

**Asllan Hamiti  
Ismail Hamiti**

# **GJUHË SHQIPE**

**PËR KLASËN VI**

**TË ARSIMIT FILLOR NËNTËVJEÇAR**

Recensues:

dr. Ismet Osmani  
profesor në Fakultetin e Filologjisë  
“Bllazhe Koneski”, Shkup

Ibe Mustafa  
mësimdhënëse në ShFK “25 Maji”  
Hasanbeg, Shkup

Safet Nuredini  
mësimdhënës në ShFK “Sami Frashëri”  
Gllumovë, Shkup

Redaktor gjuhësor: prof. dr. Ajten Qamili

Со решение на Министерот за образование и наука на Република Македонија бр. 22-991/1 од 13. 06. 2011 год. се одобрува употребата на овој учебник

Me Aktvendimin e ministrit të Arsimit dhe të Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr. 22-991/1 të datës 13. 06. 2011 miratohet përdorimi i këtij libri shkollor

Со решение на Министерот за образование и наука на Република Северна Македонија бр. 26-125/1 од 29. 01. 2020 год. се продолжува важноста на Одлуката за одобрување и употреба на учебникот

Me Aktvendimin e ministrit të Arsimit dhe të Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 26-125/1 të datës 29. 01. 2020 vazhdohet vlefshmëria e Vendimit për miratimin dhe përdorimin e këtij libri shkollor

Издавач: Министерство за образование и наука на Република Северна Македонија

Botues: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Печати: Европа 92, Кочани

Shtypi: Европа 92, Коџан

Тираж: 6.858

Tirazhi: 6.858

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

373.3.016:811.18(075.2)

**HAMITI, Asllan**

Gjuhë shqipe për klasën VI të arsimit fillor nëntëvjeçar / Asllan Hamiti, Ismail Hamiti.  
- Shkup: Ministria e arsimit dhe shkencës e Republika e Maqedonisë së Veriut, 2020. -  
198 стр. : илустр. ; 29 см

ISBN 978-608-226-839-2

1. Hamiti, Ismail [автор]

COBISS.MK-ID 51644165

## Disa fjalë rreth këtij libri shkollor

Ky libër mësimor është hartuar për nxënësit e klasës së gjashtë. Ai është hartuar në bazë të programit mësimor dhe përfshin katër fusha programore: 1. Gjuhë, 2. Letërsi dhe lektyrë, 3. Të shprehurit dhe krijimtaria, 4. Kultura e medias, shoqëruar me pyetje, detyra e ushtrime konkrete lidhur me leksionet në librin shkollor.

Qëllimi ynë kryesor është që libri të shërbejë si tekst themelor shkollor:

- për t'i thelluar e zgjeruar njohuritë e nënësve;
- për të përmirësuar aftësitë që të flasin e të shkruajnë bukur gjuhën shqipe dhe
- për t'u aftësuar të lexojnë, të kuptojnë e të mësojnë edhe vetë, pa ndihmën e mësimitdhënësit.

Nxënësit do të aftësohen për të lexuar rrjedhshëm dhe shkruar drejt gjuhën tonë, për të parashtruar pyetje dhe për t'u përgjigjur siç duhet, për të bërë renditjen e drejtë të fjalëve e të fjalive.

Duhet të zgjedhin fjalët më të përshtatshme dhe t'i përdorin drejt ato. Ndërtimi i rregullt i fjalive është kusht i domosdoshëm për t'i thënë drejt e qartë mendimet, për të na kuptuar të tjerët.

Në këtë libër do të mund të lexoni edhe shumë tregime të shkurtra, përralla, përrallëza, vjersha, pjesë dramash etj., jo si pjesë të ndara, por të ndërlidhura me mësimin e gjuhës.

Gjuha është mjeti me të cilin krijohen edhe veprat letrare. Letërsia na jep modelet më të bukura të shqipes.

Veprat e shkrimtarëve janë një shkollë e gjuhës. Këto njohuri do të jenë një bazë e mirë për t'u aftësuar dhe nxitur që nxënësit të lexojnë në mënyrë të pavarur libra e revista për fëmijë.

Po kështu, do të aftësohen të kuptojnë dhe të tregojnë informata të shkurtra nga mediet: emisionet televizive, filmi, teatri, libri dhe shtypi për fëmijë.

Pasurinë e fjalëve të gjuhës shqipe nxënësit e përvetësojnë pak nga pak nga jeta e përditshme, nga shkolla e puna, por edhe nga librat, shtypi e radiotelevizioni.


Njohja e mirë e gjuhës amtare nxënësve do t'u ndihmojë edhe për të mësuar më mirë lëndët e tjera. Bashkë me lëndët mësimore, ata përvetësojnë edhe mënyrën për t'u shprehur me përpikëri, me qartësi dhe me rrjedhshmëri logjike.

Ai që flet e shkruan mirë, ka më shumë sukses në jetën dhe në punën e tij. Shprehitë që nxënësit marrin për gjuhën në shkollë, janë të dobishme për gjithë jetën.

## HISTORIKU I GJUHËS SHQIPE

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane. Ajo formon degë të veçantë në këtë familje gjuhësore.

Ka disa mendime për prejardhjen e gjuhës shqipe, por është vërtetuar që gjuha shqipe rrjedh nga dialekti jugor i ilirishtes, ndërsa shqip-tarët janë pasardhës të ilirëve.



Pema gjuhësore indoevropiane

### DETYRË

- Shikojeni pemën gjuhësore indoevropiane. Çfarë vëreni në të?

Shqipja është një nga gjuhët e lashta të Ballkanit, por e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, në shekullin XV.

Dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe, është ai që quhet "Formula e pagëzimit", e vitit 1462. Është një fjali e shkurtër në gjuhën shqipe "*Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit*", që gjendet në një qarkore të shkruar në latinisht nga Kryepeshkopi i Durrësit Pal Engjëlli, bashkëpunëtor i ngushtë i Skënderbeut.

Dokumenti i dytë, i shkruar në gjuhën shqipe është "Fjalorthi i Arnold von Harfit", i vitit 1496. I fundit të shekullit XV ose i fillimit të shekullit XVI është "Ungjilli i Pashkëve". Këto dokumente paraqesin interes për historinë e gjuhës së shkruar shqipe.

Libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe, që njohim deri më sot, është "Meshari" i Gjon Buzukut, i vitit 1555, i cili shënon edhe fillimin e letërsisë së vjetër shqiptare. Kjo vepër dëshmon për ekzistencën e një tradite të mëparshme të shkruarit të shqipes.

Në shekullin XVI i ka fillimet edhe letërsia në gjuhën shqipe tek arbëreshët e Italisë.

Vepra e parë e letërsisë arbëreshe në gjuhën shqipe dhe vepra e dytë për nga vjetërsia, pas asaj të Buzukut, është ajo e priftit arbëresh Lekë Matrënga "E mbësuarë e krishterë ...", e botuar në vitin 1592.

Një zhvillim më të madh njohu lëvrimi i gjuhës shqipe në shekullin XVII, nën penën e një vargu autorësh, si Pjetër Budi, Frang Bardhi dhe Pjetër Bogdani.



Ndarja dialektore e gjuhës shqipe

Gjatë Rilindjes Kombëtare, në shekullin XIX, në kushte të reja historike, lëvrimi dhe përparimi i gjuhës shqipe hyri në një etapë të re. Në këtë periudhë u bënë përpjekje të vetëdijshme për të krijuar një gjuhë letrare kombëtare, standardizimi i së cilës u arrit në shekullin XX.

Gjuha shqipe ka dy dialekte, dialektin e veriut ose gegërishten dhe dialektin e jugut ose toskërishten. Kufiri natyror që i ndan këto dialekte është lumi Shkumbin. Në anën e djathtë të Shkumbinit shtrihet dialekti verior (gegërishtja), në anën e majtë të tij, dialekti jugor (toskërishtja).

Dallimet midis dialekteve të shqipes nuk janë të mëdha, folësit e tyre kuptohen pa vështirësi njëri me tjetrin.

## mëso më shumë

Përpjekjet për një gjuhë letrare kombëtare të njësuar (gjuhë standarde) kanë filluar që në shekullin XVI. Gjuha shqipe u përpunua gjatë Rilindjes Kombëtare. Më vitin 1844 u botua “Ëvetar”-i (Abetarja) i Naum Veqilharxhit. Kostandin Kristoforidhi më 1904 botoi “Fjalorin e Gjuhës Shqipe”.

Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, shqipja u shkrua në dy variante letrare: në gegërishte dhe në toskërishte. U bënë përpjekje për afrimin e këtyre varianteve dhe për njësimin e gjuhës letrare. Detyra e parë që duhej zgjidhur, ishte njësimi i alfabetit. Deri atëherë, shqipja ishte shkruar në disa alfabete: alfabetin latin, alfabetin grek, alfabetin turko-arab dhe alfabetin cirilik.

Në Kongresin e Alfabetit, i mbajtur prej 14 deri më 22 nëntor 1908 në Manastir, u përcaktua alfabeti i shqipes që e përdorim edhe tani.

Në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që u mbajt në nëntor të vitit 1972 në Tiranë, u miratuan rregullat e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe dhe me këtë përfundimisht u njësua shqipja standarde.

Janë otuar një varg veprash të rëndësishme, që kodifikojnë normat e gjuhës standarde, siç janë: “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, “Fjalori i shqipes së sotme”, “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe”, “Gramatika

e gjuhës së sotme shqipe (I Morfologjia, II Sintaksa)”, “Rregullat e pikësimit të gjuhës shqipe” dhe shumë vepra të tjera të vlefshme.

Tani kemi edhe një Program kompjuterik për drejtshkrimin e shqipes, Fjalor elektronik shpjegues, Fjalor enciklopedik, Atlas dialektologjik të shqipes etj.


Studimet për ruajtjen dhe pastrimin nga fjalët e huaja të panevojshme, për pasurimin e gjuhës shqipe me fjalë të reja po vazhdon dhe do të vazhdojë edhe më tej.

Edhe ne nxënës të dashur, duhet të përpiqemi që të flasim e të shkruajmë bukur gjuhën shqipe. Nxënësi që mëson me zell, flet e shkruan mirë, kur të rritet mund të shkruajë ndonjë libër për gjuhën shqipe ose të bëhet shkrimtar.

### Pyetje për tekstin

1. Në cilën familje gjuhësh bën pjesë gjuha shqipe?
2. A është e vjetër gjuha shqipe?
3. Nga rrjedh gjuha shqipe?
4. Cili është dokumenti i parë i gjuhës shqipe?
5. Kur është shkruar ai?
6. Kush e ka shkruar?
7. Cili është dokumenti i dytë i gjuhës shqipe?
8. Cili është libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe?
9. Sa dialekte ka gjuha shqipe?
10. Cili lumë i ndan dy dialektet e shqipes?
11. Në qoftë se do të gjenit ndonjë shkrim të vjetër të shqipes, çfarë do të bënit me të?

12. Shiko hartën dhe gjeje qytetin më të afërt ku banon ti. Cilit dialekt i takon e folmja jote?





## PËRNGJASHIMI I BASHKËTINGËLLOREVE

Gjatë të folurit, kur kemi njëren pas tjetrës dy bashkëtingëllore me zëshmëri të ndryshme (një të zëshme dhe një të shurdhët ose anasjelltas), atëherë ato i përshtatim në zëshmëri: ose të dyja i shqiptojmë të shurdhëta, ose të dyja të zëshme.

Bashkëtingëllorja e parë njëjtësohet me të dytën. Pra, bashkëtingëllorja e dytë ndikon që ta njësojë me veten bashkëtingëlloren para saj.

Rregull i përshtatjes në zëshmëri të bashkëtingëlloreve të shqipes (si edhe i shumë gjuhëve të tjera) është: kur i shqiptojmë njëren pas tjetrës, e shurdhëta para të zëshmes zëshmohet, ndërsa e zëshmja para të shurdhëtës shurdhohet. Këtë dukuri të përshtatjes në zëshmëri e zbatojmë në të folurit, por nuk e shkruajmë. P.sh.:

	<i>shkruajmë</i>	<i>shqiptojmë</i>
<b>s &gt; z</b> <b>s</b> - e shurdhët <b>z</b> - e zëshme	s'dëgjoj	z'dëgjoj
	s'guxoj	z'guxoj
	s'vjen	z'vjen
	asgjë	azgjë
	mesditë	mezditë
	mesdhetar	mezdhetar
	s'bën	z'bën

	<i>shkruajmë</i>	<i>shqiptojmë</i>
<b>k &gt; g</b> <b>k</b> - e shurdhët <b>g</b> - e zëshme	ekzistencë	egzistencë
	ekzekutiv	egzekutiv

	<i>shkruajmë</i>	<i>shqiptojmë</i>
<b>d &gt; t</b> <b>d</b> - e zëshme <b>t</b> - e shurdhët	i njëmendtë	i njmenttë
	e argjendtë	e argjenttë
	i njëqindtë	i njëqinttë

	<i>shkruajmë</i>	<i>shqiptojmë</i>
<b>b &gt; p</b> <b>b</b> - e zëshme <b>p</b> - e shurdhët	absolut	apsolut
	absolvent	apsolvent
	abstenim	apstenim

## THEKSI I FJALËS

Fjalët përbëhen nga rrokjet, që në rrjedhën e të folurit nuk shqiptohen të gjitha njëloj. Kur shqiptojmë fjalë të ndryshme me dy a më shumë rrokje, vëmë re se njëra prej tyre dallohet nga të tjerat. Ky dallim bëhet me anë të theksit.

Zanoret e theksuara shqiptohen me forcë më të madhe, me ton më të lartë, janë më të gjata dhe më të qarta sesa zanoret e patheksuara. Bartëse të theksit janë vetëm zanoret. Në një fjalë kemi vetëm një zanore të theksuar, ndërsa të tjerat janë të patheksuara. Për të shënuar se cila zanore është e theksuar, mbi zanore shënojmë shenjën e theksit, si á, é, í, ó, ú, ý, ó.

Në gjuhën shqipe fjalët rëndom shqiptohen me theks në njërën nga dy rrokjet e fundit të fjalës.

Në fjalët njërrrokëshe theksi bie mbi zanoren e vetme të fjalës: *mík, qén, dét, lésh, lís, mál, plák, fúnd, ménd, shtég, dréjt, trím, gúr, rrúsh, drú, shkój, mbjëll, sjéll, dál, há, pí* etj.

### mëso më shumë

Në fjalët shumërrrokëshe, theksi bie:

1. Në pozitë fundore (në rrokjen e fundit): *njerí, qirí, qytét, lirí, babá, shtëpí, ushtrí, barí, folé, puním, mësój, lexój, shikój, mendój* etj. Te foljet, theksi bie rregullisht mbi zanoren e fundit të temës.

Me theks fundor shqiptohen edhe fjalët e prejardhura, të formuara me anë të prapashtesimit, të cilat marrin mbi vete theksin e fjalës: *fshát - fshatár, qytét - qytetár, údhë - udhëtár, lákër - lakrór, dásme - dasmór, mál - malór, ákull - akullóre, rrégull - rregullóre; púnë - puním, punëtór, punëtorí; árt - artíst, futbóll - futbollíst, mjéshtër - mjeshtrí, zónjë - zonjúshë, i ëmbël - ëmbëlsí, djálë - djalëri, rrúgë - rrugác, ménd - mendój* etj.

Por theksi nuk kalon te prapashtesat -as, -ës dhe -je. Krahaso: *vénd - véndas, nxë - nxënës, prés - prítës* etj.

2. Në pozitë parafundore (në rrokjen e dytë nga fundi): *mótër, anije, déle, lúle, bésë, shkóllë, fúshë, dárdhë, émër, fémër, létër, móllë, púlë, ...* Shqipja ka prirje të theksojë zanoret parafundore.

3. Në pozitë tejfundore (në rrokjen e tretë, rrallë edhe në të katërtën nga fundi i fjalës): *flútura, kúmbulla, plúhuri, fúshave, ndéshe-mi, fshehúrazi; punúakëshim, punúakemi* etj.

Fjalët e huazuara i janë përshtatur natyrës së shqipes: ato shqiptohen ose me theks parafundor ose me theks fundor.

### MBANI MEND

Në gjuhën shqipe:

- a) 54% e fjalëve shqiptohen me theks parafundor,
- b) 44% me theks fundor,
- c) vetëm 2% me theks tejfundor.



## GJINIA E EMRIT

### Detyrë

Lexoni dy trajtat e këtyre emrave: trajtën e pashquar dhe trajtën e shquar.



laps - laps**i**



kompjuter - kompjuter**i**



libër - lib**ri**



ujk - ujk**u**



shah - shah**u**



ari - ari**u**



shkollë - shkoll**a**



mollë - moll**a**



orë - or**a**



lule - lul**ja**



shtëpi - shtëpi**a**



piano - piano**ja**

### Mendohu

#### Çfarë dallimi vëreni?

Emrat që në trajtën e shquar njëjës marrin mbaresat **-i** ose **-u** janë të gjinisë mashkullore.

Emrat që në trajtën e shquar njëjës marrin mbaresat **-a** ose **-ja** janë të gjinisë femërore.

Emrat që marrin mbaresën **-t** (**-të** ose **-it**) janë të gjinisë asnjëse.

Formë përfaqësuese (bazë) e emrit është trajta e pashquar, numri njëjës, rasa emërore: *djalë, vajzë, shkollë, lule, letër, njeri, kompjuter, lepur, qen, piano* etj.

Gjinia e emrave në gjuhën shqipe mund të dallohet fare lehtë. Zakonisht emrat e gjinisë mashkullore mbarojnë me bashkëtingëllore, ndërsa ata të gjinisë femërore mbarojnë në zanore.

Por, edhe më lehtë gjinia e emrave dallohet në trajtën e shquar. Kështu, formës përfaqësuese i shtohen këto mbaresa shquese:

- a) mbaresa **-i** ose **-u** emrave të gjinisë mashkullore;
- b) mbaresa **-a** ose **-ja** emrave të gjinisë femërore;
- c) mbaresa **-t**, **-të** ose **-it** emrave të gjinisë asnjësore.

Treguesit gramatikorë të emrit po i paraqesim edhe në mënyrë tabelore:

<b>gjinia mashkullore</b>			
trajta e pashquar			trajta e shquar
1.	fjalë që mbaron me bashkëtingëllore:	+ <b>i</b>	top + i = topi libër + i = libri
2.	me bashkëtingëlloret: -k, -g, -h	+ <b>u</b>	ujk + u = ujku
3.	me zanoren: -í	+ <b>u</b>	njerí + u = njeriu

<b>gjinia femërore</b>			
trajta e pashquar			trajta e shquar
1.	zanore: -ë	+ <b>a</b>	nënë + a = nëna
2.	-e	+ <b>ja</b>	lule + ja = lulja
3.	-í	+ <b>a</b>	shtëpí + a = shtëpia
4.	-o, -á, -é, -ý	+ <b>ja</b>	vazo + ja = vazoja / kalá+ja

Janë në gjininë asnjane:

a) disa emra të prejardhur nga folje. Këta quhen emra prejfoljorë, më saktësisht emra prejpjesorë.

b) disa emra të prejardhur nga mbiemra, që quhen emra prejmbiemrorë.

*folje* → *emër i gjinisë anjanëse*

mësoj	-	të mësuarit
këndoj	-	të kënduarit
eci	-	të ecurit
lexoj	-	të lexuarit
flas	-	të folurit

*mbiemër* → *emër i gj. anjanëse*

i zi	-	të zitë
i kuq	-	të kuqtë
i verdhë	-	të verdhët
i ftohtë	-	të ftohtët
i bardhë	-	të bardhët

## MBANI MEND

Në trajtën e shquar:

- emrave të gjinisë mashkullore u prapavihen **-i** ose **-u**;
- emrave të gjinisë femërore **-a** ose **-ja**, dhe
- emrave të gjinisë asnjane **-t**, **-të** ose **-it**.

## SHUMËSI I EMRAVE

### Detyrë

Ç'shohim në këto fotografi? T'i emërtojmë së bashku.



një libër  
libri



shumë libra  
librat



një laps  
lapsi



dy lapsa  
lapsat



një çantë  
çanta



tri çanta  
çantat



një lule  
lulja



disa lule  
lulet

### Mendohu

Krahasoni çiftet e emrave të dhënë më lart në numrin njëjës dhe në shumës. Çfarë vëreni?

Emrat kanë dy numra: numrin **njëjës** dhe numrin **shumës**.

Emri është në numrin njëjës kur emërton një njeri, një kafshë a një send.

Në numrin shumës emri tregon dy a më shumë njerëz, kafshë a gjëra.

Edhe në numrin shumës, emri ka trajtën e pashquar dhe të shquar.

Emrat e njerëzve, të vendeve etj. nuk kanë numër shumës.

## SI FORMOHET NUMRI SHUMËS?

1. Disa emra kanë formë të njëjtë, si në njëjës ashtu edhe në shumës. P.sh.:

NJËJËS	SHUMËS
(një) <i>nxënës</i>	- (shumë) <i>nxënës</i>
<i>mësues</i>	- <i>mësues</i>
<i>mace</i>	- <i>mace</i>
<i>shtëpi</i>	- <i>shtëpi</i>
<i>orë</i>	- <i>orë etj.</i>

2. Por, shumica e emrave shumësin e formojnë në dy mënyra:

- me prapashtesa dhe
- me ndërrime fonemash (tingujsh).

a. Formimi i shumësit me prapashtesat: **-e, -a, -ë, -nj, -ër, -enj, -inj, -ra.**

NJËJËS	SHUMËS
(një) ⇔ (shumë)	
<i>gabim</i>	- <i>gabime</i>
<i>stacion</i>	- <i>stacione</i>
<i>mal</i>	- <i>male</i>
<i>vajzë</i>	- <i>vajza</i>
<i>top</i>	- <i>topa</i>
<i>emër</i>	- <i>emra</i>
<i>motër</i>	- <i>motra</i>
<i>arsimtar</i>	- <i>arsimtarë</i>
<i>shok</i>	- <i>shokë etj.</i>

NJËJËS	SHUMËS
(një) ⇔ (shumë)	
<i>ari</i>	- <i>arinj</i>
<i>lumë</i>	- <i>lumenj</i>
<i>vëlla</i>	- <i>vëllezër</i>
<i>numër</i>	- <i>numra</i>
<i>pulë</i>	- <i>pula</i>
<i>kushëri</i>	- <i>kushërinj</i>
<i>shqiptar</i>	- <i>shqiptarë</i>
<i>fshat</i>	- <i>fshatra</i>
<i>njeri</i>	- <i>njerëz etj.</i>



b. Formimi i shumësit me ndërrime fonemash: /a/~ /e/, /k/~ /q/  
/g/~ /gj/, /r, l, ll/~ /j/ + e

P.sh.:

**NJËJËS SHUMËS**

(një) ⇨ (shumë)

*plak - pleq*

*armik - armiq*

*bujk - bujq*

*mik - miq*

*peshk - peshq*

*zog - zogj*

*treg - tregje*

**NJËJËS SHUMËS**

(një) ⇨ (shumë)

*popull - popuj*

*bir - bij*

*mashkull - meshkuj*

*dash - desh*

*natë - net*

*rreth - r Rathë*

*vit - vjet*

## Ushtrahu

Me emrat: *libër, fletore, laps, shtëpi, gomë, mace formoni fjali sipas shembullit më poshtë:*

Unë kam një shok. Ti ke dy shokë.

Unë kam një libër. Ti ke dy libra.

## KATEGORITË GRAMATIKORE TË MBIEMRIT

Mbiemri përshtatet në gjini, në numër e rasë me emrin të cilin e përcakton. Ai ka kategoritë gramatikore të gjinisë, të numrit; ndërsa mbiemrat e nyjshëm edhe kategorinë e rasës. Veç kësaj, mbiemri ka edhe kategorinë e shkallës, të cilën emri nuk e ka.

Shqipja ka dy tipa mbiemrash: **të nyjshëm** dhe **të panyjshëm**.

### mëso më shumë

Mbiemrat e nyjshëm i kanë nyjat **i, e, të** në rasën emërore; kurse mbiemrat e panyjshëm nuk kanë nyjë të paravendosur. Nyja te mbiemrat e nyjshëm është pjesë përbërëse e tyre dhe nuk mund të mungojë në asnjë rast.

Mbiemrat zakonisht përdoren pas emrave. P.sh.: *djalë i mirë, vajzë e sjellshme, lule e bukur, shkollë e madhe* etj.

Çdo emër mund të lidhet me një ose me dy mbiemra.

### Përshtatja e mbiemrit me emrin

Mbiemri merr gjininë, numrin dhe rasën e emrit të cilin e përcakton.

## GJINIA E MBIEMRIT

Mbiemrat e nyjshëm e bëjnë gjininë femërore nga gjinia mashkullore në disa mënyra:

a) duke ndryshuar vetëm nyjën e përparme, p.sh.:

*një top i vogël - një gotë e vogël;*

b) duke e ndryshuar nyjën e përparme e duke marrë mbaresën **-e**: *një yll i kuq - një shami e kuqe;*

c) duke ndryshuar nyjën e përparme dhe zanoren e temës:

*një djalë i ri - një vajzë e re; një dem i zi - një lopë e zezë.*

### **Mbiemrat e panyjshëm e bëjnë gjininë femërore nga gjinia mashkullore në dy mënyra:**

a) duke marrë mbaresën **-e**: *njeri dinak - dhelpër dinake; pushim veror - frute verore.*

b) një numër mbiemrash nuk e ndryshojnë fare formën e gjinisë mashkullore, p.sh.: *babë zemërbardhë - nënë zemërbardhë; vëlla dorëilirë - motër dorëilirë.*

## **NUMRI I MBIEMRIT**

Numri i mbiemrit varet nga numri i emrit të cilit i përket. Kjo do të thotë se kur emri është në njëjës, edhe mbiemri duhet të jetë në njëjës. Kur emri është në shumës, edhe mbiemri duhet të përdoret në shumës.

### **Formimi i shumësit të mbiemrave të nyjshëm të gjinisë mashkullore**

Mbiemrat e nyjshëm të gjinisë mashkullore shumësin e bëjnë në tri mënyra:

1. duke e shndërruar vetëm nyjën **i** në **të**. P.sh.:

<i>një libër <b>i</b> mirë</i>	<i>disa libra <b>të</b> mirë</i>
<i>një djalë <b>i</b> zellshëm</i>	<i>disa djem <b>të</b> zellshëm</i>

2. duke ndryshuar nyjën **i** në **të** dhe duke marrë mbaresën **-nj**:

<i>një djalë <b>i</b> ri</i>	<i>disa djem <b>të</b> rinj</i>
<i>një laps <b>i</b> zi</i>	<i>disa lapsa <b>të</b> zinj</i>

3. duke e bërë shumës nyjën dhe duke e ndryshuar rrënjën e mbiemrit:

<i>një njeri <b>i</b> madh</i>	<i>disa njerëz <b>të</b> mëdhenj</i>
<i>një njeri <b>i</b> vogël</i>	<i>disa njerëz <b>të</b> vegjël</i>
<i>një njeri <b>i</b> keq</i>	<i>disa njerëz <b>të</b> këqij</i>
<i>një njeri <b>i</b> lig</i>	<i>disa njerëz <b>të</b> ligj</i>

### **Formimi i shumësit të mbiemrave të nyjshëm të gjinisë femërore**

Edhe mbiemrat e nyjshëm të gjinisë femërore shumësin e bëjnë nga forma e njëjës në tri mënyra:

#### **1. duke bërë shumës njëjën e në të:**

*një punë e këndshme  
një notë e kalueshme*

*disa punë të këndshme  
disa nota të kalueshme*

#### **2. duke bërë shumës njëjën e në të dhe duke marrë mbaresën -a:**

*një vjershë e bukur  
një statujë e drunjtë*

*disa vjersha të bukura  
disa statuja të drunjta*

#### **3. duke bërë shumës njëjën dhe duke ndryshuar rrënjën:**

*një fjalë e keqe  
një shtëpi e madhe  
një shkollë e re*

*disa fjalë të këqija  
disa shtëpi të mëdha  
disa shkolla të reja*

## KATEGORIA E RASËS TE MBIEMRAT

Mbiemrat e panyjshëm kur vendosen pas emrit që e përcaktojnë, nuk pësojnë ndonjë ndryshim në rasë, domethënë nuk lakohen. P.sh.:

*një djalë **punëtor**, i një djali **punëtor**;  
 djali **punëtor**, i djalit **punëtor**;  
 një vajzë **punëtore**, i një vajzeje **punëtore**;  
 vajza **punëtore**, i vajzës **punëtore** etj.*

E njëjta gjë ndodh edhe me trupin e mbiemrave të nyjshëm, por këta sipas rasës ndryshojnë nyjën, e cila është pjesë e pandashme e mbiemrit.

### Lakimi i një emri me një mbiemër të nyjshëm

#### Gjinia mashkullore

Numri	Rasa	Emri i pashquar	Emri i shquar
Njëjës	E.	(një) shok <b>i</b> mirë	shoku <b>i</b> mirë
	Gj.	i (e) (një) shoku <b>të</b> mirë	i (e) shokut <b>të</b> mirë
	Dh.	(një) shoku <b>të</b> mirë	shokut <b>të</b> mirë
	K.	(një) shok <b>të</b> mirë	shokun <b>e</b> mirë
	Rr.	(një) shoku <b>të</b> mirë	shokut <b>të</b> mirë
Shumës	E.	(ca) shokë <b>të</b> mirë	shokët <b>e</b> mirë
	Gj.	i (e) (ca) shokëve <b>të</b> mirë	i (e) shokëve <b>të</b> mirë
	Dh.	(ca) shokëve <b>të</b> mirë	shokëve <b>të</b> mirë
	K.	(ca) shokë <b>të</b> mirë	shokët <b>e</b> mirë
	Rr.	(ca) shokësh <b>të</b> mirë	shokëve <b>të</b> mirë

#### Gjinia femërore

Numri	Rasa	Emri i pashquar	Emri i shquar
Njëjës	E.	(një) vajzë <b>e</b> bukur	vajza <b>e</b> bukur
	Gj.	i (e) (një) vajze <b>të</b> bukur	i (e) vajzës <b>së</b> bukur
	Dh.	(një) vajze <b>të</b> bukur	vajzës <b>së</b> bukur
	K.	(një) vajzë <b>të</b> bukur	vajzën <b>e</b> bukur
	Rr.	(një) vajze <b>të</b> bukur	vajzës <b>së</b> bukur
Shumës	E.	(ca) vajza <b>të</b> bukura	vajzat <b>e</b> bukura
	Gj.	i (e) (ca) vajzave <b>të</b> bukura	i (e) vajzave <b>të</b> bukura
	Dh.	(ca) vajzave <b>të</b> bukura	vajzave <b>të</b> bukura
	K.	(ca) vajza <b>të</b> bukura	vajzat <b>e</b> bukura
	Rr.	(ca) vajzash <b>të</b> bukura	vajzave <b>të</b> bukura

## KATEGORIA E SHKALLËS TE MBIEMRI

Cilësia e sendeve mund të shprehet në mënyrë të shkallëzuar.  
P.sh.:

*Liqeni është i madh.*

*Deti është më i madh.*

*Oqeani është shumë i madh.*

Pra, mbiemri ka tri shkallë: *shkallën pohore, krahasore dhe sipërore.*

1. **Shkalla pohore** është shkalla bazë e mbiemrit dhe emërton tiparin e sendit, jashtë çdo krahasimi. P.sh.: *i mirë, e bardhë, të verdhë* etj.

2. **Shkalla krahasore** tregon se cilësia e dhënë krahasohet me vetveten ose me një cilësi tjetër. P.sh.:

*Mësuesi ishte po **aq** i rreptë, **sa** edhe i mirë.*

*Ajo është **më** e re **se** motra ime.*

***Sa** më shumë largohej treni, **aq** më i vogël dukej.*

*Ai ishte **më i riu** dhe **më i miri** nga ne.*

3. **Shkalla sipërore** e mbiemrit tregon se cilësia e dhënë është në një shkallë shumë të lartë, jashtë çdo krahasimi. Rëndom, shkalla sipërore formohet me ndajfoljet: *shumë, jashtëzakonisht, mjaft, tepër, fort, krejt, fare, absolutisht* etj. P.sh.:

*Midis reve dukej qielli **shumë i kaltër**.*

*Kjo fjalë ka domethënie **jashtëzakonisht të madhe**.*

*Stacioni është **fare i ri**.*

*Oborri tani iu duk **shumë-shumë i vogël**.*

Në gjuhën popullore dhe letrare, për të shprehur shkallë shumë të lartë të cilësisë, përdoren edhe disa emra me kuptim të fytyruar, të cilët në rastin e dhënë nuk emërtojnë më sende, por tipare karakteristike të këtyre sendeve. P.sh.: *akull, mjaltë, borë, dyllë, qumësht* etj.:

*Uji i burimit ishte **akull i ftohtë**.*

*Muri dukej **qumësht i bardhë**.*

*Mollët janë **mjaltë të ëmbla**.*

*Ajo u bë **thanë e kuqe** në fytyrë.*

## KATEGORITË GRAMATIKORE TË PËREMËRIT

Ashtu si në gjuhët e tjera, edhe në gjuhën shqipe përdoren shpesh fjalë që zëvendësojnë emrat, që janë përfaqësues të tyre në fjali. Përdorimi i përemrave bën të mundur që të shmanget përsëritja e të njëjtit emër.

Përemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që tregon në mënyrë të përgjithshme (pa i emërtuar) frymorë, sende, tipare ose sasi të pacaktuara.

Disa përemra, ashtu si mbiemrat, përdoren pranë emrave dhe përshtaten në gjini, në numër dhe në rasë me ta. Për shembull:

- Gjyshi **im** ka qenë murator.
- **Kjo** kullë ka përballuar shumë sulme.

Disa përemra të tjerë nuk përdoren pranë emrave dhe lakohen në njëjës dhe në shumës, ashtu si emrat. P.sh.:

- **Unë** them të tregojmë të vërtetën në çdo rast.
- **Dikush** po vjen.
- Hapat **e dikujt** po dëgjohen në korridor.

Sipas kuptimit që kanë, dallojmë shtatë lloje përemrash:

1. **Përemra vektorë:** *unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato;*
2. **Përemra vetvektorë:** *vete, vetvete;*
3. **Përemra dëftorë:** *ky, kjo, këta, këto, i tillë...;*
4. **Përemra pronorë:** *im, yt, i tij, i saj...;*
5. **Përemra pyetës:** *kush? cili? sa? ç'?...;*
6. **Përemra lidhorë:** *që, i cili, e cila;*
7. **Përemra të pacaktuar:** *cilido, secili, asnjë, ca, asnjëri, kushdo, dikush, çdo... .*

## PËREMRI VETOR

Përemra vetorë janë fjalët që tregojnë veta të ndryshme. Ata kanë tri veta.

Përemrat vetorë të vetës së parë: njëjës *unë*, shumës *ne*, tregojnë vetën që flet, përkatësisht një grup vetash ku bën pjesë edhe folësi.

Përemrat vetorë të vetës së dytë: njëjës *ti*, shumës *ju*, tregojnë vetën me të cilën flasim, bashkëbiseduesin, përkatësisht bashkëbiseduesit.

Përemrat *ai*, *ajo* njëjës dhe *ata*, *ato* shumës janë të vetes së tretë dhe tregojnë frymorët dhe sendet për të cilët bëhet fjalë.

Përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë (*unë*, *ti*; *ne*, *ju*) përdoren për të dy gjinitë dhe vetëm për njerëz, kurse ata të vetes së tretë (*ai*, *ajo*; *ata*, *ato*) kanë forma të veçanta për gjini të ndryshme dhe përdoren edhe për kafshë e sende.

P.sh.:

- *Agimi u nis përpara. Me **të** shkoi dhe Artani.*
- *Petriri dhe Ylli erdhën të parët. Pas **tyre** erdhën të tjerët.*
- *Vjollca shkoi në Shkodër. Prej **saj** morëm letër.*

Përemrat vetorë të vetës së tretë e kanë si kategorinë e gjinisë, ashtu edhe atë të numrit: *ai*, *ajo* - *ata*, *ato*; ndërsa kategorinë e rasës e kanë të gjithë përemrat vetorë.

### Pasqyra e lakimit të përemrave vetorë

numri	rasa	veta e parë	veta e dytë	veta e tretë	
				mashkullore	femërore
njëjës	Emërore	<b>unë</b>	<b>ti</b>	<b>ai</b>	<b>ajo</b>
	Gjinore	---	---	i atij	i asaj
	Dhanore	mua, <b>më</b>	ty, <b>të</b>	atij, <b>i</b>	asaj, <b>i</b>
	Kallëzore Rrjedhore	mua, <b>më</b> (prej) meje	ty, <b>të</b> (prej) teje	atë, <b>e</b> (prej) atij	atë, <b>e</b> (prej) asaj
shumës	Emërore	<b>ne</b>	<b>ju</b>	<b>ata</b>	<b>ato</b>
	Gjinore	---	---	i atyre	i atyre
	Dhanore	neve, <b>na</b>	juve, <b>ju</b>	atyre, <b>u</b>	atyre, <b>u</b>
	Kallëzore Rrjedhore	ne, <b>na</b> (prej) nesh	ju, <b>ju</b> (prej) jush	ata, <b>i</b> (prej) atyre	ato, <b>i</b> (prej) atyre



## PËREMRI DËFTOR

Përemri dëftor shërben për të treguar frymorë ose sende që gjenden afër ose larg folësit. Ata përdoren bashkë me emrin ose e zëvendësojnë atë.

Përemrat dëftorë janë:

### **për afër:**

ky, kjo, këta, këto; i këtillë, e këtillë, të këtillë, të këtilla; i tillë, e tillë

### **për larg:**

ai, ajo, ata, ato; i atillë, e atillë, të atillë, të atilla

Përemrat dëftorë ndryshojnë sipas gjinisë, numrit dhe rasës. P.sh.:

- **Ky** djalë është shumë punëtor.
- **Kjo** vajzë ndihmon shoqet.
- **Ajo** parcelë është eksperimentale.
- **Ata** ara do të mbillen me oriz.
- **Ky** libër është i bukur.
- **Këtë** libër sapo e lexova.

Përemrat dëftorë **ky, kjo, ai, ajo** lakohen si përemrat vetorë **ai, ajo**.

Përemrat dëftorë **i këtillë, e këtillë** etj. lakohen si mbiemrat e nyjshëm: *një djalë i këtillë, i një djali të këtillë* etj.

Po japim lakimin e përemrave dëftorë **ky, kjo, këta, këto**:

Rasa	<b>Ky</b>		<b>Kjo</b>	
Emërore	ky	ky mësues	kjo	kjo mësuese
Gjinore	i (e) këtij	i (e) këtij mësuesi	i (e) kësaj	i (e) kësaj mësueseje
Dhanore	këtij	këtij mësuesi	kësaj	kësaj mësueseje
Kallëzore	këtë	këtë mësues	këtë	këtë mësuese
Rrjedhore	prej këtij	prej këtij mësuesi	prej kësaj	prej kësaj mësueseje

Rasa	<b>Këta</b>		<b>Këto</b>	
Emërore	këta	këta mësues	këto	këto mësuese
Gjinore	i (e) këtyre	i (e) këtyre mësuesve	i (e) këtyre	i (e) këtyre mësueseve
Dhanore	këtyre	këtyre mësuesve	këtyre	këtyre mësueseve
Kallëzore	këta	këta mësues	këto	këto mësuese
Rrjedhore	prej këtyre	prej këtyre mësuesve	prej këtyre	prej këtyre mësueseve

## PËREMRI PYETËS

Përemri pyetës përdoret për të pyetur për frymorë e sende ose për tipare të tyre. Përemra pyetës janë: **kush?**, **cili?**, **cilat?**, **ç'?**, **çfarë?**, **sa?**, **i sati?**, **me se?** etj.

Përemri **kush?** përdoret për të pyetur për njerëz ose për genie të personifikuara, vetëm në numrin njëjës: *Kush ishte regjisor i filmit? Kush këndon më bukur se unë? - tha Bilbili.*

Ky përemër nuk duhet përdorur asnjëherë përpara emrave si përcaktor i tyre. P.sh. nuk duhet të themi *Kush këngëtar këndon më mirë?* por *Cili këngëtar këndon më mirë?*

Përemri **cili?** mund të përdoret për të pyetur për njerëz, për kafshë dhe për sende. Mund të përdoret edhe si përcaktor i një emri ose më vete.

Përemrat pyetës **ç'?**, **çfarë?** kanë gjithnjë të njëjtën formë, pavarësisht nga funksioni që kryejnë në fjali. Përemri pyetës **ç'?** shkruhet gjithmonë me apostrof, si: *Çfarë bën mësuesja?* ose *Ç'bën mësuesja?*

Në vijim po japim tabelat e lakimit të përemrave pyetës **kush?**, **cili?**, **cila?** **cilët?**, **cilat?**

Rasa	<b>Kush</b>	<b>Cili</b>	<b>Cila</b>	<b>Cilët</b>	<b>Cilat</b>
E.	kush?	cili?	cila?	cilët?	cilat?
Gj.	i (e) kujt?	i (e) cilit?	i (e) cilës?	i (e) cilëve?	i (e) cilave?
Dh.	kujt?	cilit?	cilës?	cilëve?	cilave?
K.	kë?	cilin?	cilën?	cilët?	cilat?
Rr.	prej kujt?	prej cilit?	prej cilës?	prej cilëve?	prej cilave?

## KOHA E PAKRYER (IMPERFEKTI)

Koha e pakryer tregon një veprim të zgjatur a të përsëritur herë pas here brenda një kohe të caktuar të së shkuarës e që ka përfunduar para çastit të ligjërit, pa ditur fillimin dhe mbarimin e tij.

Koha e pakryer përdoret edhe me pjesëzën "**po**", por kjo pjesëz nuk është aq e domosdoshme sa në të tashmen e dëftores.

Të gjitha foljet, duke i përfshirë edhe foljet e parregullta, në të pakryerën e veprorës, marrin këto mbaresa vetore:

veta I	<b>-ja</b>	<b>-nim</b>
veta II	<b>-je</b>	<b>-nit</b>
veta III	<b>-nte(-te)</b>	<b>-nin</b>

jam		kam		punoj	
Unë isha	Ne ishim	kisha	kishim	punoja	punonim
Ti ishe	Ju ishit	kishe	kishit	punoje	punonit
Ai ishte	Ata ishin	kishte	kishin	punonte	punonin

Që të kemi një pasqyrë më të qartë, në vazhdim po japim edhe disa folje të tjera në kohën e pakryer:

### a) forma veprorë

- shkoj** - shkoja, shkoje, shkonte; shkonim, shkonit, shkonin.
- laj** - laja, laje, lante; lanim, lanit, lanin.
- kthej** - ktheja, ktheje, kthente; kthenim, kthenit, kthenin.
- luaj** - luaja, luaje, luante; luanim, luanit, luanin.
- hap** - hapja, hapje, hapte; hapnim, hapnit, hapnin.
- mbyll** - mbyllja, mbyllje, mbyllte; mbyllnim, mbyllnit, mbyllnin.
- lëviz** - lëvizja, lëvizje, lëvizte; lëviznim, lëviznit, lëviznin.
- pi** - pija, pije, pinte; pinim, pinit, pinin.
- di** - dija, dije, dinte; dinim, dinit, dinin.
- dua** - doja, doje, donte; donim, donit, donin.
- vij** - vija, vije, vinte; vinim, vinit, vinin.

## b) forma joveprore

Në formën joveprore, foljet marrin këto mbaresa vetore:

veta I	-(h)esha	-(h)eshim
veta II	-(h)eshe	-(h)eshit
veta III	-(h)ej	-(h)eshin

*Për shembull:*

- lahem** - la**esha**, la**eshe**, la**ej**; la**eshim**, la**eshit**, la**eshin**.  
**bëhem** - bë**esha**, bë**eshe**, bë**ej**; bë**eshim**, bë**eshit**, bë**eshin**.  
**ulem** - u**lesha**, u**leshe**, u**lej**; u**leshim**, u**leshit**, u**leshin**.

## KOHA E KRYER E THJESHTË (AORISTI)

### Mendohu

*Në cilën kohë është kryer veprimi i shprehur nga foljet e dhëna me shkronja të hijesuara në tekstin e mëposhtëm.*

#### Plaku i urtë

Një plak nëntëdhjetë vjeç po mihte dheun e po mbillte një hardhi. Një mik i tij shkoi atje, e pa dhe e pyeti: "Ke shpresë ti të rrosh e të hash pemë nga kjo?"

"Jo - tha plaku - por mbollën të tjerët, hëngrëm ne, tani mbjellim ne që të hanë të tjerët."

Aoristi i shqipes tregon një veprim që ka përfunduar.

### mëso më shumë

Funksioni kryesor i kohës së kryer të thjeshtë është që të tregojë një veprim ose gjendje të përfunduar në një kohë të shkuar, d.m.th. para momentit të të folurit, zakonisht në praninë e personit që e tregon.

Po japim mbaresat vetore të foljeve në kohën e kryer të thjeshtë:

-a	I	-am / -ëm / -më / -em
-e	II	-at / -ët / -të / -et
-i / -u	III	-an / -ën / -në / -en

## Detyrë

*Vëreni zgjedhimin e foljeve të mëposhme. Format e këtyre foljeve përpikuni t'i përdorni drejt.*

<b>jam</b>	- qeshë, qe, qe; qemë, qetë, qenë.
<b>kam</b>	- pata, pate, pati; patëm, patët, patën.
<b>shkruaj</b>	- shkrova, shkrove, shkroi; shkruam, shkruat, shkruan.
<b>kthej</b>	- ktheva, ktheve, ktheu, kthyem, kthyet, kthyen.
<b>gjej</b>	- gjeta, gjete, gjeti; gjetëm, gjetët, gjetën.
<b>luaj</b>	- luajta, luajte, luajti; luajtëm, luajtët, luajtën.
<b>bëj</b>	- bëra, bëre, bëri; bëmë, bëtë, bënë.
<b>hyj</b>	- hyra, hyre, hyri; hymë, hytë, hynë.
<b>zë</b>	- zura, zure, zuri; zumë, zutë, zunë.
<b>hap</b>	- hapa, hape, hapi; hapëm, hapët, hapën.
<b>mbyll</b>	- mbylla, mbylle, mbylli; mbyllëm, mbyllët, mbyllën.
<b>dal</b>	- dola, dole, doli; dolëm, dolët, dolën.
<b>them</b>	- thashë, the, tha; thamë, thatë, thanë.
<b>shoh</b>	- pashë, pe, pa; pamë, patë, panë.
<b>vij</b>	- erdha, erdhe, erdhi; erdhëm, erdhët, erdhën.
<b>dua</b>	- desha, deshe, deshi; deshëm, deshët, deshën.

## VETAT E FOLJES

Vetë e foljes quhet forma foljore që tregon se kush e kryen veprimin (*unë, ne, ti, ju, ai, ajo; ata, ato*). Përgjithësisht, në gjuhën shqipe nuk është e domosdoshme që përemrat vectorë të përdoren para foljeve, siç ndodh në gjermanishten, anglishten ose frëngjishten.

Numër i foljes quhet forma foljore që tregon se veprimi kryhet nga një ose më shumë qenie ose sende. Folja ka dy numra: *njëjësin* dhe *shumësin*.

## FOLJET NJËVETORE

Folje njëvetore janë foljet që përdoren vetëm në vetën e tretë dhe që shënojnë:

- dukuri atmosferike: *bie* (shi, borë), *fryn* (erë), *bleron* (natyra), *gjelbëron* (bari), *ushton* (mali) etj.

- veprime karakteristike për kafshët: *hingëllin* (kali), *leh* (qeni), *pëllet* (gomari).

- foljet e tipit: (s'më) *besohet, bëhet, kujtohet, pëlqen* etj.

- folje të formës joveprore, si: *dihet, flitet, thuhet, kuptohet, parashikohet* etj.

- foljet: *jam, vij, shkoj, dal* në shprehjet, si: *s'është mirë, s'është keq, s'më vjen mirë, s'më shkon* etj.

## FOLJET PAVETORE

Folje pavetore janë:

- disa folje ose shprehje që emërtojnë dukuri atmosferike: *vetëtin, bubullin, veson, bën ftohtë, bën ngrohtë, resh* etj.

- foljet *duhet* dhe *do*;

- foljet jokalimtare të formës joveprore: *s'shkohet, s'rrihet, s'lyhet, s'flihet* etj.

Foljet njëvetore ose pavetore nuk marrin kryefjalë. T'u bësh këtyre foljeve pyetjen cili, cila për ta gjetur kryefjalën është pa kuptim: *Dje bëri ftohtë*.

## GJYMTYRËT KRYESORE TË FJALISË

### Mendohu

Shikoni vizatimet e dhëna dhe lexoni fjalitë.




Ardiani lahet.



Ermira mëson.



Nëna lexon.



Kali vrapon.

### Mendohu

Mendoni dhe përgjigjuni:

- Në fjalinë e parë flitet për \_\_\_\_\_
- Në fjalinë e dytë flitet për \_\_\_\_\_
- Në fjalinë e tretë flitet për \_\_\_\_\_
- Në fjalinë e katërt flitet për \_\_\_\_\_

Emrat **Ardiani**, **Ermira**, **nëna** dhe **kali** janë kryefjalë.

Pra, kryefjalë është fjala për të cilën flitet në fjali.

Si e dallojmë kryefjalën?

Kryefjala gjendet me njëren nga pyetjet: **kush?** (për njerëz), **cili?** **cila?** **cilët?** **cilat?** (për frymorë e gjësende). P.sh. *Kush mëson?* - **Ardiani**. *Cili vrapon?* - **Kali**.



Kryefjala rëndom mund të zëvendësohet me përemrat **ai, ajo, ata, ato**.

## Mendohu

Mendoni dhe përgjigjuni vetëm me një fjalë.

- Çfarë bën Ardiani? \_\_\_\_\_
- Çfarë bën Ermira? \_\_\_\_\_
- Ç'bën babai? \_\_\_\_\_
- Çfarë bën kali? \_\_\_\_\_

Fjalët **mëson, lahet, lexon** dhe **vrapon** janë kallëzues.

Kallëzuesi tregon se ç'thuhet për kryefjalën. Kallëzuesin e gjejmë më lehtë në fjali duke pyetur se **ç'bën?** apo **ç'pëson?** kryefjala.

## Detyrë

Lidhni fjalët e kolonës **A** me ato të kolonës **B** që të fitoni fjali.

A	B
Bariu	zë peshq.
Bujku	ndreq makina.
Mekaniku	gatuan bukë.
Aktori	punon tokën.
Shkrimtari	qeth flokët.
Gjellëbërësi	shkruan libra.
Bukëpjekësi	shet produkte.
Peshkatari	ruan delet.
Floktari	përgatit gjellë.
Shitësi	luan në film.

### PËR TË QESHUR

**MËSUESI:** Në fjalinë “Hajni është arrestuar”,  
ku është kryefjala?


**NXËNËSI:** Në burg, zoti mësues.

## KUPTIMI I PARË DHE KUPTIMI I FIGURSHËM I FJALËVE

Si në komunikimin tonë të përditshëm, ashtu edhe në letërsinë artistike (në prozë e në poezi) përveç në kuptimin themelor, fjalët shpeshherë përdoren në kuptim të bartur, në kuptim figurativ.

Po ta shfletojeni *Fjalorin shpjegues të shqipes* ose *Fjalorin shpjegues elektronik* do të vëreni se shumë fjalë kanë kuptimin e parë dhe një varg kuptimesh të tjera, ndër të cilat edhe kuptime të figurshme.

Së pari jepet kuptimi i parë (me numrin 1), pastaj kuptimet e tjera (2, 3, 4...) dhe në fund edhe kuptimi apo kuptimet e figurshme (5 apo të ndonjë numri tjetër pasues). P.sh.: fjala **GLLABËROJ** ka këto kuptime:



### Të mësuarit kreativ

Bashkë me arsimtarin në *Fjalorin shpjegues të shqipes* gjeni disa fjalë që kanë shumë kuptime dhe diskutoni për to.

## KRAHINORIZMAT

Krahinorizmat ose fjalët krahinore janë ato fjalë që përdoren vetëm në një krahinë a të folme të caktuar, si p.sh. *korube* “zgjua bletësh”, *bodile* “shishe”, *bonjak* “jetim”, *dybek* “tundës”, *kollomboq* “misër”, *korit* “turpëroj”, *xhit* “çka”, *dixhit* “diçka” etj.

Pjesa më e madhe e fjalëve dialektore e krahinore në shqipen janë të përbashkëta, por dallime më të mëdha hetohen në variantet fonetike të të njëjtës fjalë, të tipit *borë*, *bor*, *vdorë*, *xborë*, *zborë*; *shtëpi*, *shpi*, *shpaj*/*shpoj*/*shpëj*.

Do përmendur se para formimit të gjuhës së njësuar letrare (në Kongresin e Drejtshkrimin, Tiranë, 1972) pothuajse të gjitha veprat e shkrimtarëve tanë janë shkruar në gjuhën dialektore a krahinore.

Por, edhe pas formimit të gjuhës standarde shqipe, përdorimi i fjalëve dialektore e krahinore në letërsinë artistike është i lejueshëm.

## NEOLOGJIZMAT


Neologjizmat janë fjalë dhe shprehje të reja, që sapo kanë filluar të përdoren në gjuhën letrare. Fjalët e reja krijohen për të pasuruar fjalorin, për t'i zëvendësuar fjalët e huaja të panevojshme, fjalët e moçme etj.

Fjalë të reja, në shqipen janë, p.sh. *bashkëbisedim* (ka zëvendësuar fjalën dialog), *drejtshkrim* (në vend të ortografi), *drejtshqiptim* (në vend të ortoepi), *bashkëjetesë* (koekzistencë), *përnqjashmim* (asimilim), *vetëdije* (koshiencë), *cilësi* (kualitet), *sasi* (kuantitet), *përmasë* (proporcion), *risi* (novitet) etj.

Fjalët e reja ndërtohen me lëndën e gjuhës amtare. Neologjizma mund të krijojnë populli, përkthyesit, gjuhëtarët, shkrimtarët etj. Shkrimtari që ka sjellë numrin më të madh të neologjizmave me funksione artistike është, pa dyshim, Ismail Kadareja, si *borëtar*, *darkëtar*, *dyshimtar*, *kanuntar*, *qelqëri*, *mosfjetje*, *mospjellje*, *penglënës* etj.

## Të mësuarit kreativ

Në hartën e mëposhtme është paraqitur shtrirja territoriale e fjalës **kashtë** në disa fjalë krahinore, që formojnë sinonime: *tallë, kashtë, misrishtë, mishtrishtë, lëpushkë, degë, kallam*. Si i thonë në të folmen tënde?



## PËRDORIMI I ZANOREVE I DHE Y

Kur flasim e kur shkruajmë, shpeshherë nuk i përdorim drejt zanoret /i, y/. Gabojmë atëherë kur fjalët që kanë /y/ i përdorim me /i/. Këtë mospërdorim të drejtë të zanoreve /i, y/ e bëjmë për shkak se disa të folme tona nuk e kanë zanoren /y/, por në vend të saj kanë /i/.

Këto dy zanore dallohen njëra nga tjetra. Dallimi kryesor është se gjatë shqiptimit të /i/-së buzët nuk marrin pjesë, ato janë pasive. Kur shqiptojmë /y/-në buzët zgjaten përpara dhe rrumbullakohen. Pra, /i/-ja është zanore jobuzore, ndërsa /y/-ja është buzore.

Po kështu, në disa të folme tona /i/-ja diftongohet në njërin nga diftongjet [aj, ej, ëj, oj], si në fjalët *shtëpi* > *shpi* > *shpaj*; *mirë* > *majr*, *mik* > *majk*, *trim* > *trajm* e në shumë fjalë të tjera. Ka edhe fjalë ku /y/-ja ka kaluar në /i/ e pastaj është shpërbërë (diftonguar), si *sy* > *si* > *saj*, *fyell* > *fiell* > *fill* > *fajll* etj. Sipas rregullave, në shqipen standarde format e fjalëve me diftongje nuk janë normative.

### DIKTIM

#### DY

*Dy sy pushojnë në një lule,  
Dy duar përqafojnë një nënë,  
Dy veshë dëgjojnë një këngë,  
Dy këmbë vrapojnë kah shkolla.*

*Dy lapsa, dy libra, dy fletore,  
Dy çanta, dy goma, dy vizore,  
Shkojnë së bashku në shkollë,  
Të kapura dorë për dorë.*

## PËRDORIMI I DREJTË I TOGJEVE TË ZANOREVE **UA, UE, IE, YE**

Gjuha shqipe ka një varg fjalësh që përmbajnë togje (grupe) zanoresh, si ua, ue, ie, ye, etj.; si *dua, shkruaj*, (kam) *punuar*; *mësues, dëgjues, shikues*; *diell, miell*; *arsye, fyell, lyej, pyes* etj. Te togjet e zanoreve theksi bie në zanoren e parë.

Nën ndikimin e shqiptimeve dialektore, ndonjëherë grupet e zanoreve nuk i shqiptojmë dhe nuk i shkruajmë të plota, por ato i cungojmë (i shkurtojmë apo i përngjashmojmë).

P.sh.: *dua* > *du*, *shkruaj* > *shkruj*, (kam) *punuar* > (kam) *punu*; *mësues* > *msus*, *dëgjues* > *dëgjus*, *shikues* > *shikus*; *diell* > *dill*, *miell* > *mill*; *lyej* > *lyj*, *lij* etj.

Në shqipen standarde togjet e zanoreve duhet të shkruhen dhe të shqiptohen të plota, d.m.th. duke i ruajtur elementet përbërëse të grupeve, pa i përngjashmuar ose pa i cunuar ato.

Po sjellim disa fjalë me togje zanoresh në formën normative.

P.sh.: *ftua, grua, muaj, përrua, thua, bluaj, druaj, quaj, ruaj, mësuam, punuam; dëgjues, edukues, mësues; i dëgjueshëm, i gëzueshëm; arsye, dyer, krye, kryesor, lyej, ngjyey, i pëlqyeshëm, pyes, i shkëlqyeshëm; diell, qiell, miell* etj.

## PËRDORIMI I DREJTË I BASHKËTINGËLLOREVE

q, ç; gj, xh; r, rr; h, f, nj, v

### Drejtëpërdorimi i bashkëtingëlloreve q, ç dhe gj, xh

#### Lexojmë

*Lexoje me kujdes këtë poezi. Çfarë na këshillon ajo?*

#### STILOLAPSI

Stilolapsin mora  
të shkruaj fillova,  
më gaboi dora  
shumë keq shkrova.

Gomën atëherë  
e mora me shpejtësi,  
i rashë shumë herë,  
por shkrimi nuk u fshi.

Më treguan, është ngjyrë  
me të s'mund të luaj,  
me kujdes, mirë  
duhet të shkruaj.

Bashkëtingëlloret [q] dhe [gj] në disa të folme popullore i shqiptojmë si [ç], [xh]. Prandaj, si kur flasim, ashtu edhe kur shkruajmë, shpeshherë në vend të /q/-së përdorim /ç/-në, ndërsa në vend të /gj/-së përdorim /xh/-në.

P.sh.: qafë > çaf, qen > çen, qiri > çiri, qilim > çilim, qershi > çershi, qiell > çill, qift > çift, qymyr > çymyr, çimir, qyqe > çyçe, çipe; gjak > xhak, i gjallë > i xhall, gjarpër > xharpër, gjashtë > xhasht, gjeth > xheth, gjysh > xhysh, xhish etj.

Dihet se sipas rregullave drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore fjalët e mësipërme duhet të përdoren me /q/ose me /gj/.

## PËRDORIMI I DREJTË I BASHKËTINGËLLOREVE

r, rr

### Mendohu

Lexoni çiftet e fjalëve të dhëna dhe thoni kuptimin e tyre.  
arë ~ arrë, rasë ~ rrasë, deri ~ derri, rimë ~ rrimë ~ rrymë

Në disa të folme tona, bashkëtingëllorja /rr/ zbutet në /r/. Mirëpo, në gjuhën standarde shqipe këto dy bashkëtingëllore dallohen. Ato janë fonema të veçanta dhe shkruhen me shkronja të posaçme. Ka disa çifte fjalësh (si ato që i shënuam më lart) që dallohen për nga kuptimi nëse kanë /r/ ose /rr/.

### Mëso më shumë

Në gjuhën letrare shqipe /rr/-ja shqiptohet dhe shkruhet në fillim, në mes dhe në fund të fjalës:

a) në fillim të fjalës, si: *rrafsh, rregull, rreth, rreze, rrezik, rrënjë, rrotë, rrugë, rrymë; rri, rrit, (i, e) rrallë, rreth e rrotull* etj.

b) në mes të fjalës: *arrë, burrë, furrë, karrige, përrallë, përrua, qerre, arrij, harroj, ngatërroj, kurrë* etj.

c) në fund të fjalës: *ëndërr, kokërr, oborr, sherr, terr, tmerr, varr; korr, marr* (por mora), *nxjerr* (por nxora) etj.

### Detyrë

Në të folmen tënde a i dalloni bashkëtingëlloret /r, rr/?



## PËRDORIMI I DREJTË I BASHKËTINGËLLOREVE

### **h, nj, f, v**

Nën ndikimin dialektor, bashkëtingëlloret /h, nj, f, v/ ndonjëherë nuk i shqiptojmë e nuk i shkruajmë siç duhet. Në disa të folme të shqipes /h/-ja nuk shqiptohet fare ose dëgjohet dobët.

### **Të mësuarit kreativ**

Duhet të nyjëtohen e të shkruhen me /h/ fjalët: *ha, hap, hartë, harroj, hënë, hudhër, i hollë, hundë, hallë; aheng, lahem, ah, krah, fsheh, shoh* etj.

Herë-herë në vend të /h/-së gabimisht përdorim /f/-në. Kështu fjalët *njoh, shoh, i ftohtë, i nxehtë, i mprehtë* e ndonjë tjetër i nyjëtojmë e i shkruajmë në formë të gabuar: *njof, shof, i ftoftë, i nxeftë, i mpreftë*.

Edhe /nj/-ja në të folmet dialektore nuk përdoret kudo njësoj. Atë jorrallë e zëvendësojmë me /j/-në ose /n/-në, si p.sh.: *e zoja < e zonja, baj < banjë, ftoj < ftonj, thoj < thonj; ni < një, nizat < njëzet* etj.

Në përdorimin e bashkëtingëllores /v/ ka më pak shmangie. Atë zakonisht e përdorim drejt, si: *vezë, vesh, i vogël, vazo; punova, mësova, shkrova* etj.

Të gabueshme janë format e fjalëve *kavi, shivi, thivi; shkovi, punovi, msovi, gruva* etj., ndërsa forma normative janë *kau, shiu, thiu; shkoi, punoi, mësoi, grua*.

## PËRDORIMI I DREJTË I TOGJEVE TË BASHKËTINGËLLOREVE

Kur dy bashkëtingëllore përdoren shpesh njëra pranë tjetrës, formojnë grupe a togje bashkëtingëlloresh. Të tilla janë togjet mb, nd, ng, ngj, pl, pj, fl, fsh, bl, br, vj, shk etj. Më shpesh përdoren togjet mb, nd, ng, ngj.

Grupet e bashkëtingëlloreve përdoren në fillim, në mes dhe në fund të fjalës. Përdorimi i drejtë i grupeve të bashkëtingëlloreve në gjuhën e sotme letrare shqipe del i vështirësuar për arsye se në shumë të folme geqe për lehtëshqiptim ato janë përngjashmuar (asimiluar) në bashkëtingëllore të rëndomta, ose ndonjëra nga to është shkrirë në një tingull të vetëm.

### MBANI MEND

Në shqipen standarde është ngritur në normë që togjet e bashkëtingëlloreve të ruhen të plota, si në nyjëtim ashtu edhe në shkrim, në të gjitha pozitat: në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

P.sh.:

**mb:** mbush, mbaroj, mbesë, mbetem, (për)mbi, mbij, mbyt; i ëmbël, këmbë, gjemb, humb, krimb, plumb, shkëmb etj.;

**nd:** ndaj, ndesh, ndër, ndërmarrje, ndërmjetës, ndërtoj, ndjek, ndjell, ndodhem, ndriçoj; andej, këndej, mandej, mundoj, përmendsh, prandaj; kuvend, mend, mund, vend, përmend etj.;

**ng:** nga, ngacmoj, ngarkesë, ngij, ngut; kungull, i mangët, mëngë, shtëllungë, trangull; cung, deng, peng, trung etj.;

**ngj:** ngjaj, ngjall, i ngjashëm, ngjyrë; engjëll, tungjatjeta, thëngjill; qengj etj.

**pl:** plak, pleqëri, plep, pleh, pluhur, plesht, plumb, plis, plot etj.

**bl:** bletë, bluaj, bli, blej etj.

**fl:** flutur, flakë, fletë, fletore, fle, fletëpalosje, fletëparaqitje etj.

### Mendohu

Ç'është drejtshkrimi?

Siç dihet, alfabeti është inventar i shenjave grafike, ndërsa drejtshkrimi është përmbledhje rregullash për kombinimin e këtyre shenjave.

**Drejtshkrimi** është një sistem rregullash për të shkruar drejt e njësoj po të njëjtat fjalë dhe trajtat e tyre gramatikore, për përdorimin e shkronjave të mëdha, si edhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit.

### Parimet e përgjithshme të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe mbështetet në:

- 1) *parimin fonetik,*
- 2) *parimin morfologjik dhe*
- 3) *parimin historik-tradicional.*

Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik: në përgjithësi fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar. Mbi 76% e fjalëve në gjuhën shqipe shkruhen sipas parimit fonetik, ndërsa vetëm 23% shkruhen sipas parimit morfologjik, historik-tradicional, semantik dhe simbolik.

Për të shkruar pa gabime duhet mësuar rregullat e drejtshkrimit. Përvetësimi i rregullave kërkon mjaft mund dhe përpjekje, megjithatë, po të njihet struktura e tyre, detyra e mësimit të rregullave të drejtshkrimit lehtësohet mjaft. Për çdo rast kur ndodhemi në mëdyshje duhet t'i drejtohem fjalorit të gjuhës së sotme shqipe (të shkruar në letër ose fjalorit shpjegues elektronik), Drejtshkrimit të gjuhës shqipe etj.

Gjuha shqipe ka edhe *Fjalor drejtshkrimor* (Tiranë, 1972; Prishtinë, 1973), *Fjalor drejtshkrimor elektronik AS 2.0* dhe *Fjalor shpjegues elektronik etj.*



Këta fjalorë elektronik mund të instalohen në kompjuter dhe pa vështirësi mund t'i shfrytëzoni edhe ju nxënës të dashur. Me këtë program të rëndësishëm edhe gjuha shqipe bën pjesë në mesin e gjuhëve të kompjuterizuara.

Me programin e drejtshkrimit të shqipes mund të korrigjohen *mbi një milion fjalë*, përkatësisht rreth *katër milion trajta të përsëritshme*.

Shfrytëzuesit nuk i duhet trajnim i veçantë për përdorimin e këtij programi, mjaftojnë vetëm disa minuta për përvetësimin e tij.



## Mësim në laborator

*Në laboratorin kompjuterik të demonstrohet mënyra e përdorimit të programit kompjuterik për drejtshkrimin e shqipes.*



# LEXIM LETRAR



## VEÇORITË E POEZISË ARTISTIKE

Njerëzit shkruajnë poezi për të shprehur ndjenjat e tyre: gëzim, hidhërim, dashuri, vuajtje. Kush ka shkruar poezi, ai e di që ajo zakonisht vjen pas një frymëzimi shpirtëror. Megjithatë, njerëzit shkruajnë poezi edhe për të luajtur me fjalët, për të krijuar imazhe dhe për t'u argëtuar. Poezitë më së shumti shkruhen në vargje me gjatësi të barabartë ose të ndryshme dhe përdorin mjete stilistike.

Në poezi gjejmë shpesh fjali të ngarkuara me figura letrare që nxitin imagjinatën, ndërsa roli i pikësimit është për t'i treguar lexuesit ku të ndalojë ose ku të krijojë ritëm.

Poezia tingëllon bukur. Tingujt që përsëriten ose rima, e bëjnë poezinë më të këndshme për të dëgjuar. Shpesh, për hir të rimës poetëve u lejohet që të mos respektojnë rregullat gramatikore ose drejtshkrimore kur këto janë në dobi të tingëllimit të bukur të poezisë. Për të shijuar veçoritë e poezisë artistike, lexojeni vjershën e mëposhtme të Asdrenit.

### Dua

Mbi bar dua të prehem,  
të këndoj, të dëfrehem,  
të shoh rreth bagëtinë,  
kur hanë dhe pinë;

të shoh fushat e blerta,  
bimët kur i fryn era,  
njerëzit kur punojnë  
dhe çupat kur këndojnë!

Ah, dua dhe lulet,  
kur i shfaqin pekulet,  
dhe fluturat që venë,  
mbi to dua të jenë;

bilbili t'ia thotë  
nën diellin e ngrohtë.  
Dua dhe Shqipërinë,

se atje kam shtëpinë,  
kur rrija nëpër ferrat  
edhe lozja me shqerrat;

për këtë kam dëshirë  
dhe s'dua më mirë,  
atje dua të shkoj,  
sa të jem e të rroj!

*Asdreni*

## Të mësuarit kreativ

### SI TË SHKRUAJMË NJË POEZI?

Përpjekjet tuaja të para për të shkruar poezi mund t'i filloni me tema shumë të tjeshta, p.sh. me përshkrimin e një sendi të njohur ose që ju pëlqen. Poezitë e para mund t'i mendoni edhe si lojë fjalësh. Pjesa më e madhe e njerëzve, sidomos fëmijët, zbaviten kur shkruajnë poezi. Hidhni në letër çdo gjë që vini re për objektin e zgjedhur, p.sh. një varg mbiemrash përshkrues, dhe përpiquni të gjeni fjalë që rimojnë me to.

#### ***Të marrim një shembull.***

Ta zëmë se kemi vendosur të shkruajmë diçka për duart. Gjëja e parë që mund të bëhet është mbledhja e fjalëve përshkruese dhe hedhja e tyre në letër në formë të një liste. P.sh.:

*duart, të vogla, të njoma, të vyeshme,  
të dobishme, të bukura, punëtore,  
fletore, qepin, shkruajnë  
vizatojnë, punojnë, të palodhshme*

Fillojmë t'i radhisim në varg që të kenë kuptim dhe rimë:

*Duart tona janë të të vyshme  
janë të bukura, janë të njoma  
Ato janë shumë puntore  
në fletore shkruajnë bukur*

*presim me gërshan  
me xhilpan qepim rroba  
Vizatojmë hanën, mbajmë lapsin,  
Me to përqafojmë nanën.*

### **Më pas i rishikojmë dhe i radhisim më mirë**

Orgonizojini fjalët, shprehni ndjesitë tuaja dhe përpiquni që vargjet të bëhen sa më bukurtingëlluese e të rimuara. Njëkohësisht bëjmë edhe përmirësimin e gabimeve drejtshkrimore. Ja se si mund të riorganizohen vargjet e mësipërme:

#### **Duart tona**

Duart tona janë të vogla,  
janë të bukura, janë të njoma.

Duart tona janë punëtore,  
shkruajnë bukur në fletore.

Me to presim me gërshërë,  
edhe qepim me gjilpërë.

Mbajnë lapsin, vizatojnë hënën  
Për çdo ditë përqafojnë nënën.

#### **Detyrë**

Krijoni një poezi sipas udhëzimeve të dhëna më sipër. Si frymëzim mund t'ju shërbejë fotografia e mëposhtme.





## LLOJET E POEZIVE LIRIKE

Klasifikimi tradicional i poezive lirike mbështetet në temën që trajtohet. Poezitë (vjershat) sipas motiveve që trajtojnë quhen:

- a) poezi shoqërore,
- b) poezi patriotike,
- c) poezi e dashurisë,
- ç) poezi e peizazhit.

### POEZIA E DASHURISË

Poezia lirike e dashurisë nëpërmjet figurave poetike shpreh ndjenjat më intime të të dashuruarve. Këto poezi mund të flasin për hollësitë e ndjenjave, gëzimin, bukurinë, por edhe për pikëllimin, i cili haset shpesh kur dy të rinj pengohen në dashuri.

Në lirikën tonë gojore dhe artistike, motivi erotik zë një vend të rëndësishëm. Këngët e dashurisë janë të shkurtra me një kumbim harmonik. Dashuria konsiderohet si ndjenja më fisnike e njeriut. Zakonisht djali i këndon vajzës, duke e përshkruar dhe hyjnizuar bukuritë dhe virtytet e saj.

### VALLJA E LULEVE

Vijnë vashat valle-valle  
Gushë-e-gji-stolisura.  
Një pëllumb, një sy-zorkalle  
Seç vjen më mbollisura.

Ç'm'i ka hije shtat'i hedhur,  
Hije kraharuari,  
Pa fillon me zë të dredhur  
Motra së kënduari:

Ju që niseni për lule,  
Shoqe moj të mijëza,  
Merr-më-ni as edhe mua  
Nër pyje-e korijëza;

Pritni moj të vi dhe unë  
Maleve, lëndinave,  
Ndaj çkëlqen pa të përdhunë  
Fill-i trendelinave;

Në mos diçka të bëj tufë,  
Shoqe ju dëgjomëni:  
Bëni moj një tog me lule  
Dhe me to mbulo-më-ni;

Në ju pyeçin për mua:  
Ç'u bë flog-banusheja?  
Thoni, se më një përrua  
E zu gjarpërusheja:

Thoni, se ndaj një mburimi  
Më t'e patë fluturën:  
Thoni, seç e zuri trimi  
Atë bel-këputurën.

*Lasgush Poradeci*

## Pyetje dhe detyra

- ▶ Çka përshkruan poeti në këtë vjershë.
- ▶ A janë të stolisura vashat?
- ▶ A e dallon poeti ndonjë të prej tyre?
- ▶ Si e përshkruan poeti dukjen e saj?
- ▶ A ka kërkuar ai të shkojë bashkë me to të mbledhë lule?

## Interpretim

- ▶ Çka simbolizojnë lulet në këtë vjershë?
- ▶ Cilat figura stilistike përdoren në këto vargje?
- ▶ Thoni disa vargje të ndonjë kënge lirike të dashurisë.

## Të shprehurit krijues

Dëgjojeni një këngë popullore me temë dashurie dhe shkruajeni tekstin e saj.



## POEZIA SOCIALE

Poezia sociale është krijim letrar i gjinisë lirike në të cilën poeti shpreh qëndrimin dhe botëkuptimet e veta ndaj shoqërisë, dukurive të ndryshme të jetës shoqërore dhe marrëdhënieve të njerëzve. Poeti social zakonisht frymëzohet nga gjendja shoqërore e një klase të shtypur e të shfrytëzuar, nga mjerimi i madh ose padrejtësitë e ndryshme prej të cilave vuajnë të shtypurit.

Lirika sociale a shoqërore si zhanër nënkupton atë poezi që frymëzohet nga gjendja dhe realiteti (shoqëror) i kohës kur jeton dhe krijon shkrimtari. Shembull më karakteristik i kësaj lirike në letërsinë tonë kombëtare, padyshim është vepra poetike e Migjenit, ku si ilustrim po e marrim vetëm një pjesë të vjershës së tij "**Poema e mjerimit**":

*Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,  
kafshatë që të mbetë në fyt edhe të ze trishtimi  
kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta  
që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita  
edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin  
të tanë jetën e vet derisa të vdesin.  
E mbi ta n'ajri, si në qesendi,  
therin qiellën kryqat e minaret e ngurta,  
profetënt dhe shejtënt në fushqeta të shumngjyrta  
shkëlqejnë. E mjerimi mirfilli ndien tradhti.  
Mjerimi ka vulën e vet të shëmtueme;  
asht e neveritshme, e keqe, e turpshme;  
balli që e ka, syt që e shprehin,  
buzët që më kot mundohen ta mshefin -  
janë fëmitë e padijes e flitë e përbuzjes,  
të mbetunat e flliqta rreth e përqark tryezës,  
mbi të cilën hangri darkën një qen i pamëshirshëm  
me bark shekulluer, gjithmon i pangishëm.  
Mjerimi s'ka fat. Por ka vetëm zhele,  
zhele fund e maje, flamujt e një shprese  
të shkymë dhe të coptuem me të dalun bese.*

**Migjeni**

### Fjalor

**kapërdihet** - gëlltitet

**qesendi** - qëndrim tallës që shprehet me fjalë thumbuese, ironi.

**fushqetë** - fishekzjarr që hidhej natën lart në ajër për t'i dhënë një shenjë të caktuar dikujt ose për të ndriçuar.

**zhele** - copë e shqyer që varet në një rrobë të vjetër.

## Pyetje dhe detyra

1. Çfarë temash trajtohen në poezinë sociale?
2. Çfarë teme trajtohet në këtë poemë?
3. A kemi edhe tani njerëz të varfër?
4. Si e përshkruan skamjen Migjeni në vargjet e tij?
5. Kërkoni në faqet e internetit dhe lexoni për jetën dhe veprat e Migjenit.

### MIGJENI (1911-1938)

Millesh Gjergj Nikolla, i njohur si Migjeni, lindi më 13 tetor 1911 në Shkodër, në një familje të varfër qytetare. Ishte poet dhe prozator. Shkollën fillore e kreu në qytetin e lindjes, ndoqi mësimet e mesme teologjike në Manastir. Punoi si mësues në Vrakë, Shkodër dhe në Pukë. Vdiq më 26 gusht 1938 në moshën 27-vjeçare në Torino të Italisë. Libri i tij me vjersha titullohet "Vargjet e lira".

Ndër krijimet më të njohura në prozë dhe në poezi janë: "Poema e mjerimit", "Luli i vocërr", "Bukuria që vret", "Mollë e ndalueme", "Legjenda e misrit", "A don qymyr zotni", "Të çelen arkapijat", "Studenti në shtëpi", "Zoti të dhashtë" etj. Shkrimet poetike dhe ato në prozë të Migjenit janë përkthyer në disa gjuhë të huaja.



## POEZIA E PEIZAZHIT

Lirika e peizazhit ose lirika përshkruese është ajo që frymëzohet nga përshkrimi i pamjes së natyrës dhe dukuritë e saj. Poeti nuk është thjesht një fotograf i natyrës, ai shpreh botën e vet shpirtërore që ka për të. Të përkujtojmë poezitë e Naim Frashërit ose të poetëve të tjerë, që duke shkruar për bukuritë e natyrës, shprehin mallin e tyre për vendlindjen dhe bukuritë natyrore.

### FSHATI IM

Malet me gurë,  
fushat me bar shumë,  
arat me grurë,  
më tutje një lumë.

Fshati për karshi;  
me kish' e me varre,  
rrotull ca shtëpi,  
të vogla fare.

Ujët të ftoftë,  
era pun' e madhe,  
bilbili ia thotë,  
gratë si sorkadhe.

Burrat nën hije,  
lozin kuvendojnë;  
pika që s'u bie,  
se nga gratë rrojnë!

Gratë venë në arë,  
dhe në vreshta gratë,  
gruaja korr barë,  
punon dit' e natë.

Gratë në të shirë,  
në të vjela gratë,  
ikin pa gdhirë,  
kthehen me natë.

Gruaja për burrë,  
digjet në diell,  
punon e s'rri kurrë,  
as ditën e diel.

O moj shqipëtarë,  
që vet i nget qetë,  
edhe drek' e darkë,  
kthehesh e bën vetë.

Moj e mjera grua,  
ç'e do burrë zinë,  
që ftohet në krua  
dhe ti mban shtëpinë.

Andon Zako Çajupi

**Çajupi** është një ndër shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare që u angazhua shumë për fatin e femrës shqiptare të asaj kohe. Në vjershën "*Fshati im*" poeti përshkruan pamjen e fshatit si dhe punën e vështirë në fshat. Gjithashtu, flitet haptas për pozitën e vështirë të gruas, për vuarjtjen e femrës, e cila ishte e ngarkuar me punët e shtëpisë e të fushës, e shtypur gjithnjë nga zakonet prapanike.

## Pyetje dhe detyra

- ▶ Sa strofa ka kjo vjershë?
- ▶ Nga sa vargje kanë strofat?
- ▶ Çfarë rime ka kjo vjershë
- ▶ Mësoni përmendsh katër strofat e para të kësaj vjershe dhe recitoni.

▶ Pasi ta keni lexuar me kujdes temën e shtjelluar, shkruani gjërat më të rëndësishme për strofën, vargun dhe rimën.

### **Andon Zako Çajupi** (1866 - 1930)

Lindi në Sheper të Zagorisë më 27 mars 1866. Mësimet e para i mori në vendlindje, vazhdoi në kolegjin francez në Aleksandri, ndërsa drejtësinë në Gjenevë.

Shkroi elegjinë "Vaje", përmbledhjen poetike "Baba Tomorri" (1902) ku përfshiu komedinë "Katërmëdhjetë vjeç dhëndërr", poemën "Baba Musa lakuriq", tragjedinë "Burri i dheut", komedinë "Pas vdekjes", përmbledhjen poetike "Këngë e vome", Përrallat e La Fontenit (1921) dhe "Lulet e Hindit" (1922). Vdiq në Kajro më 11 korrik 1930.



## POEZIA PATRIOTIKE

Poezitë patriotike për motiv kanë dashurinë për vendin, për atdheun, historinë dhe traditën, për gjuhën dhe lirinë. Tematikë patriotike kanë pjesa më e madhe e poezisë sonë të Rilindjes, ku shkrimtarët, ashtu si tërë populli, synon çlirimin e vendit nga robëruesi.

### **O moj Shqypni**

*O moj Shqypni, e mjera Shqypni,  
Kush të ka qitë me krye n'hi?  
Ti ke pas kenë një zojë e randë,  
Burrat e dheut të thirrshin nanë.  
Ke pasë shumë t'mira e begati,  
Me varza t'bukura e me djelm t'ri,  
Gja e vend shumë, ara e bashtina,  
Me armë të bardha, me pushkë ltina,  
Me burra trima, me gra të dlira;  
Ti ndër gjith shoqet ke kenë ma e mira.  
Kur kriste pushka si me shkrep moti,  
Zogu i shqyptarit gjithmonë i zoti  
Ka kenë për luftë e n'luftë ka dekun  
E dhunë mbrapa kurr s'i mbetun.  
Kur ka lidhë besën burri i Shqypnisë,  
I ka shti dridhën gjithë Rumelisë;  
Ndër lufta t'rrehta gjithëkund ka ra,  
Me faqe t'bardhë gjithmonë asht da.*

Pashko Vasa

Poezia "O moj Shqypni" u bë një nga kryeveprat poetike të Rilindjes. Kjo vjershë lindi në ditët e stuhishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe qarkulloi gojë më gojë, ngandonjëherë edhe si këngë. Në të ndihet jehona e ngjarjeve dramatike që kalonte vendi ynë, kur shqiptarët mbronin me gjak trojet e tyre nga lakmitë e shovinistëve fqinjë dhe nga vendimet e padrejta të Kongresit të Berlinit. Vjersha sintetizon në

mënyrë poetike gjithë idetë e mëdha të lëvizjes kombëtare. Ajo është ndërtuar mbi bazën e antitezës. Për nga brendia ajo përmban dy pjesë, dy tablo të Shqipërisë. Në të parën, si gjithë rilindësit, autori prezanton të kaluarën, kurse në pjesën e dytë përshkruhet me ngjyra rrëqethëse gjendja e mjerë e atdheut të robëruar.

Vjersha fillon me ton elegjiak, me një pyetje plot dhembje drejtuar Shqipërisë, që e kanë *"qit me krye n'hi"*, që s'e ka më forcën dhe lavdinë e mëparshme.

Pashko Vasa është një nga të parët që lëshoi kushtimin për t'u bashkuar pa dallim feje. Në pikëpamje të kompozicionit, vjersha përbëhet prej dy pjesësh dhe theksi vihet më tepër tek e dyta, por ajo i drejtohet edhe së ardhmes. Vjersha "O moj Shqypni" është një nga krijimet më të frymëzuara të poezisë shqiptare. Figuracioni i pasur e shprehës, epitetet, krahasimet, pyetjet retorike plot ngarkesë emocionale, shkodoranishtja e kuptueshme dhe e ëmbël e bënë atë aq ndikues tek masat. Vargu dhjetërrokësh (pesërrokësh i dyzuar) i jep poezisë një ritëm marshi, në përputhje me përmbajtjen, duke sintetizuar thuajse gjithë idetë e lëvizjes kombëtare: krenarinë për të kaluarën, dashurinë për vendin, urrejtjen për robërinë, thirrjen për bashkim.



#### **Pashko Vasa (1825-1892 )**

Pashko Vasa (i njohur edhe si Vaso Pasha) lindi në Shkodër më 1825. Njohu disa gjuhë të huaja. Në Turqi, Stamboll, Vasa u ngrit në shkallën e lartë të hierarkisë shtetërore. Nga viti 1883 e deri sa vdiq, më 1892 në Bejrut, ishte guvernator i përgjithshëm i Libanit. Shkroi poezi, prozë artistike, publicistikë dhe libra gjuhe.

Veprat më të rëndësishme të P. Vasës janë: përmbledhja me vjersha "Trëndafila dhe gjemba"(1873), romani "Bardha e Temalit" (1890) i shkruar frëngjisht.



## ELEMENTET PAMORE DHE DËGJIMORE TË POEZISË

### a) Elementet pamore (vizuale) të poezisë

Poezia dallohet dukshëm nga proza. Nga ana e jashtme shihet se poezia shkruhet në një pjesë të faqes, zakonisht në mes, në vargje që vijnë njëri pas tjetrit. Pra, në të shkruar poezia ka pamjen e një kolone në vargje. Veçori e brendshme e poezisë është se ajo zakonisht nuk ka ngjarje, nuk ka personazhe. Raporti i poetit ndaj realitetit është subjektiv, përplot me emocione dhe poeti aty flet vetë, në vetën e parë dhe në kohën e tashme.

Ka disa lloje poezish. Lloji më tradicional i poezisë është poezia e shkurtër ose e vogël, që zakonisht e njësojnë me poezinë lirike, ku shquhet disponimi emocional, intim dhe subjektiv i poetit.

### b) Elementet dëgjimore (auditive) të poezisë

Elementet kryesore auditive mbi të cilët ndërtohet poezia janë: **ritmi, rima, theksi, rrokja** etj.

Në poezinë shqipe kemi tri lloje vargjesh: varg popullor, varg të huazuar dhe varg të krijuar. Rol vendimtar në ndërtimin e vargut luajnë numri i rrokjeve në varg dhe renditja e rrokjeve të theksuara e të pathek-suara. Numri i rrokjeve përcaktohet nga numri i zanoreve.

Poezia ka një gjuhë të përpunuar përplot me figura stilistike, ritëm, muzikalitet e melodi. Me ritëm nënkuptojmë anën melodike, muzikore të poezisë, d.m.th. harmoninë e brendshme të vargut.

Në vargjet e Asdrenit:

*Ardhi koha, ardhi dita,  
Iku nata, doli drita,  
Ngrihu trima, mos përtoni,  
Këtë kohë ta shpëtoni!*

ka simetri të plotë të vargjeve, që përforcohet nga rima.

## Detyrë

*Lexoni me vëmendje prozën “Vendlindja ime” dhe poezinë “Shtëpia ime”.*

1. Si është shkruar proza e si poezia?
2. Krahasoni pamjen e jashtme të prozës “Vendlindja ime” dhe të poezisë “Shtëpia ime”.
3. Thoni çfarë dallimi hetoni ndërmjet tyre?

### VENDLINDJA IME

Një djalosh udhëtoi shumë. Kaloi nëpër vendet më të bukura dhe më të largëta të botës. Kur u kthye në vendlindjen e vet, një shok i tij e pyeti se cili vend i kishte pëlqyer më tepër. Djaloshi iu përgjigj:

- Kam parë shumë vende të bukura e të mrekullueshme në botë. Por, më të bukura nga të gjitha, janë muret e bardha të shtëpisë ku kam lindur. Prej të gjitha luleve të bukura të atyre shtëpive të pasura në mërgim, asnjëra nuk më është dukur aq e bukur, sa karafili që ka mbjellë babai im dhe që e ka ujitur nëna ime.

Ndoshta ti nuk i ke parë ato vendet e bukura, për të cilat shpeshherë flasin mërgimtarët - e pyeti me habi shoku i vet.

- Pashë shumë vende, por po të them se të shëtitesh mbarë botën, për ne nuk ka asnjë vend më të bukur dhe më të dashur se vendlindja jonë.

## SHTËPIA IME

Atje kah fundi i katundit  
Aty afër nj'atij lumit,  
Atje larg kam një shtëpi  
Ku banojnë prindërit e mi.

Është e vogël pa zbukurime,  
Por e madhe në zemrën time,  
Ty të dua, o moj fole  
Se je vendi ku kam le.

Të kam ndërmend e s'të harroj,  
Natë e ditë ty t'kujtoj,  
Shumë të dua, pa ty s'rri,  
Se te ti janë prindët e mi.

S'të ndërroj, jo; as me pallate,  
Le të jenë edhe me shumë kate,  
Se mbi t'gjitha në këtë dhe  
Është shtëpia ku kam le.

### Detyrë

*Dëgjoni ndonjë poezi të recituar nga ndonjë aktor i njohur shqiptar. Diskutoni për mjetet dëgjimore (auditive), si ritmin, rimën, theksin, rrokjen, intonacionin.*



## FIGURAT STILISTIKE

Të shprehurit e figurshëm është veçori dalluese e letërsisë artistike, por është e shpeshtë edhe në gjuhën e folur e në krijimtarinë gojore. Figurat stilistike janë të shumta. Figura të tilla stilistike janë epiteti, metafora, krahasimi, antiteza etj.

**Epiteti** (greq. epítheton – shtesë, ndajshim) është fjalë përcaktuese që i shtohet emrit, për të cilësuar a vënë në dukje një tipar karakteristik të tij. P.sh. në katër vargjet e veprës së Naimit “Historia e Skënderbeut” në dy raste është përdorur epiteti:

*Krujë o qytet i bekuar  
prite, prite Skënderbenë,  
po ujen si pëllumb i shkruar  
të shpëtojë mëmëdhenë.*

ndërsa më poshtë në pesë vargjet - pesë herë:

*Ishte Uran-bukuroshi  
dhe Tanushi kordhë-larë  
Hamzaj, Muzakë-djaloshi  
.....  
Maneshi, shpatulla-gjerë,  
Golemi mjekërë-ziu,*

Në gramatikë epiteti është mbiemër cilësor (i nyjshëm a i panyjshëm, përcaktor, atribut), që lidhet drejtpërdrejt me emrin.

**Metafora** (nga greq. metaphorá – bartje, ndërrim kuptimi) ka përdorim të gjerë jo vetëm në letërsinë artistike, po edhe në të folurit e përditshëm dhe në folklor. Metafora sajohet kur emërtojmë një send me emrin e një sendi tjetër në bazë të ngjashmërisë. Kështu, kur themi: *Agroni është si gacë e mbuluar*, fitojmë një krahasim. Mirëpo, po ta heqim lidhëzën e krahasimit si, do të kemi metaforën: *Agroni është gacë e mbuluar*. Pra, metafora është rezultat i një krahasimi të menduar dhe fitohet duke e ruajtur vetëm pjesën e dytë të krahasimit, si

p.sh.: *ujk i vjetër* (= është ujk i vjetër; *dhelpër* (= dinak si dhelpër) etj.

Metafora të tilla hasim në dy vargjet e strofës së parë të poemës “Andrra e Jetës” të Ndre Mjedës:

*Molla t'kputuna nji deget  
dy qershija lidhë n'ji rrfanë, ...*

**Krahasimi** (lat. comparatio) sajohet kur një send, një mendim, një dukuri e krahasojmë me një gjë tjetër, me qëllim që të parën ta njohim ose ta sqarojmë më mirë.

Kjo figurë përbëhet prej dy pjesësh: e krahasueshmja (gjëja që krahasohet) dhe krahasuesja (gjëja me të cilën krahasohet), që lidhen ndërmjet tyre me anën e lidhëzave krahasore mënyrore: si, posi, porsi, sikur, sikurse, ashtu, ashtu si etj. P.sh. *Ma ka shtatin si selvi, ma ka syrin si filxhan, m'i ka dhëmbët si inxhi, m'i ka buzët si qershijë ...* Pjesa e dytë është e figurshme.

**Antiteza** (nga greqishtja antithesis – kundërshti) është figurë e përbërë nga dy gjëra apo mendime të kundërta. Si mjet stilistik përdoret për t'i dhënë shprehjes forcë e qartësi. Antiteza përbëhet nga paraqitja e dy anëve të kundërta, që shprehen me antonime, pra me fjalë me kuptim të kundërt. P.sh.: *Koha, atë mëngjes, aty qante, aty qeshte.*



## NDARJA E LETËRSISË SIPAS GJINIVE

Vepër letrare mund ta quajmë edhe një poezi të shkurtër prej tre- katër vargjesh, njësoj si edhe një roman vëllimor. Format dhe llojet letrare janë të shumta. Krijimet letrare kanë dy forma kryesore: prozën dhe poezinë.

Ndarja e letërsisë në prozë e në poezi bëhet në bazë të veçorive të tyre të jashtme dhe të brendshme. Tipar i jashtëm (pamor, vizual) është se proza shkruhet në tërë faqen, me rreshta të ngjeshur, me fjali të një- pasnjëshme e periudha të gjata. Poezia shkruhet në vargje, në një pjesë të faqes.

Veçori e brendshme është se proza i shtjellon gjërat shtruar (gjerë e gjatë), aty flet edhe autori edhe personazhet. Në gjuhën e prozës ndërthuren rrëfimi, monologu dhe dialogu. Aty kemi përshkrim të hollë- sishëm të një ngjarjeje me disa personazhe, përmes të cilëve shkrimtari rrëfen në vetën e tretë dhe në kohën e shkuar.

Me pak fjalë mund të thuhet se në prozë mbizotëron objektiviteti i shkrimtarit, me ngjyrim subjektiv; ndërsa në poezi (lirike) mbizotëron forma e shprehjes subjektive, bota e brendshme intime.

### Detyrë

*Lexoni tri tekstet e mëposhtme.*

Babai i Albanit punon çdo ditë. Ai del nga shtëpia herët në mëngjes dhe kthehet natën vonë. Albani e sheh vetëm në darkë. Ai do të luajë me të, por shpeshherë, babanë e lodhur e kap gjumi.

\* \* \*

*Erdhi babai në shtëpi,  
Është i lodhur, kushedi,  
Se punon e lodhet shumë,  
Që të jem i lumtur unë.*

\* \* \*

MËSUESI: Po, pesëshe. Por, sigurisht ti nuk e di që më parë.

EDMONDI: E di... e di edhe për nesër.

MËSUESI: Si mund ta dish përpara?

EDMONDI: E di. Nesër në mëngjes, para fillimit të mësimit, do të më vijë tezza nga Ulqini.

## Mendohu

- A dallohen këto tri pjesë?
- Me se dallohen ato?

### Të mbajmë mend

Njeriu bën vepra të ndryshme, të cilat shkaktojnë kënaqësi shpirtërore. Një lloj i veprimtarisë së tillë është edhe vepra letrare. Letërsia është një lloj i veprimtarisë së njeriut, e cila krijohet me anë të fjalës.

Letërsia ndahet në dy tipe:

- 1) **letërsi gojore** dhe
- 2) **letërsi e shkruar**

**Letërsia gojore** krijohet, bartet nga gjenerata në gjeneratë nëpërmjet gjuhës së folur, ndërsa **letërsia e shkruar** paraqitet nëpërmjet shkrimit.

Vepra letrare janë vetëm ato, që, kur lexohen ose dëgjohen shkaktojnë kënaqësi artistike.

Veprat letrare ndahen në tri gjini. Ato janë:

- a) **lirika**,
- b) **epika** dhe
- c) **dramatika**.

**Krijimet lirike** zakonisht shkruhen në vargje, që quhet poezi.

**Veprat epike** shkruhen në rreshta, që quhet prozë.

Në tipin e prozës, lloje kryesore janë: **fabula, anegdota, tregimi, përralla, novela** dhe **romani**.

Veprat që shkruhen për t'u luajtur në skenë janë **drama**.

Kur i lexojmë ose i dëgjojmë veprat letrare, ndiejmë kënaqësi shpirtërore.

Nuk lodhemi kurrë nga ajo që është shkruar bukur.

## VEÇORITË E POEZISË EPIKO-LIRIKE

Në komunikimin e përditshëm poezi e quajmë veprën letrare të shkruar në vargje. Poezia e shkruar në vargje mund të jetë e shkurtër ose e gjatë. Zakonisht poezitë lirike janë më të shkurtra, nuk kanë subjekt dhe poeti shpreh ndjenjat e brendshme; ndërsa poezitë epike janë më të gjata, kanë subjekt dhe ndjenjat e poetit janë më të përmbajtura.

Te poezitë epiko-lirike bashkohen apo gërshetohen elementet epike me ato lirike. D.m.th. poezia epiko-lirike është një krijim letrar në vargje ku rrëfimi i ngjarjeve gërshetohet me ndjenjat e brendshme të autorit, si te poemat, romancat, baladat etj.

### Detyrë

Lexojeni poezinë e mëposhtme epiko-lirike nga Gavrill Dara i Riu

#### KËNGA E SPRASME E BALËS

Shpjegim:

Në hyrje të poemës, plaku Balë i mërguar në dhe të huaj, kujton rininë plot vrull luftarak, betejat nën udhëheqjen e Skënderbeut, shokët e luftës dhe njëkohësisht, Marën "bijën e Lalës" si dhe historinë e trishtuar të dashurisë së saj me Nikun.

#### BALA

*Mori bijë, bijë e Lalës,  
Moj e bukur, e trishtuar,  
Pse m'kujton motin e shkuar?  
Ja, ku mjegulla e errët  
Rrokulliset mal më mal  
Sa lind dielli malit t'Gropës,  
Tundet, qesh i thelli shpat.  
Porsi ti, e bardhë, e kthjellët*



Cipëza e qiellit shtrihet  
Me një rreth-o të pasosur,  
E rimët si ninëza jote.  
Nga zjarret e pranverës  
Seç ndri çojnë gjith' kodrinat  
Edhe tymi ngjyrë hiri  
Me ret' vete e përzihet,  
Ngjarë këngës së trishtuar,  
Që siell era për së largu.  
Ja, dhe vashëzat pa brez,  
Zën' të gjitha dor' më dorë,  
Të thërresin ty ndër vallet.  
Pa kujdes këmba e djemvet  
Hidhet rëndë ndër kangjelet,  
Se e kan' zemrën tek ti.  
O ti, lulja e hollë e malevet,  
O ti, e para e vajzërisë,  
Ec atje ku në hare  
Derdhet ari i moshës s're  
Edhe zemërzën gëzo  
N'ëndërrën e ëmbël të mëngjesit!  
Lerja plakut, lerja Balës  
Terrtët lisa, zhurm'n e lumit,  
Që, rrëmbyer malit t'egër,  
Thellon shtratin me përrenjtë,  
Si mendimi im i shkretë,  
Që më bren e m'përvëlon  
Me të moçmet kujtime.  
Dyzet herë krahu i dimrit  
Ra mbi Honin e mbi Brinjën  
E i mbuloi e i zbardhëlloi  
E aq her bleruan arat  
E ugarevet të Fushës,  
Qëkur mblodhi dheu i huaj  
T'ikurit e të pafatët;  
Dhe gëzimi q'atëher,  
Më nuk shkrepi këso nate,

Që trut' krejt m'i errësoi.  
Para sysh më fluturojnë  
Vite, trima e pun' të shkuara,  
Sikur era ndërron retë,  
I shpërndan e i zvarris  
E i përze me frymë e gji.  
Moti shkon pa u kuptuar  
Për të shkretin bari,  
Por mbi ballë të ushtarit  
Bien si plumba këto ditë,  
Sepse me duar të ftohta  
Brenda mu në varr e shtinë.  
E këto ditë pushimi  
Të helmuara si vdekja  
Jan' për Balën, mori vajzë;  
Pse ky krah, tashti i dobët,  
Shum' herë ushtën e vërviti  
Ndër ushtarë e bëmat tona  
Shumë her' të bukrat vajza  
Na i lëvduan e i kënduan.  
Tashti që eci në shkretirë  
Edhe mbeta gjallë e shkretë.  
Vrulli i rinis më lë  
Të harruar në një skaj.  
Por veç ti si rreze qielli  
Lehtë e lehtë dimrit t'egër  
Shkon e gjen t'mjerin bari  
Zbjerrë tek humbja e Llazit  
Dhe e gëzon me afsh e dritë  
Dhembje ndjen për t'keqen time,  
Vjen me mua n'errësirë.  
Dhe ja, para sysh më dalin  
Gjith' bujarët e fuqishëm,  
Të helmuar e të vrenjtur,  
Si m'u dukën për së largu  
Çukat e malevet t'dashur  
Kur iu fala që nga deti

*T'fundit herë e më s'i pashë.  
Ju, o bij të motit t'madh,  
Hapët një të ndritur udhë  
Në të vjet vet thellësi.  
Zulma juaj ndriçoi si diell  
Përmbi botën e përmbysur;  
Ajo eshtrat jua shkëlqen  
Ashtu si dielli mbulon,  
Edhe pasi perëndon,  
Valët e trazuara  
Me zjarr edhe me shkëndija.  
Por ushtarët s'duan helme,  
S'duan qarë... Por, po deshe,  
Emri yt këtu m'kujton  
Një përrallëz plot lotë.*

*Gavrill Dara i Riu*

## **Fjalor**

- e rimët si ninëza - e kaltër si bebëza e syrit
- kangjel-i - valle me këngë
- hare-ja - gëzim, gaz
- ugar-i - tokë e papunuar (djerre) për një ose dy vjet
- ushtë-a - heshtë, shtizë
- bëmë-a - veprim, vepër trimërie
- zbjerrë - humbur (nga folja bjerr - bora – bjerrë)
- çukë-a - maja e një mali ose e një bregu
- zulmë-a - lavdi

## **Detyrë**

Në bazë të njohurive që keni fituar deri më tani, analizojeni këtë vjershë epiko-lirike.

## FABULA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT

Në një tekst tregimtar (poemë, roman, tregim etj.) dallojmë fabulën dhe subjektin.

**Fabula** është mbarështrimi i ngjarjeve themelore, për të cilën flitet në ndonjë vepër letrare.

Në vepër hasim edhe ndjenja, përshkrime dhe qëndrime, por fabula shënon vetëm rrjedhjen e ngjarjeve më të rëndësishme të një vepre letrare.

Fabula është vetë thelbi i ngjarjes, ashtu si ajo ka ngjarë, në renditjen e vet logjike e kronologjike.

**Përmbajtja** (subjekti) është thurja dhe zhvillimi i tërësisë së çasteve (episodeve) përbërëse, duke ndjekur zakonisht logjikën dhe kronologjinë e fabulës. Me një fjalë, subjekti është thurja artistike e episodeve të ndryshme me anë të së cilës autori mishëron fabulën. Pikërisht, subjekti bart vlerat më të shumta artistike. Subjekti është më i gjatë dhe më i zhvilluar se fabula.

### LUMI I VDEKUR

*Shpërngulja*

Në qerren e parë të karvanit, ngushtuar nga rregullimat e shtëpisë, përveç Pilos që e ngiste, ishte e reja me të vjehrën. Plaka e ndënjur te koka e nuses, te koka i thënçin, se gruaja që po çaplehej në të dhëmburat e hidhura të lindjes (ku vinte kokën, s'vinte këmbët) kishte kryqosur duart në kraharor me një pikëllim të madh dhe s'dinte ç'të bënte. Vetëm kur ranë kambanat e Shën-Gjergjit, që lajmëronin se po dilte nga kisha, plakës iu kujtua zoti i madh dhe filloi t'i lutej shenjtit t'i lehtësonte dhimbjet së resë e t'i ipte lirim të mbarë. Me gjithë të keqtë e atij çasti, nuk harroi të falej që t'i gëzonte shtëpinë me një djalë. Të gjithë këto i bëri me mënt e saj, vetëm këtë të fundit e tha me zë, sikur kërkonte që ta dëgjonte dhe e reja.

Nusja që kishte rënë një hop në atë qetim të shkurtër në të cilin

bien rëndom gratë shtatzëna kur janë duke mbledhur fuqi për shtër-  
imin e fundit, u dha buzëve të mavjosura një fije gazi të hidhur.

- Ashtu, vërtet, moj nënë, djalë qoftë, çupë mos u bëftë, se ne gratë  
na ka nëmur zoti qëkur na bëri gra...

Qerrja që hidhej sa më një krah, më një krah nga një herë në  
tjetrën, po bënte të sajën, lehtësonte dhe afronte orën e madhe të dritës  
e të qetësisë.


Atë hop, kur Piloja shpoi rëndë kalin që të bënte djathtas e të linte  
mënjanë një pellg të thellë më ujë, nusja lëshoi dhe afronte orën e madhe  
të dritës e të qetësisë.

- Uf, nëno moj! - sikur hosteni të ishte ngulur në trup të saj e jo  
në lëkurën e argasur të kaut.

Kjo ndjenjë e çuditshme e zaptoi menjëherë Pilon, që në çast hoqi  
hostenin nga vithet e kafshës dhe ktheu kokën të shikonte ç'kishte e  
shoqja.

Qetë, lënë në punë të tyre, i ranë lerës përmes. Shtatzënia në të  
dhëmbura e sipër, u shpëtoi duarve të plakës që e mbanin të mos e  
briste e ta dëgjonin bota dhe u kthye më krah, sikur ashtu do të gjente  
lehtësimin që kërkonte. Gjunjët, mbledhur mbi bark, iu përpoqën në  
faqen e një dengu me plaçka. Rrangullat e shtëpisë u rrokullisën nëpër  
qerre dhe një trastë shkau e ra ne tokë. Trahanaja e imët dhe e thatë  
kërckë u përhap mbi baltë.

- Uaha kazil, uaha kuqo! U foli Piloja qeve që të ndalojnë dhe vetë,  
si pështeti hostenin në tokë, u hodh poshtë.



E dhe qerrja e dytë pushoi së qari. Qetë duke shfryrë jashtë avullin e dendur e të ngrohtë, zhytën turinjtë në trahana dhe nisën të përtypen me qejf. Një shkumë e bardhë filloi t'u rrjedhë si zinxhir i hollë nga të dy anët e bulçive.

Nga bishti i qerres së pasme kërceu në rrugë dhe ndau drejt së parës një vajzë nja gjashtëmbëdhjetë vjeçe. I ra baltës përmes dhe doli në krye të karvanit. Ishte Vita, çupa e madhe e Pilos.

- Ç'kërkon, moj bijë, që erdhe?... I foli gjyshja. - Nuk bën të rrish, këtu, po shko... Je çupë e rritur tashti...

- Nëna, ç'ka nëna?...

Piloja, pasi u vuri qeve përpara e më këmbë hostenin e gjatë, si shenjë që s'duhej të lëviznin nga vendi, i ra qerres rrotull dhe doli në bisht të saj.

- Po ty, moj, kush të thirri të vish?

Kur vajza pa t'anë kaq të ngrysur e tek vetulla e mëngjër i epte fët-fët poshtë e lart si për kohë të lirë, uli kokën dhe mërmëriti:

- Erdha se mos më do gjëkafshë nëna... dhe, sikur të kishte në duar ndonjë palë kriga, kapërceu gishtërinjtë me njëri - tjetrin pa ditur ç'të bëjë tjetër.

- Shko, shko, te qerrja, se s'mbeti jot'ëmë për ndihmën tënde! I foli i ati, duke i bërë me kokë, sikur kërkonte ta shtynte tutje.

Si u largua çupa, Piloja iu afrua s'ëmës.

- E, plakë, si duket puna, a do të mbajë dot gjer në Seman?

- Zor, o bir... Më duket se po e mundojmë e po hyjmë në gjynah me zotin dhe me të ... Ktheje më mirë qerren për në Bishtanakë, te hani. Gjyshja ngriti kokën dhe pa të birin në sy, si për t'i zgjidhur mendjen.

- Ma desh zemra të lindte fëmija në dhe të ri, se, kush e di, mund të na sillte të mbarë... Po, nejse, kur s'do perëndia, s'ka ç'bën robi...

- Tundi kokën dhe u largua drejt kreut të karvanit. Mori hostenin, hodhi lart dhe shpoi kuqon që të kthente, më të djathtë.

\* \* \*

- Pse qan ata, mos e rrahu tata?... pyeti vëllai i vogël zgjuar në kohën kur qerrja kishte pushuar së tunduri e përkunduri.

- Jo vëllaçko, nuk qan ata, por prit dhe pak, të shohësh se kush do të qajë: vëllai apo motra... iu përgjigj Vita, duke tërhequr me një dorë tërkuzën e lopës dhe me tjetrën duke shtrirë të vëllanë.

Qerrja filloi të lëkundej përsëri dhe boshti i palyer ia nisi vajit të tij: "criu-criu fiq..." avaz që po e mbante që atë mëngjez kur i zoti i harroi, apo s'pat nge, t'hedhë masën katranit. Kjo e qarë zvarrëzvarrë, si ajo tërkuzua e lëshuar e lopës që Vita e kish lënë nga dora, shiu i imët i fushës së Myzeqesë, që s'priti gjersa karvani të zinte Kilin e vogël. Koka, lëshuar gjumit dhe ëndërrave, po i shkante sa mënjanë nga troshitja.

Sytë e vajzës, si kaluan një çast vështrimin e plogët e të qullët të kafshës që vinte pas, u mbushën përnjëherë me lot. Bulzat e ujit mbi faqen e një pellgu të rrahur nga shiu, dukeshin si barka të vogla që kishin ngritur velat për udhëtim, ashtu si lotët e vajzës që kishin marrë teposhtë faqeve. Kapur fort pas hunjve të qerres, kokën pështetur mbi faqen e rrogëzit që mbulonte plaçkat dhe binte gjer poshtë, vështrimin mbytur në atë re të madhe shiu, as Vita s'e kuptonte dot kush ja ndillte gjithë këtë trazim e pikëllim: arratia nga fshati ku kishte lerë e ishte rritur, lëngimi dhe dhembjet e nënës, apo ndonjë duf i ri që s'pati ndjerë gjer atë ditë në kufijt e fshatit të saj, në gjerdhet e kasolles së saj.

E ku kuptohet ndonjëherë nga çastisin rrëketë që mbushin lumin dhe e bëjnë të buçasë nga shtrati dhe udha e tij!...

*Fragment nga romani "Lumi i vdekur" i Jakov Xoxës*

### **Shpjegim:**

Në fragmentin e shkëputur nga romani "Lumi i vdekur" shquhen çastet që tregojnë: shpërnguljen e familjes së Pilo Shpiragut dhe dhimbjet e lindjes që e kanë shtrënguar gruan e tij, e cila përpëlitet në qerren që lëviz rrugës me gropa fushës së Myzeqesë. Në të dyja rastet përmes rrëfimit të qetë, Jakov Xoxa shpreh, botën e ngarkuar me reflekse, përfytyrime e asociacione të pasura, botën psikologjike të personazheve, si dhe drithërima të brendshme, të thella shpirtërore... E gjithë rruga që përshkon karvani ka një domethënie simbolike.

Varfëria, rruga me llucë, qerret me qetë e lodhura, karrocet e mbushura me njerëz dhe dengje leckash është rruga e jetës së familjeve Myzeqare në vitet '30. Tiparet përcaktuese të personazheve dalin që të përgatisnin për ngjarjet e mëpastajme: plaka me urimet dhe mallkimet e saj, Pilo me zemërimin dhe përgjegjësinë e prijësit të karvanit; Lili i vogël që e sheh botën ende përmes përngjumjes nga lëkundja e qerres, Vita në prag të shpërthimit të vajzërisë; gruaja shtatzënë me dhimbjet e

rënkimet që s'dihen në janë ogur i mirë apo i keq. Pamjet, përshkrimet, gjendjet janë dhënë me një leksik aq të përshtatshëm dhe aq të pasur, sa të duket sikur i ke të gjalla para syve. Kjo është edhe veçoria më karakteristike e stilit të J. Xoxes.

### Pyetje dhe detyra

- ▶ Ç'është fabula?
- ▶ Ç'është subjekti?
- ▶ Çfarë dallimi kemi ndërmjet fabulës dhe përmbajtjes së veprës letrare?
- ▶ Lexojeni në tërësi romanin "Lumi i vdekur". Analizojeni këtë vepër letrare: shkruani në fletore fabulën dhe subjektin e veprës.

Për t'ju ndihmuar për detyrën e dhënë, po japim këtë skemë:

#### LUMI I VDEKUR

**Tema:** Jeta e vështirë e fshatit të Myzeqesë gjatë viteve 1938 - 1939

*Fati i tri familjeve:*

- Familja Shpiragu e dëbuar nga beu i vendit;
- Familja Tafilaj, kosovarë të dëbuar nga pushtuesi serb;
- Familja e Koz Dynjasë, vendase nga fshati Trokth.

*Linjat paralele:*

- Vështirësitë e jetës dhe të mbijetesës së fshatarëve përballë bejlerëve e tregtarëve;
- Dashuria e Vitës me Adilin (një bashkim simbolik).

*Zhvillimi i ngjarjeve:*

- Dëbimi nga toka e vet e familjes së Shpiragajve;
- Vendosja e tyre në Trokth;
- Marrëveshja e Pilo Shpiragut me tregtarët e Fierit;
- Shpërthimi i lumit;
- Zhgënjimi i Pilo Shpiragut nga tregtarët;
- Marrëveshja e tij me beun;
- Arratisja e Adilit me Vitën.

*Personazhet kryesore:*

- Pilo Shpiragu e Koz Dynjaja, që tipizojnë figurën e fshatarit



shqiptar mes dilemave të kohës.

- Sylejman Tafili tipizon figurën e kosovarit të ikur nga serbët, por dhe të zhgënjyer nga raportet me fshatarët e Myzeqesë.

- Adili dhe Vita janë dy personazhe romantikë të dashuruarish, që autori i parapërgatit për ngjarjet e mëpasme të luftës.

*Veçori të veprës:*

- Ka unitet të brendshëm të qëndrueshëm, me anë të të cilit lidhen rrjedhat fabulare.

- Ndërhyrja e autorit për të bërë zgjidhje qëllimore.

- Synimi për të rrëfyer bindshëm.

- Gjuha e pasur me frazeologji dhe filozofi popullore.



### **JAKOV XOKA (1923-1979)**

Jakov Xoxa në letërsinë shqipe është i njohur si romansier, novelist e tregimtar.

Lindi në Fier ku e mbaroi shkollën fillore, ndërsa të mesmen e kreu në Korçë. Pasi përfundoi studimet e larta për letërsi, një kohë punoi si gazetar dhe më vonë si profesor i letërsisë në shkollën e lartë. Nga viti 1965 Jakov Xoxa kryesisht filloi të merret me krijimtari letrare, ku në fillim shkroi skica, reportazhe dhe tregime.

Tregimet e Jakov Xoxës janë përmbledhur në "Novela" I dhe II.

Në letërsinë shqipe Jakov Xoxa u bë i njohur me romanet "Lumi i vdekur", "Juga e bardhë" dhe "Lulja e kripës". Është marrë me stilistikë dhe teori të letërsisë.

## VEÇORITË E TREGIMIT

*Lexoni me kujdes tregimin e mëposhtëm dhe diskutoni rreth tij.*

### **NJË NATË NË STAMBOLL**

Nata ka mbuluar me krahët e vet Stambollin. Dritat e shtëpive të qytetit po shuhën njëra pas tjetrës. Në një dhomë, buzë një rrugice të ngushtë, dritat nuk shuhën akoma. Është dhoma e punës e një shqiptari të madh.

Nga dritarja e vogël, drita duket ende. Brenda në dhomë ndodhet rilindësi i madh. I rrethuar nga librat, është ulur në një kolltuk të vjetër dhe shkruan.... Nga kalldrëmi i rrugës së ngushtë vazhdon të kumbojë zhurma e hapave të zaptijeve. Dinjitoz, i heshtur, i vrazhdë, i brengosur nga të therurat e gjunjëve, nga reumatizmi i pashërueshëm, ai vazhdon të shkruajë. Kohë pas kohe e lëshon punën mbi tryezë dhe diku i mbërthen sytë. Ai ëndërron dhe shkruan, shkruan dhe ëndërron.

I mbështjellë në ëndrrën e tij të madhe, ai kaloi dete, male, fusha, bregore dhe arriti atje ku ëndërronte kryeqytetin e Shqipërisë së ardhshme në Belsh. Qëndroi para liqeneve dhe në pasqyrën e atyre ujërave të kristalta soditi një botë të tërë përmes ëndrrës së vet. Njeriu me mjekër të gjatë dhe të thinjur para kohe shikonte me sytë e mendjes atë që sot e shikojmë me sytë e ballit. Ai e dinte se ëndrrat e tij s'mund të qëndronin ëndrra; ai e njihte fuqinë shpirtërore të popullit shqiptar, zotësinë e tij, talentin e tij, vetëmohimin e tij dhe, mbi të gjitha, trimërinë e tij legjendare.

Në ato ujëra të kristalta ai soditi Shqipërinë, të lirë, pa shtypës pa pushtues, pa të ligj. Ai kundroi universitetin ku hynin e dilnin mijëra djem e vajza me libra në sqetull. Ai aty pa si në pasqyrë minierat nga të cilat rridhnin lumenj nafte dhe sere, ai pa male plot me krom, hekur e nikel. E tërë Shqipëria aty ishte. Dhe u mahnit. Një lot shkau si një rubin nga sytë e tij, çau përmes rrudhave të asaj fytyre, u rrokullis në ujërat e kulluara të liqenit e një valëz uji e rrethoi atë lot. Ai buzëqeshi. Ndofta pas kaq e kaq vitesh ishte e para buzëqeshje që zbukuronte fytyrën e tij. Një valëz u përplas lehtas në breg dhe me zhurmën e vet,

ndoshta përshëndeti rilindësin e madh.

U zgjua nga ëndrra, erdhi në vete, fërkoj sytë me duart e veta dhe duart iu qullën. Kishte qarë.

Drita e zbehtë e llambës me vajguri vazhdonte të përpëlitej dhe hapat ritmikë të rëndë të zaptijeve dëgjoheshin që nga jashtë. Ngriti pakëz kokën, hodhi sytë rreth e rrotull dhe i mbërtheu me mallëngjim mbi librat që e rrethonin nga të katër anët. Ndoshta desh t'u jepte lamtumirën e fundit. Mori përsëri penën, por pena për herë të parë nuk iu bind dhe i shkau nga dora. E uli kokën mbi libër, po sytë iu veshën, fytyra iu zbeh, mjekra iu drodh. Pena pret një dorë që të lëvizë, por dora s'lëviz më. Dhe boja u tha mbi libër. Vdiq mbi libra, i rrethuar nga libra, si trimi në fushën e betejës me armë në dorë.

*Sipas Nonda Bulkës*

## **TREGIMI**

Njerëzit, në komunikim me të tjerët, mund të tregojnë përjetimet e tyre ose ngjarje të ndryshme, por këtë nuk mund ta bëjnë të gjithë në mënyrë artistike. Tregimi është një krijim artistik që i kushtohet një ngjarjeje të veçantë pa përmendur me hollësi se çfarë ka ndodhur përpara dhe pas kësaj ngjarjeje.

Tregimi është më i shkurtër se novela. Ai zakonisht përfshin vetëm një detaj, një fragment të shkëputur nga jeta e njeriut.

Ai është një tekst që ka tri pjesë themelore: hyrjen, zhvillimin e përmbajtjes dhe mbylljen. Tregime kanë shkruar shumë autorë shqiptarë. Ndër më të njohurit janë: Migjeni, Ramiz Kelmendi, Abdylaziz Islami, Konstantin Kristoforidhi, Naim Frashëri, Mitrush Kuteli, Anton Pashku, Vath Koreshi, Teodor Laço, Zija Çela, Dritëro Agolli, Naum Prifti, Murat Isaku, Rexhep Zllatku, Kim Mehmeti etj.

### **Struktura e tregimit**

Tregimi, si një krijim letrar, përbëhet nga disa elemente kryesore:

- përmbajtja (fabula),
- **shtresa kuptimore** (lidhjet që krijojnë fjalët me njëra-tjetrën),
- **personazhet** dhe
- **skema**.

- Në hyrje paraqiten fakte që u përgjigjen pyetjeve ku? kur? dhe kush?

- Në zhvillimin e përmbajtjes paraqitet ngjarja kryesore, ndërsa në mbyllje jepet përfundimi i tregimit.

### **Pyetje dhe detyra**

- Ç'është tregimi?
- Cilat janë elementet kryesore të tregimit?
- Lexojeni edhe një herë me vëmendje tregimin e dhënë më sipër dhe gjeni hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tregimit.

### **Punë kreative**

#### **SI TË SHKRUAJMË NJË TREGIM?**

- Përpara se të filloni të shkruani një tregim, duhet të përcaktoni ngjarjen më të rëndësishme që do të tregoni.

- Hyrja e tregimit duhet të jetë e përshtatshme, me fakte dhe hollësi që lidhen me vazhdimin dhe me fundin e ngjarjeve.

- Përpiquni që, me fjalët tuaja, të bëni një paraqitje të plotë dhe të saktë të saj.

- Jepni të dhënat ose faktet e nevojshme në mënyrë që lexuesi të krijojë një ide të qartë për atë që ka ndodhur.

- Duhet pasur kujdes për ta mbajtur të gjallë kureshtjen e lexuesit për tregimin, disa të dhëna duhet të mos i tregojmë.

- Tregimi është një tërësi ku tri pjesët e tij janë të lidhura njëra me tjetrën.

- Gjuha e tregimit duhet të jetë e zgjedhur, e saktë dhe tërheqëse.

## NOVELA

Novela është formë e shkurtër e shkrimit në prozë. Ajo, rrëfimin e vet e ka më të kufizuar dhe ka pak personazhe. Në të jepen më pak informata, ndërsa rrëfimi i ngjarjes është më i dendur dhe më konciz.

Janë të njohura novelat e Mihal Gramenos, “Oxhaku”, “E puthura” dhe “Varri i pagëzimit”. Novela kanë shkruar edhe Shefqet Musaraj “Isha unë Çobo Rrapushi”, Zejnulla Rrahmani “Udhëtimi i një pikë uji”, “E bukura e dheut”.

### Detyrë

*Lexojeni këtë novelë.*

#### OXHAKU

#### PJESA E PARË

#### Krye I

Më 1821, në kohën e Ali Pashës, Shqipëria dhe më shumë Toskëria gjendej në rrëmujë. Katunde edhe qytete shkretoheshin dhe njerëzia mërgoheshin në vende të huaj, duke lënë shtëpitë, plaçkat e gjithë ç’kishin edhe vështronin vetëm si e si të shpëtojnë nga rreziku shpirtin e tyre.

Asi kohe, qyteti Korça kishte zënë të lulëzonjë, duke qenë më parë një qyteti i vogël edhe i padëgjuar siç është sot, po njerëzia dridheshin nga frika se mos kenë gjithë atë fat që kishin edhe të tjerët të cilët ngrysheshin të gjallë e gdhiheshin të vdekur. Andaj, me të perënduar dielli, mbylleshin nëpër shtëpitë edhe nuk dinin ç’bëhesh natën në qytet.

Nga ky shkak nuk kishin vërejtur që “shtëpia e zezë” prej ca kohe mbante njerëz brenda. “Shtëpia e zezë”, siç e quanin qytetarët ishte një shtëpi e madhe, ndërtuar me gurë dhe rrethuar më gjithë anët ime avlli edhe fortesa edhe ishte mbanë qytetit pranë krojt të Abdi beut. Prej shumë kohe, kjo shtëpi ishte e pandënjur edhe e shkretuar, të gjithë sa kishin ndenjtur, gjithë atë fat kishin pritur që të shuhen me gjithsej, edhe nga ky shkak kishte arritur të jetë folë e kukumjaçkave edhe e galave, se njerëzia jo vetëm që nuk guxon të ryjnë brënda, por edhe kur shkonin pranë asaj shtëpie do të faleshin me tmerr, duke iu lutur zotit t’i shpëtonjë edhe t’i mpronjë nga nonjë gjëmë e madhe.

Në të këtilla frikëra gjendeshin korçarët, kur një natë të marsit frynte një erë e marrë edhe dëgjojnë të zbrazura prej pushkësh. Të gjithë mbetnë të tmerruar, se pandeshnin që afrojtë edhe për ata fundi i jetës. Andaj që të gjithë faleshin, duke kërkuar nga nonjë vent të fshehtë për shpëtimin e shpirtit, edhe asnjë nuk guxonte të dalë përjashta që të mësonjë shkakun e pushkëve.

Po sa vinte më shumë dëgjoreshin të zbrazura prej pushkësh, pastaj dëgjoreshin edhe zëra njerëzish, të cilët bërtisnin sa muntnin që të vraponin të shuanin zjarrin që diqte shtëpinë e zezë, se ishte shumë frikë mos përhapet zjarri mi gjithë qytet.

Vetëm atëhere njerëzia, si u siguruan që nuk është tjetër rrezik përveç zjarrit, të cilin e pandeshnin t'ja ketë vënë nonjë njeri mëndjeshkurtër, vraponin me ujë, dhiqelë e sëpata, edhe me çfarë muntnin për të shuar zjarrin.

Po, me t'u afruar pranë shtëpisë së zezë që digjesh, mbetnë të nemitur e të habitur kur vështronin sot krerë njerëzish në dritaret e shëpisë, të cilët u luteshin edhe u kërkonin ndihmë që t'i shpëtojnë mos digjen të gjallë.

Një grua e re edhe e bukur, që dukesh fare mirë në dritare të flagëvet me leshrat e lëshuar edhe të pakrehura, me sy të zgurdulluar, veshur me rrobën e natës si ç'ishte ngritur me tmerr nga gjumi, zgjate duar, duke lutur njerëzinë t'i shpëtojnë të vetmin djalë që kishte, i cili flinte në katin e dytë, meqënëqë ajo nuk munte nga flagët e zjarrit ta shpëtonjë!

Po njerëzia gjithë mbetnë të shurdhër në blegërimet e në lutjet e kësaj gruaje, mënjane nga frika e zjarrit që nuk muntnin t'afroheshin, më tjetër anë nga tmerrri që vështronin njerëz në atë shtëpi, të cilën e dinin të pandenjor edhe të shkretuar. Andaj vështronin vetëm që të mos zgjatet zjarri më tjetër shtëpi, duke lënë të brençmit në duart e Perëndisë! Ah, sa keq është të veshtrosh shpirta që digjen edhe të mos mundësh t'i shpëtosh!

Zërat që brenda pushuan së bërtituri edhe së kërkuari ndihmë edhe nuk dëgjoresh përveç trak-trak! nga drurët edhe nga dhogat që digjeshin, se zjarri sa vinte po përhapte flagët më të gjitha anët, kur dëgjohet pas pakëzë, për të fundit herë, një buçim i math përzierë me një zë të thellë edhe pastaj bëhet një heshtje e madhe, se çatia me dyshemetë e gjithë ç'kishte shtëpia, ranë të gremisura, edhe zjarri më

s'kishte fuqi.

Qytetarët ndenjë të gjithë pranë zjarrit gjer më të gdhirë, për të ruajtur mos kërcenjë nonjë shkëndijë afër, edhe pyesnin njëri-tjatrën në dinte gjësendi që kur rronin njerës në këtë shtëpi po asnjë prej syresh nuk e dinte ç'njerës rronin, që kur kishin ardhur në atë shtëpi, edhe sa ishin. Andaj, me gjithë helmin që ndjenin për ata që u bënë therorë të zjarrit, gëzoheshin më tjetër anë se zjarri i vuri funt asaj shtëpie së zezë, që kishte shuar kaqe njerës, edhe të cilën e nëmëronin si shkakun e gjithë të ligave që ngjisnin në qytet!

*Mihal Grameno*

## Detyrë

1. Në këtë fragment të novelës "Oxhaku" përshkruhet momenti i djegies së "Shtëpisë së zezë" në të cilën ishte strehuar Vahideja me shërbëtorin Rustemin dhe me fëmijët. Analizojeni këtë pjesë dhe vëreni si e ka bërë shkrimtari përshkrimin e kësaj scene.

2. Ç'mendojnë qytetarët kur dëgjojnë krisma pushkësh, si veprojnë kur kuptojnë se ka shpërthyer zjarri dhe përse nuk u ndihmojnë njerëzve që ishin në flakë?

3. Lexoni edhe pjesët e tjera të kësaj novele. Ato mund t'i gjeni edhe në internet.

### **MIHAL GRAMENO (1871-1931)**

Lindi në Korçë. Mësimet e para i mori në vendlindje. Në moshë të re mërgoi në Bukuresht, ku u lidh me shoqërinë "Drita". Botoi vjersha dhe artikuj në shtypin e kohës. Në vitet 1907-1908 luftoi në radhët e Çetës së Çerçiz Topullit, më 1908 mori pjesë në Kongresin e Manastirit. Vdiq në Korçë më vitin 1931. Shkroi novelat "Oxhaku" (1904-1905), "Varri i pagëzimit" (1909) dhe "E puthura" (1909) etj.



## NARRATORI (RRËFYESI)

Çdo vepër letrare i dedikohet lexuesit ose dëgjuesit. Në dramë aktorët në skenë u flasin shikuesve, kurse autori flet përmes tyre. Në llojet e tjera letrare, të ashtuquajtura narrative (sipas latinishtes: naratio, rrëfim) narratori drejtpërdrejt ose tërthorazi i drejtohet lexuesit.

Narratorin nuk duhet ta identifikojmë çdo herë me autorin. Rolin e narratorit mund ta marrë ndonjë personazh në vepër ose një personazh i shpikur, si dëshmitar i ngjarjes. Narratori ka një rol të rëndësishëm për t'i kuptuar elementet e tjera të veprës. Tema, fabula dhe motivimi nuk mund të kuptohen drejt pa bërë edhe analizën e rolit të narratorit në një vepër letrare.

### ***Vepra letrare nga ana gjuhësore përbëhet:***

a) nga ligjërata e autorit (kur fjalët dhe fjalitë janë thënë në vetën e tretë nga autori);

b) nga ligjërata e personazhit (kur fjalët dhe fjalitë thuhet nga një pjesëmarrës i veprës), dhe

c) nga ligjërata e rrëfimitarit a narratorit (kur një pjesëmarrës i veprës tregon në vetën e parë).

Gjuha e autorit dhe gjuha e personazheve ndërthuren.

## MALËSORJA

*(fragment)*

Sa shumë e ndryshuan Hajrinë ato tetëmbëdhjetë vjet të martesës së dytë, habitej edhe ajo vetë. Nëpër fytyrën dikur të njomë e të bukur, të shëndoshë e të plotë, si lulja në mëngjesin e pranverës plot rreze të këndshme dielli, ishin kryqëzuar tash do rrudha që ia kishin bërë koha dhe vuajtjet, thua se në atë mënyrë i kishte shënuar çdo vuajtje kujtimet e veta me nga një rrudhë në fytyrën e saj. Të gjitha ato kishin marrë tash pamjen e një rrjete marimange në ndonjë qoshe të çardakut. Edhe trupi i saj, dikur i hollë e i gjatë si selvia në mes të malit, ishte kërrusur pak, tash dukej më e vogël. Sytë i ishin zgjeruar e flokët, dikur aqë të zez e të



gjata, sa të gjitha shoqet ia lakmonin, ishin thinjur e rralluar. Megjithatë, Hajria, mu tash, në këto vite pleqërie, e ndjente veten më krenare se kurr ndonjëherë më parë. Sa herë e mendonte jetën e vet, i dukej se ka lindur mu atë ditë, që u krijua bota dhe se është më e vjetër se të gjithë njerëzit në të. Se kishte parë e përjetuar gjithçka që ndodhi deri tash në botë. E ka përcjellë çdo ngjarje të asaj ane dhe i dukej se vetë kishte marrë pjesë në to, pasi të gjithë ngjarjet e kaluara i mbante mend fare mirë.

Sabiti tashmë ishte rritur. Raba kishte vdekur para tri vjetësh. Të gjithë kujtimet e Hajrisë për të kaluarën e vështirë tashmë i mbuloi bukur shumë pluhuri i harresës, sidomos tash kur e shihte të birin burrë, të zotin e çdo pune; tash kur e shihte dhe veten dikund lart, lart mbi të gjithë, thuajse prej andej dëshironte t'u thonte të gjithëvet me plot mburrje:

"Qe, unë nuk kam qenë fajtores kurr!..." e ndjente në vete se si i shtohet ajo krenari pse arriti t'u bëjë ballë të gjitha atyre ngjarjeve të mundimshme dhe t'i harrojë deri dikund.

E vetmja brengë, të cilën nuk mund ta shlyente kurrsesi që Aliu. Ai i dhembet e dashuria për të nuk i zvogëlohet fare, edhe pse i urrente nganjëherë ata njerëz. Dashuria prindërore e shtynte të harrojë tërë të kaluarën dhe ta ledhatojë të birin herë pas here, por vetëm me ato kujtime e dëshira, të cilat e ndjente në vete se si i rridhnin dita ditës më tepër.

Plot nëntëmbëdhjetë vjet nga ndarja mbusheshin atëherë e asaj i kujtohet vetëm fytyra e tij, ajo fytyrë të cilën e la para aq vjetësh në mesin e atyre maleve të thepisura të Gollakut të largët, të cilën nuk e pa kurr më.

"Mos ka vdekë? Kur nuk e ka dëgjue ma as një fjalë për te!" u frigua shpeshherë dhe thellë në vete ndjeu atë dhembje e pikëllim që ia djeg zemrën nënës, të cilën e mundonte dashuria për të birin e humbur.

Tash edhe po ta shihte të birin, me siguri nuk do ta njihte më e ëma nuk do ta njihte të birin! Nëna të mos e njohë të birin! I vinte keq edhe asaj dhe çuditej, por s'kishte çka të bënte, pasi e tillë që jeta ndaj saj. Të mos e njohë djalin, për të cilin mendoi gjithmonë, në ditët më të vështira dhe më të lumtura të jetës së vet, të mos e njohë nëna femijën, gjirin e së cilës e kishte thithur, atë që e kishte shpëtuar nga vdekja, sepse sikur Hajrija të mos mendonte për të, të mund të men-

donte jetën e të birit pa të sajën, atëherë i dukej se jeta e vet ishte e kotë dhe nuk kishte pse të jetojë, prandaj qysh atëherë do të vdiste. Të gjitha këto tash i dukeshin shumë të çuditshme. Sa net i kaloi pa gjumë dhe duke menduar për të!

Sa herë ëndërroi e në mëngjes u zemërua në vete pse pranoi të ndahet: pse nuk u kap për derën e shtëpisë sa të mos mundesh askush ta ndajë prej saj. Sa lotë derdhi gjatë atyre nëntëmbëdhjetë vjetëve malli përvëlues, i cili qe shumë më i nxehtë se dielli i korrikut. Sa e sa herë e kujtoj atë moment të ndarjes, kur e la të birin për herë të fundit me duar të zgjatura kah ajo dhe vetëm kur e mendonte këtë pamje i kujtohej më së miri fytyra e tij. Iu duk se i biri donte ta luste të mos ndaheshin, por ajo ia ktheu shpinën, kurse kali vazhdonte të ecë rrugës përjetë, t'i ndajë e t'i largojë ëmë e bir prej njëri - tjetrit, edhe pse këtë nuk e dëshironin asnjëri.



Aqë më tepër e lodhnin edhe mendimet se i biri nuk dinte asgjë për të, për vuajtjet e së ëmës dhe për dashurinë e harruar. Mendonte se i biri do ta përfytyrojë tash vetëm si një grua zemërkeqe, të shëmtuar dhe shtrigë, e pa fije dashurie për të birin, të cilën e urrente pse e kishte lënë atë pa nënë për t'u martuar me tjetërkend.

Atij kurr nuk do t'ia tregojë kush romanin e jetës së saj. Atë roman të pashkruar të malësore, i cili me siguri një ditë do të harrohet, ashtu sikur janë harruar edhe mija e mija të tjerë në këto male të Llapit e të Gollakut, atë roman që e shkruan njerëzit me pashpirtësinë e tyre ndaj njeriut. Romanin për vuajtjet e njeriut nga njeriu. Romanin që zë fill dikund në Gollak, me një vajzë të bukur që ende nuk e kishte shijuar jetën që vazhdon për një grua të pafat dhe që përfundon me ... Mendimet e tilla e lodhnin Hajrinë tash më tepër se gjithçka.

Friga se mos e kishte humbur dashurinë e të birit nuk e lente të qetë, sa herë që i kujtohej jeta e tashme e lumtur. Dëshironte vetëm të dijë se a e urrente ai apo jo dhe se a dëshironte të shohë ndonjëherë të ëmën. Çfarë lehtësimi do të ndjente ajo vetëm sikur ta dinte se i biri e donte, nuk e kishte harruar kurrë dhe se mendonte gjithnjë për të.

Por, në atë rmoment në kokë i fluturonte përherë një mendim i ftohtë: "Me më pas dashtë kishte ardhë ndonjiherë. Ai tash asht burrë, kishte mujtë me ardhë!" i thonte vetes dhe pikëlluhej përsëri.

E sa e sa mendime nuk e lenin të qetë shpeshherë edhe pas kaqë vjetësh; aq shumë pikëlluhej nganjëherë sa dilte e shikonte përmallshëm qiellin e përhimtë, andej në drejtim të katundit, ku e la të birin, thua se përpiquej ta shihte atë copë qielli që e mbulonte atë.

*Nazmi Rrahmani*

## TË KUPTOJMË PËRMBAJTJEN

Hajria është personazhi kryesor i romanit. Ajo është personifikimi i vuajtjes së femrës së nënshtruar dhe të shtypur shqiptare në Kosovë e më gjerë. Vuajtjet e saj janë të shumta, por më të madhen autori ka spikatur dhimbjen e nënës për djalin që ia kanë marrë me forcë dhe tani ai është i rritur.

Rrëfimim e historisë së vet para djalit, Hajria e quan roman, një roman të pashkruar, kjo për dy arsye: asnjëherë fëmija nuk mund të njohë aq thellë historinë e prindit të vet, aq më tepër në këtë rast kur i biri i Hajries është rritur larg prehërit të nënës së vet. Kjo e bën dhe më tragjike dramën që fsheh Hajria përbrenda.

Drama e Hajries merr përmasa të mëdha shoqërore. Me dhimbjen e vet ajo përpiket të kundërshtojë botën e egër të mentalitetit e të dhunës mashkullore. Po deri në këtë fragment protesta e saj është e heshtur. Asaj s'i mbetet gjë tjetër veçse të shikojë qiellin e përhimtë.

Si stil shkrimi në këtë fragment e në tërë romanin të bie në sy ndërthurja e monologut të personazhit kryesor me gjuhën e drejtpërdrejtë të shkrimtarit.

### **Detyrë**

*Lexojeni këtë roman në tërësi.*

*Shkruajeni në fletore përmbajtjen e këtij romani.*

## LLOJET E DRAMËS

Llojet kryesore të gjinisë dramatike janë:

- a) **tragjedia**,
- b) **komedia** dhe
- c) **drama**.

### TRAGJEDIA

#### ANTIGONA

##### **Skena e tretë**

*Personazhet: Kori, Antigona, Kreoni, Rojtari, Ismena*

KREONI

*(Duke iu drejtuar Ismenës)*

Moj ti, që më thithnje fshehurazi gjakun,  
strukur si nepërkë brenda në shtëpi!  
Si nuk e kuptonja se dy veta mbanja,  
dy armiq të fronit, dy armiq të mi?  
Haj tashti më thuaj: në këtë varrim  
pate gisht dhe ti, apo do mohosh  
e me be do thuash se s'di gjë prej gjëje?

ISMENA

Në më jep kjo lejë, thom se edhe unë  
asaj i ndihmova në këtë varrim;  
e pra edhe unë jam bashkëfajtores.

ANTIGONA

Këtë drejtësi nuk do ta lejojë;  
se as ti s'ke dashur as unë s'të mora bashkëpunëtore.

ISMENA

Unë turp s'e quaj, kur ti ke mjerime,  
të lundrojmë bashkë në det plot rreziqe.

ANTIGONA

Hadi m'ata poshtë dinë kush e bëri  
punën e varrimit; unë nuk e dua,  
nuk e dua mikun që vetëm me fjalë tregon dashuri.

ISMENA

Mos, të lutem motër, mos më ler pa nder;  
më lejo të vdesim që të dyja bashkë

e kështu dhe unë të nderoj vëllanë.

ANTIGONA

Një gjë që s'ke prekur, si qënka e jote?  
S'është aspak nevojë të vdesësh dhe ti;  
mjafton vdekja ime.

ISMENA

Jeta më për mua ç'shije do të ketë,  
po qe se do mbetem, do të jetoj pa ty?

ANTIGONA

Pyete Kreonin; e ke kujdestar.

ISMENA

Pse më ndez me fjalë nga të cilat ti  
s'ke ndonjë fitim?

ANTIGONA

Vërtet qesh me ty, porse me sa helm!

ISMENA

Thuaj: a do të mund të të jap një ndihmë,  
qoft' edhe tashti?

ANTIGONA

Shpëto jetën tënde; nuk të kam zili.

ISMENA

Oh e mjera unë! Pse të mos e kem  
fatin tënd dhe unë?

ANTIGONA

Ti ke zgjedhur jetën, kurse unë vdekjen.

ISMENA

Po unë të thashë ç'kisha për të thënë,

ANTIGONA

Ca të quajnë ty, ca mua të urtë.

ISMENA

Sidoqoftë fajin të dyja e kemi.

ANTIGONA

Mos u bëj merak, se ti je e gjallë,  
ndërsa shpirti im ka vdekur prej kohe;  
po dobi kjo vdekje të vdekurve u sjell.

KREONI

Nga këto dy vajza njëra tani çmendet;  
Kurse ajo tjetra, qëkur është lindur.

ISMENA

Ndër mjerimet, mbret, mëndja nuk mbetet  
ashtu siç ka mbirë, porse ikën, zhduket.

KREONI

Pa dyshim menç dole, mbasi me të liqtë  
ke bërë dhe ti punëra të liga.

ISMENA

Si mund të jetoj, pa ditur këtë.

KREONI

A! Këtë?

Mos e zër në gojë, zëre sikur s'është.

ISMENA

Si? Mendon të vrasësh nusen e tyt' biri?

KREONI

Ka të tjerë brazda që mund të lërohen.

ISMENA

Po s'mund të ujdysin si këta të dy.

KREONI

Unë gra të liga kurrë s'marr për djemtë.

ISMENA

Emon fort i dashur! Sa të fyen yt atë!

KREONI

Shumë më mërzit ti dhe kjo martesë.

KORI

Vërtet ke vendosur t'ia rrëmbesh t'yt biri?

KREONI

Po këtë martesë Hadi do ta prishë.

KORI

U vendos, si duket, vdekja e kësaj.

KREONI

Ashtu them dhe unë! porse s'duhet zgjatur;  
shpjerimi, shërbyes, brenda në pallat.

Lidhini, të lira mos i lini fare;

se edhe guximtarët mendojnë të ikin,  
kur e shohin vdekjen fare pranë tyre.

*(Të dy motrat i shpiejnë brënda në pallat,*

*(Kreoni qëndron)*

Sofokliu

## Fjalor

- nepërkë** - gjarpër helmues me kokë të shtypur në formë trekëndëshi  
**mjerim** - fatkeqësi  
**zili** - inat  
**të ligj** - të dobët, të këqij

## Interpretim

Ky fragment është shkëputur nga tragjedia "Antigona" e shkrimtarit të vjetër grek, Sofokliut. Zhvillimi i subjektit bëhet me një gjallëri e qartësi, që rrallë mund ta gjesh në tragjeditë e tjera.

Kreoni mundohet ta mbështesë urdhëresën e tij të rreptë mbi argumente jo të vërteta, si ato që përdorin njerëzit e kategorisë së tij, d.m.th. njerëzit krenarë dhe brutalë. Thotë me plot gojën se i thirri njerëzit nga Teba për t'u këshilluar gjoja me ta, por kjo është vetëm një maskë që përdori për ta mbuluar vendimin e tij të egër, meqë kur mblodhi Këshillin e pleqve, vendimi ishte marrë dhe urdhëresa kishte dalë.

### Pyetje dhe detyra

- ▶ Cili është personazh pozitiv në këtë tragjedi?
- ▶ Si e gjykoni veprimin e Kreonit?
- ▶ Si e vlerësoni veprimin e Ismenës?
- ▶ Si përfundon fragmenti?
- ▶ Si do ta kishit përfunduar ju këtë tragjedi?

### Shpjegim

Vepra "Antigona" e Sofokliut është e llojit të gjinisë dramatike që quhet tragjedi.

**Tragjedia** është lloj i gjinisë dramatike që përfshin vepra, të cilat përshkohen nga tragjikja dhe kanë në bazë një konflikt të brendshëm ose një hero tragjik. Pra tragjedia përfundon në mënyrë të dhembshme me vdekjen e heroit. Ndër tragjeditë më të njohura janë tragjeditë e letërsisë antike, tragjeditë e Shekspirit etj.

Në letërsinë shqipe të Rilindjes Kombëtare ka pasur ndonjë përpjekje për të shkruar tragjedi, si për shembull dallohet Çajupi me tragjedinë "Burri i dheut", Mihail Grameno me "Vdekja e Piros" etj. Në letërsinë e sotme shqipe ky lloj i gjinisë dramatike është shumë pak i lëvruar.

## KOMEDIA

“KATËRMBËDHJETË VJEÇ DHËNDËR”

### Pamja e parë: burrë e grua

(Është natë. Brenda në një dhomë gjumi, zoti Vangjel e zonja Tanë bëhen gati për të rënë në gjumë. Në fund të odës ndrit një llambë afër shtratit.)

**Tana**  
Dëgjo, burrë...

**Vangjeli**  
Ç'ke, moj grua?

**Tana** (Rënkon.)  
Jam sëmurë.

**Vangjeli**  
Që kur! Ç'thua?

**Tana**  
Ç'them? Ja them që jam sëmurë, koka më digjet si furrë, s'e keshë pësuar kurrë.

**Vangjeli**  
Po tani, vallë, ç'pësove? Më duket se u ftove; gjithë natën u zbulove dhe s'më lë fare të flerë!

**Tana**  
Gjithë ditën ç'keshe bërë?  
Ti për bar e për dru s'vete dhe qahesh se nukë flete?  
Tërë ditën ngas qetë dhe drek' e darkë bëj vetë, gjithë puna përmi mua!

**Vangjeli**  
Përse të kam marrë grua?  
Gratë për punë po janë.

**Tana** (Qesëndis.)  
Edhe burratë të hanë dhe të rrinë nat' e ditë!

**Vangjeli** (Me inat.)  
Mos më bën të të godit. se zakonë s'e harrova, sonte shumë të durova. Nga hunda s'më heq dot kurrë, se nuk' jam si çdo burrë!

Jam shqipëtar i vërtetë, do të bëj si dua vetë! Ç'ke që s'pushon duke qarë?

Nga une ç'të ligë ke parë?  
S'të kam lënë si të tjerë, Vetëm, të shkret' e të mjerë.

Nuk ika kurrë nga fshati, eja, s'të shkoi inati?  
Ngreu të biem të flëmë dhe këto fjalë t'i lëmë.

**Tana**  
Bjer e fli, mua s'më flihet.

**Vangjeli**  
Nesër, porsa që të gdhihet, do t'dërgoj djalën me vrapë të bjerë mjekun prapë.

**Tana**  
Cilin mjek?

**Vangjeli**  
Adhamutnë.<sup>1</sup>

**Tana**  
S'e shoh dot me sy çifutnë, as për mace s'i vë besë!

**Vangjeli**  
Lermë moj grua, ta thërrasë, kokën mund të ta shërojë.

**Tana**  
Nuk' e dua të më shojë! Të bukur mjek që gjete! Më p'hair të ruaj qetë.

**Vangjeli**  
Mos kuvëndo kështu, moj grua.

**Tana** (Me inat.)  
Nuk' e dua, nuk' e dua! Pse s'shëron gruan e tij? Se nga ajo ha e pi... Ndaj e mori me një sy, i dalçinë që të dy.

\* \* \*

<sup>1</sup>Adhamutnë - emri i mjekut

(Andon Zako ÇAJUPI:  
fragment nga komedia  
“Katërmëdhjetë vjeç  
dhëndër”)



## Pyetje dhe detyra

1. Ku zhvillohet kjo bisedë?
2. Cilët janë personazhët kryesorë të këtij fragmenti?
3. Pse grinden Tana dhe Vangjeli?
4. Çfarë është komedia?
5. Gjejini në internet dhe shikojeni tërë komedinë "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër".
6. Diskutoni në klasë për këtë komedi të shikuar.

## Shpjegim

**Komedia** është një lloj i lashtë i gjinisë dramatike. Në kohërat antike ajo shfaqej në skenë ku luanin dy-tre aktorë që përdornin maskat për të krijuar efekte komike.

Karakteristikë kryesore e komedisë është e qeshura. Në komedi pasqyrohen dukuri shoqërore të shëmtuara dhe të ulta, që vihen në lojë nëpërmjet personazheve me vese. Elementet kryesore të saj janë ironia dhe sarkazma.

Ndryshe nga tragjedia, që përfundon me dhimbje, komedia zakonisht përfundon në mënyrë të gëzueshme dhe në të mirën e personazheve pozitivë.

Komediografët më të njohur janë Aristofani, Shekspiri, Molieri, Gogoli etj.

Komedi kanë shkruar: Mihajl Grameno, Haki Stërmilli, Anton Xanoni, Fan Stilian Noli, Foqion Postoli; ndërsa komediografë më të njohur janë Andon Zako Çajupi dhe Kristo Floqi. Në komedinë "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër" me anë të shpotisë e të humorit Çajupi godet zakonin e martesave në moshë të re.

Komedi të bukura janë edhe "Karnevalet e Korçës" (Spiro Çomorra), "Zonja nga qyteti" (Ruzhdi Pulaha) etj.

## DRAMA

Drama paraqet një konflikt të ashpër, por që gjen rrugëzgjdhje. Ajo paraqet ngjarje tronditëse, që shkaktojnë vuajtje të mëdha shpirtërore. Subjekti është mjaft i përqendruar e i ngjeshur.

Drama e parë origjinale në gjuhën shqipe është "Emira" e rilindësit arbëresh Anton Santori. Më pas ajo u zhvillua nga Fan S. Noli, Çajupi etj. Dramaturgë të njohur të letërsisë sonë janë edhe: Kolë Jakova, Spiro Çomora, Kasem Trebeshina, Sulejman Pitarka, Ruzhdi Pulaha, Teodor Laço, Ekrem Kryeziu etj.

### EMIRA

*(Kalina u jep ujë dhenve në Krojin e Ftohtë dhe po i këndon një qingji të porsalindur, pastaj vjen Emira)*

#### Skena 1

KALINA: I lumi ti,  
Që pa u trëmbur  
Këcen, o shqerr!  
Qumshtin dhe barin  
Saher' e do  
E gjen, e merr:  
Njërin dhe tjetrin,  
Kur s'të pëlqen,  
E lë tek është  
Vihe lodron  
Me bark të ngosur.  
Plot me hare  
Ditën e shkon.  
I par' ti leve...

EMIRA: Ohi, ndrikull Kalinë, Uh!

KALINA: Kush po më thërret?

EMIRA: Ndrikull Kalinë!

KALINA: Dëgjojmë, dëgjojmë!

EMIRA: Ku je?

KALINA: Këtu te Kroji.

EMIRA: Kur erdhe? Nuk të pashë të zbritshe këtej poshtë.

KALINA: S'ka një copë herë që jam këtu. Te ky bar, ja delet po kullosin.

EMIRA: E po si, pa furkë gjënde? Jot ëmë s'të shtërngon të

punosh gjithnjë si imja më?

KALINA: Ç'thua, diç zotin edhe ti Emirë? Ajo është një kul shedër, që nuk ngopet kurrë. Po t'ish si thotë ajo, do të donte të pregatis ja një palë çorape ditën. Çdo herë, kur mblidhemi në mbrëmje, të parën të pyetur që më bën është kjo: Punove sot, apo fjete e shtruar në diell, apo në ndonjë hije? Ku e ke çorapin që ke bërë? Unë rri e qetë se po t'i përgjigjesha edhe një gjysmë fjale, m'atë çast do të zihej lufta.

EMIRA: Eh, motra ime, ashtu është bërë jeta, ka më shumë thartira se ëmbëlsira.

KALINA: Veçse thuhet se kush vuan më shumë, e kush më pak.

EMIRA: Moj po kush e di? Më kujtohet se kur isha, të të them, nja tetë a nëntë vjeç, Tata më shpuri ndër Sheshe, atje tek kishim arën; atje ishin burrat që kor rnin. Pasi hëngrëm e pimë mezdite, atje nën hijen e një lisi degëgjërë dhe plot fletë, ashtu si ishin, ata zunë të flisnin për mjerimet e kësaj bote dhe, kush duke qeshur, kush duke u tallur, kush duke folur me tamam, për secilin mjerimet e veta ishin më të rënda se të tjerëve. Kur ja ku ja arriu Eremiti i Shën Pantaleut Motëmadhi.

KALINA: Motro, mba mënd se ku qëndron, dhe ndjemë se po të pres fjalën, po unë do të të rrëfej një të pësuar me këtë; unë tani jam e madhe.

EMIRA: Mëma më tha se ke lindur dy vjet para meje.

KALINA: Sa vjeç je ti?

EMIRA: Mbaroj tetëmbëdhjetë në muajin që po hyn.

KALINA: Popo, ç'thua, moj motër? Unë jam shtatëmbëdhjetë vjeç.

EMIRA: Atëhere, në unë jam dy vjet më e vogël se ti, sa vjeç mund të jem?

KALINA: Njëzet vjeç.

EMIRA: Ah! Ah! Ah! vjetët u nëmëruakan së prapëthi!

KALINA: Ti po më përqesh tani.

EMIRA: Jo, pse moj motër?

KALINA: Pse po tallesh me mua, sikur dij unë se ç'thashë?

EMIRA: Mos u thëntë kurrë! S'dij se si vate që më shpërtheu gazi. Ç'të pësuar do të më rrëfeje?

KALINA: Një herë pas të vjelavet gjëndesha me delet brënda në një vreshtë tek Zhurat. Atëhere unë kisha rritur edhe një dhi; ajo ishte aqë dëmtare dhe ashtu e djallosur që më bënte të thërrisja e dëshpëruar në çdo çast, ia kishja vënë emrin Xhallmarije dhe më dëgjonte, kur e thërrisja. Po kur i tekej asaj, nuk

më përfillte fare. Kur ish në të mira, më rrinte pranë, gjithnjë afër prehërit. Ishim vetëm afër mezit të ditës, nuk pipëtinte asnjë zog; vetëm kumborëza e dashit dëgjohej që bënte tin, tin, tin si ajo që shoqëron të vdekurit. Kur pas dhisë, që kish hyrë në një vreshtë tjetër, u hodha atje brënda për ta kthyer, më vajtën sytë tek një kasolle, që ishte në një anë, me derë të hapur. Brënda ishte e errët. M'u bë sikur atje tundej një gjë, as unë s'e di se si, që po e vërente edhe dhija. Fantazija e gjithë m'u ndez përnjëherësh dhe m'u duk një fantazëm nga e cila u trëmb edhe dhija; u lëshova t'ikja me këtë pas të ngatruar nëpër këmbë dhe u pengova, rashë dhe përpoqa e çava hundët tërë gjak në një kërcu. Nga të thirrurat e mija ai më erdhi sipër, që mos pastë të mirë kurrë!

EMIRA: Kush?

KALINA: Motëmadhi.

EMIRA: E besoj se ta ka ngrirë gjakun, kur t'erdhi sipër me ata sy si zgavra dhe të shkëlqyer, me atë mjekër të bardhë dhe të gjatë gjer në bark, i mbështjellë në gjithë ato livere.

KALINA: Unë nuk e pashë, se më kish rënë zali, po kur erdha në vehte, pashë atë që më kishte lagur faqen me ujë të ftohët dhe më mbante nën hundë një liverez të spërkatatur me ca uthull.

EMIRA: I ziu s'kish faj.

KALINA: Ku di unë a kish faj ajo, veçse që atëherë s'mund ta shoh fare.

EMIRA: Po me gjithë këtë në fshat e mbajnë të gjithë për njeri të shëjtë. Nuk pjell asnjë grua pa mos i sjellë Eremiti ikonën e Shën Pantaleut, nuk bëhet asnjë krushqi pa u këshilluar me Motëmadhin; nuk përhapet fara e krymbit të mëndafshit po s'e pat bekuar me dyllin e qirijve të të shejtit Motëmadhi. Shiko se në të gjitha shtëpitë e duan atë.

KALINA: Ashtu është moj motër, po qysh atëherë, kur më del për para, unë dridhem. Dhe më duket sikur ma bën për inat, kur ai vjen për të na parë dhe unë nuk jam në shtëpi, ajo dërgon, më thërret dhe më detyron të rrij të dëgjoj ç'thotë ai. Sa pa qejf, e di unë vetë.

EMIRA: Po ç'thotë Eremiti, kur vjen në shtëpinë tuaj?

KALINA: Unë pak, apo as fare s'ia vë veshin, veçse tek kënga e Pantaleut.

EMIRA: Me të vërtetë? e din dhe e thotë ai plak.

KALINA: Unë kam mësuar pak nga ajo.

EMIRA: A ma mëson edhe mua?

KALINA: Atë që dij unë e harroj në mes, moj ndrikull. Unë dij ta thom dhe ta këndoj vetëm bashkë me të tjerë.

EMIRA: Nuk të besoj, pse të kam dëgjuar kaqë herë kur e këndoje edhe ti vetë.

KALINA: S'është e vërtetë, mos ka qënë ndonjë tjetër.

EMIRA: Diç zotin, moj ndrikull! Si s'e njohkam unë zërin tënd nga ai i një tjetre? Nuk të kujtohet ty, kur në muajin e qershorit mblidhje gjethe në Gracian e kur nga maj' e manit këndonje dhe i bëje të kumbonin të gjitha ato lugina?

KALINA: Popo! si m'iku nga mëndja. Unë harroj shpejt çdo gjë. E lumja ti, moj Emirë, ç'kujtesë të gjallë që ke!

EMIRA: S'është e vërtetë, motër; mua s'më kujtohen as ëndërrat më të forta që shoh.

KALINA: Mirë thua, sepse ëndërrat fluturojnë dhe treten si retë të shtyra nga era; po jo të ngjarat dhe të pësuarat që thellohen mirë ndër tru.

EMIRA: Të gjithë gjërat.

KALINA: Trutë e mija unë nuk e dij se si janë. Kur nuk dua ta kujtoj një gjë ato ma mbajnë gjithnjë përpara syve, po pastaj kur e dua ta kujtoj atë gjë, sikur e largon nga unë një frymë e huaj dhe ma humb. Apo e dëgjon, moj ndrikull, atë të kënduar andej lart?

EMIRA: Jo.

KALINA: Vërja mënden dhe dëgjo.

EMIRA: Më ler të mbush kotruvet.

KALINA: E dëgjova përsëri.

EMIRA: Edhe unë, ç'do të jetë vallë?

KALINA: S'e dijmë. Eja të vemi.

EMIRA: Thirru deleve edhe ngana.

KALINA: Ma jep të ta mbaj këtë kotruve.

EMIRA: Jo, motër, se në të paftë jot ëmë, të hedh ndonjë fjalë dhe unë nuk dua të dëgjoj fjalë.

KALINA: Afër shtëpisë ta jap prapë.

EMIRA: Atëherë bej si të duash.

KALINA: Pa vështro sa ëmbël këndojnë!

*Anton Santori*

## **Shpjegim**

"Emira" e Anton Santorit është drama e parë në gjuhën shqipe. Aty trajtohet gjerësisht dukuria shoqërore e cubërisë, që Santori e kishte prekur edhe te novelat e romanet. Ngjarjet zhvillohen në fshatin arbëresh Shën Katerinë të Italisë.

Subjekti me pak fjalë është ky: dy vajza fshatare, Emira dhe

Kalina, dashurojnë të njëjtin djalë, Mirianin, të cilit i rrah zemra për të parën. Po këtë e lakmon edhe bariu i derrave të fshatit, Kallonjeri, njeri pa skrupull, që i vjen rrotull edhe Kalinës.

Veprimi zhvillohet në dy linja, përpjekjet e Fumelit për zbulimin e bandave të cubave nga njëra anë, dhe pengesat që i sjell dashurisë së Emirës dhe Mirianit, zilia e Kallonjerit dhe e Kalinës, nga ana tjetër. Kjo zili e shpie përpara veprimin. Si kallauz i cubave, Kallonjeri i shtyn ata t'i djegin kasollen e t'i mbytin bagëtinë Mirianit, orvatet të rrëmbejë edhe Emirën, po s'ia arrin qëllimit (se vajzën e shpëton vëllai i Mirianit, Albenci). Ky gati sa nuk e vret Kallonjerin, që padit Mirianin me të atin si bashkëpunëtorë të bandave.

Të dy arrestohen dhe janë gati për t'u pushkatuar, kur intrigantin Kallonjer e vrasin vetë cubat për poshtërsitë e tij. Gabimi sqarohet. Miriani me të atin lirohen nga burgu; dhjetë cuba pushkatohen.

Drama mbyllet me një fund të lumtur: vendi shpëton prej grabitjeve dhe vrasjeve. Emira dhe Miriani martohen, kështu edhe Kalina me Albencin.

Drama frymëzohet nga simpatia e autorit për njerëzit e thjeshtë, nga dhimbja për jetën e vuajtur të fshatarëve.

Me realizëm janë pasqyruar rrethanat tipike të jetës së fshatarëve arbëreshë të kohës. Këtu na dalin personazhe të gjalla e të goditura si: Emira, Kalina dhe nënat e tyre.

Në figurën e Emirës kemi tipin e vajzës së thjeshtë të popullit, plot virtyte e cilësi të trashëguara nga mjedisi ku u rrit.

Kalina është lozonjare e ziliqare, po në thelb naive e zemërmirë. Një figurë e ndërlikuar është edhe Kallonjeri: djalë i ri, i etur për jetë e dashuri, i pashëm, këngëtar i talentuar, por tek ai është tepër i fortë egoizmi që e shndërron në një hipokrit, intrigant të gatshëm të përdorë çdo rrugë për të arritur qëllimet e veta.

Ljipisia dhe Ligjëresha janë figura të goditura plakash fshatare, të cilat kanë të përbashkët mentalitetin konservator.

Dramën "Emira" e gjallëron humori i këndshëm. Dialogu është i zhdërvjelltë dhe ka frymë popullore.

## **Detyrë**

*Lexojeni në tërësi dramën e parë të letërsisë shqiptare "Emira" të shkrimtarit Anton Santori.*

## DIALOGU DHE MONOLOGU

Veprimet dramatike e japin jetën nëpërmjet dialogëve, monologëve dhe veprimit të personazheve. Ne këto vepra mungon fjala e autorit. Vendin e saj e zë gjuha e personazheve (dialogu, monologu).

Dramat, zakonisht, kanë në qendër një konflikt të vetëm, kurse, konfliktet e tjera janë të dorës së dytë, i shërbejnë zgjidhjes së konfliktit kryesor.

Këto vepra shkruhen për t'u shfaqur në skenat e teatrit, prandaj duhet të plotësojnë disa kërkesa, si: të mos zgjaten më shumë se dy orë, ngjarjet të jenë shumë të përqendruara dhe të paraqiten sikur zhvillohen para syve të shikuesit, në kohën e tashme.

Personazhet vendosen përballë njëri-tjetrit. Veprat dramatike ndërtohen me akte, skena ose pjesë.

Kompozicioni në veprën dramatike është më i ndërlikuar. Aty mbizotëron dialogu dhe monologu, si formë e të shprehurit të aktorit.

**Dialog** është bashkëbisedimi që zhvillohet ndërmjet dy personazheve, ndërsa **monolog** quhet biseda që e zhvillon një personazh duke folur me vetveten ose që u drejtohet lexuesve, dëgjuesve a shikuesve në një shfaqje teatrale.

Në vijim po japim një monolog dhe një dialog nga komedia "Koprraci" e Molierit.

### **KOPRRACI**

- *Komedi* -

(akti IV, skena VII)

Harpagoni është fajdexhi i pasur dhe koprrac i jashtëzakonshëm. Kleanti, i biri, në bashkëpunim me shërbëtorin e tij, marrin arkën me florinj. Harpagoni bëhet si i marrë dhe thërret komisarin e policisë për zbulimin e hajdutëve.

*Personazhet kryesore në këtë pjesë:*

Harpagoni (koprraci) - i ati i Kleantit dhe Elizës

Kleanti - i biri

Eliza - e bija

Komisari i policisë etj.

## MONOLOG

HARPAGONI - *(thërret që nga kopshti dhe del në skenë pa kapelë).*

Hajdutët! Hajdutët! Vrasësit! Kriminelët! Oh! I mjeri unë! Drejtësi, o Zot i drejtë! Më fikën, më vranë, më prenë kokën, më vodhën paratë e mia! Kush m'i ka marrë? Ç'u bë? Ku është? Ku fshihet? Si mund ta gjej? Ku të vete? Ku të mos vete? Mos është atje? Mos është këtu? Kush je ti? Qëndro! Paratë!

Paratë, i poshtër!... *(Zë krahun e tij).* Oh, jam unë! M'u prish mend ja s'di ku jam, cili jam e ç'po bëj. Oh, paratë e mia të gjora, miqtë e mi të dashur! Më lanë pa ju. Tani që ju rrëmbyen prej meje, e humba mbështetjen, ngushëllimin, gëzimin; të gjitha mbaruan për mua; s'më duhet më jeta; pa ju është e pamundur të rroj. Kaq ishte, më la fryma, po vdes, vdiqa, më varën. S'ka ndonjë zemërbardhë që të më ngjallë, të më kthejë verdhushkat e mia të dashura, ose të më thotë kush m'i ka marrë? E? Si thoni? Asnjë s'ka? Kushdo që ma bëri gjëmën, mirë ma gjeti rastin; zgjodhi tamam kohën kur i flisja atij të mallkuarit djalë. Të dal. Të vete në polici, t'i them t'i shkojnë në hell të gjithë të shtëpisë, me shërbëtorë e shërbëtore, me djalë, me vajzë, more dhe mua vetë. Sa njerëz qenkan mbledhur! Kujtdo që i hedh sytë, më bën të dyshoj, të gjithë më ngjajnë me hajdutin që më vodhi. Ej! Për cilin flisni atje tej? Për atë që më vodhi? Çfarë zhurme bëhet atje lart? Mos është atje hajduti? Amani, kush e di ku është futur, i lutem të ma tregojë! Mos është fshehur aty në mesin tuaj? Më vështrojnë të gjithë dhe qeshin. Keni për të parë, edhe ata kanë gisht në vjedhjen që më është bërë patjetër. Hajde, shpejt, komisarë, xhandarë, gjykatës, litarë, trarë, xhelatë! Të gjithë t'i varin, të gjithë: dhe sikur të mos i gjej paratë e mia, do të varem edhe vetë pastaj.

\* \* \*

## DIALOG

KOMISARI - Ma lini mua në dorë. Ai është zanati im. U regja në këso punësh. S'është e para herë që po merrem me zbulimin e hajdutëve dhe do të isha bërë pasanik i madh sikur të kisha aq thasë nga një mijë franga sa njerëz kam varur.

HARPAGONI - Të gjithë gjykatësit të interesohen për shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe, në qoftë se nuk m'i gjejnë paratë e mia, do të kërkoj drejtësinë e drejtësisë.



KOMISARI - Duhet bërë gjitha hetimet e nevojshme. Sa para kishit në arkë, thatë?

HARPAGONI - Dhjetë mijë florinj, të numëruar një për një.

KOMISARI - Dhjetë mijë florinj?!

HARPAGONI - Dhjetë mijë florinj.

KOMISARI - Vjedhje e rëndësishme.

HARPAGONI - S'ka torturë që mund ta lajë këtë krim kaq të madh dhe, sikur të mos i jepet dënimi i merituar hajdutit, s'ka siguri më as për gjërat më të shenjta.

KOMISARI - Në ç'monedhë ishte kjo shumë?

HARPAGONI - Në flori tingëllues.

KOMISARI - Cilin dyshoni për këtë vjedhje?

HARPAGONI - Të gjithë! Dua të arrestoni e të burgosni qytetin me gjithë rrethet.

KOMISARI - Po të më dëgjoni mua, nuk duhet të inatosim asnjëri, po të mundohemi me të urtë e me të butë të shtiem ndonjë provë në dorë, që të mundim të veprojmë pastaj me anën e forcës dhe të kërcënim për t'i gjetur gjithë paratë që ju kanë vjedhur.  
*(Kleanti i jep arkën me florinj me kusht që Harpagoni të heqë dorë nga marrëzia e tij për t'u martuar me Marianën).*

Molieri

## Shënim

Kjo pjesë është marrë nga komedia "Koprraci" e shkrimtarit të madh francez Molier, emri i vërtetë i të cilit ishte Zhan Baptist Pokëlen (1622-1673).

Përmes skenave me humor të goditur, Molieri demaskon koprracinë që shkatërron shpirtin e njeriut.

## Fjalor

**koprrac** - ai që kursen tej masës edhe për sendet e domosdoshme për jetesë; ai që ka para dhe nuk ndihmon tjetrin kur ky ka nevojë, njeri dorështrënguar.

**gjëmë-a** - fatkeqësi e madhe, e keqe e madhe

**xhelat-i** - vrasës, mizor, ai që pret kokën e njeriut

**u regja** - u mësova, u kalita

**hetim-i** - zbulim, vëzhgimi me kujdes për të zbuluar diçka

**t'i shkojmë në hell** - t'i mundojmë shumë, t'i vrasim në mënyrë të egër

**kanë gisht** - marrin pjesë në një veprim, kanë dijeni

## Pyetje dhe detyra

- Si e jep autori gjendjen e koprracit, kur kupton se e kanë vjedhur?
- Pse autori përdor një varg pyetjesh?
- Si ndikojnë ato te lexuesi ose te shikuesi i komedisë?
- Si e kuptoni shprehjen e koprracit: "Tani s'më duhet më jeta"?
- Ç'tregon çasti kur koprraci zë krahun e tij dhe pandeh se kapi hajdutin?

### MOLIERI (1622-1673)

**Zhan Batist Molier** është komediografi më i madh francez. Në moshën 20-vjeçare doli në skenë dhe u çmua si aktor komik. Më 1643 formoi teatrin e vet "Molier", në skenën e të cilit u luajtën me sukses komedi dhe tragjedi të ndryshme.

Ka shkruar shumë komedi, nga të cilat më të njohura janë: "Tartufi", "Mizatropi", "Koprraci", "Don Zhuani", "Borgjezi xhentëlmen", "I ligu për mend" e të tjera.

Veprat e Molierit kanë rëndësi mjaft të madhe, si për letërsinë franceze, ashtu edhe për letërsinë botërore. Është përkthyer në shumë gjuhë të botës. Në letërsinë shqiptare është imituar nga Çajupi, Fishta e shkrimtarë të tjerë komedish.



## Shpjegim

Dialogu apo bashkëbisedimi përveç se në dramatikë, shumë shpesh haset edhe në veprat e tjera letrare, si dhe në jetën e përditshme.

P.sh.:

a)

Tana

Ç'bën ashtu, moj Kote?

Kote

S' është puna jote.

Tana

Moj, mos je e marrë? Kam ardhë më parë.

Kote

S'mund të rri këtunë, Kam të tjera punë, po hiq nga unë!

Tana

Ç'thotë kjo murtajë!

Kote

Ujku të të hajë!

\* \* \*

b)

- Ç'po bën shamia?

- Asgjë, gjysh.

- A po e valëvit era?

- Po, gjysh.

- Nga po valëvit, nga lindja apo nga përendimi?

- Nuk e di, gjysh.

Gjyshi priti dhe pastaj tha:

- Nga deti, apo nga toka?

- Nga deti, nga deti...

\* \* \*

c)

NËNA: Agim, zgjohu!

AGIMI: Sa është ora?

NËNA: Shtatë.

AGIMI: O, qenkam vonuar!

NËNA: Jo, bir. Sot nëna do të të

dërgojë në shkollë me veturë.

AGIMI: Mirë, nënë.

# TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA



## **BISEDA DHE DISKUTIMI**

Kur je duke folur me një mik për motin dhe ai të thotë se moti i vranët e me reshje e bën të mërziur dhe e pengon të shëtisë, ndërsa ti i përgjigjesh se një mot i tillë për ty është i bukur e interesant, në fakt ju nuk po realizoni një diskutim, por një bisedë të rëndomtë.

Biseda është një shkëmbim i lirë mendimesh ndërmjet dy a më shumë njerëzve për çështje të jetës së përditshme a të punës.

Diskutimi është tërësia e mendimeve dhe e pikëpamjeve që shpreh njeriu rreth një çështjeje që shqyrtohet. Ai është një lloj komunikimi që kryhet ndërmjet disa personash, të cilët shkëmbejnë opinione për një problem të caktuar.

Diskutimi organizohet për të bindur dikë ose për të informuar të tjerët.

### **DISA RREGULLA PËR ZHVILLIMIN E DISKUTIMIT**

▶ Çdo njeri, i pranishëm në një diskutim, duhet të përpiqet të marrë pjesë në të e të shprehë mendimin e tij të argumentuar, shkurt e pa përsëritje.

▶ Duhet të dëgjojmë me vëmendje të tjerët kur flasin dhe mund të mbajmë shënime gjatë gjithë diskutimit për çështjet më të rëndësishme të tij.

▶ Të flasim e të ndërhyjmë në diskutim, kur na jepet fjala nga drejtuesi i diskutimit.

▶ Nuk duhet t'i ndërpresim të tjerët kur flasin.

▶ Si rregull, diskutimi duhet të ketë një drejtues, i cili ka për detyrë të hapë diskutimin e ta drejtojë atë në rrugën e duhur, duke u kujdesur që diskutuesit të mos flasin gjatë, të mos dalin nga tema, të flasin me leje dhe në mënyrë të kulturuar.

▶ Drejtuesi i diskutimit nuk mban qëndrim, pra nuk jep mendimin e tij gjatë diskutimit. Ai bën përmbledhjen, jep përfundimet e diskutimit dhe e mbyll atë.

## Lexojmë

*Lexojeni në role këtë dialog.*

FISNIKU: Mirëdita!

DAFINA: Mirëdita!

FISNIKU: Si quhesh?

DAFINA: Unë quhem Dafina. Po ti?

FISNIKU: Unë jam Fisniku.

DAFINA: Nga je?

FISNIKU: Jam nga Shkupi. Po ti, nga je?

DAFINA: Unë jam nga Struga.

FISNIKU: Në cilën klasë je?

DAFINA: Jam nxënëse e klasës së dytë. Po ti? Në cilën klasë je?

FISNIKU: Unë jam në klasë të tretë. Gëzohem që u njohëm.

DAFINA: Edhe mua më vjen mirë.

## PËRSHËNDETJET

Njerëzit që kanë mirësjellje, asnjëherë nuk harrojnë të përshëndetin.

Me përshëndetje shprehim dashuri, miqësi, kujdes, përzemërsi, afri.

Shqiptarët kanë përshëndetje shumë të bukura dhe shumë kuptimplote. P.sh. kur takohen me njëri-tjetrin i shtrëngojnë duart dhe thonë:

- Tungjatjeta!, Mirëmëngjes!, Mirëdita!, Mirëmbërëma!  
Ndërsa kur ndahen shprehen:

- Mirupafshim!, Mirutakofshim!, Ditën e mirë!, Natën e mirë!  
Kurse në telefon themi: - Mirudëgjofshim!

Por, fjalori i përshëndetjeve është i pafund. Kur e ndihmon dikë për të bërë ose për të kryer një punë, ai të falënderon me

fjalët:

- Faleminderit! - ndërsa mirëbërësi të përgjigjet:

- Qofsh me nder!

Shpesh i dëgjojmë edhe përshëndetjet:

- Mirë se ju gjej! Mirë se vjen! Mirë se vini! Paçi këmbën e mbarë! etj.

## KËSHILLA PRAKTIKE

Gjatë bisedës në telefon duhet të tregojmë kulturë dhe mirësjellje. Mund t'i përdorim këto shprehje: alo, urdhëro, ju lutem, faleminderit, dua të bisedoj me... etj.



### Detyrë

1. Aktrojeni një bisedë telefonike me shokun tuaj.

### Detyrë

2. Simuloni në klasë një bisedë ndërmjet nxënësit dhe pedagogut të shkollës lidhur me nevojën e pasurimit të laboratorit të informatikës me pajisje të reja didaktike.

3. Simuloni në klasë një bisedë ndërmjet nxënësit dhe drejtorit të shkollës për rregullimin e oborrit të shkollës.

## **TË TREGUARIT** **(me shkrim dhe me gojë)**

Për çdo ditë tregojmë ngjarje të ndryshme në shkollë, në familje e në shoqëri. Tregojmë diçka që dimë ne për t'i informuar të tjerët. Ka dalim ndërmjet tregimit të përditshëm apo tregimit joartistik dhe tregimit artistik.

Me tregimin joartistik rrëfejme një ngjarje të jetës së përditshme, me gjuhë të qartë e me stil të thjeshtë. Me tregimin artistik tregojmë një ngjarje të imagjinuar, por edhe nëse është e vërtetë në të ka plot imagjinatë, me plot figura e me stil të lartë.

Tregimi mund të jetë i shkurtër ose i gjatë. Ata kanë strukturë të thjeshtë: fillimin (hyrjen), trupin (pjesën qendrore, thelbin e informatave) dhe përfundimin. Në fillimin e tregimit zakonisht jepen shembuj apo ndonjë anekdotë që ilustron idenë. Në trupin e tregimit jepen lajme të reja, ngjarjet tregohen, jepen shembujt etj. Në përfundim jepen vlerësime të përgjithshme apo edhe ndonjë porosi, mësim që duhet nxjerrë.

### **Lexojmë**

#### **TREGIMI PA MEND**

Një mbrëmje, vogëlushi Armend, iu lut gjyshit që t'i kallëzojë një tregim pa mend. Gjyshi rrudhi supet, mbeti i hutuar, por kësi tregimi - tha, nuk paskam dëgjuar.

- Si? - pyeti Armendi, po çuditëm shumë, a bën gjysh t'ia filloj unë.  
- Posi - tha gjyshi, edhe shumë u gëzua, nga barra që i ngarkoi Mendi, sikur u lirua.

- Atëherë - tha Armendi, të lutem mirë dëgjo, nëse nuk është i tillë, mos e prano.

- Mirë Mendi, fillo sa më parë, për ta dëgjuar këtë tregim jam tepër kureshtar.

Pasi ca çaste Armendi mendoi, tregimin e tij kështu e filloi:



Na ishte një çun, emrin nuk ia di, por ishte tepër çapkën, nuk dëgjonte as babë, as vëlla, as motër, as nënë.

Gjyshi ngrysi vetullat, nga vendi u ngrit, - nga ishte ky çun or vëlla kaq i pacipë?

- Vendin nuk ia di - u përgjigj Mendi, as kurrë nuk e kam takuar, por se ka qenë i tillë, për këtë e kam dëgjuar.

Vazhdo më tutje, më trego, ç'bënte ai lanet? - paska qenë i çuditshëm me të vërtetë.

- Po - tha Armendi, i çuditshëm shumë, për çdo ditë ai shkonte në lumë.

- Ç'ka të keqe këtu or vëlla? - pyeti gjyshi, unë nuk di, mos qenka lumi vetëm për të rritur e jo edhe për fëmijë.

- Është, është, si nuk është - tha Mendi, pak i nervozuar, po pasi detyrat t'i ketë mbaruar.

- Eh, aty ke të drejtë - gjyshi pranoi dhe për të vazhduar tegimin nga Mendi kërkoi.

- Kam të drejtë, si nuk kam, të lutem prit pak, ky çun cipëplasar çdo herë kthehej me natë. Merakosej e ëma, babai, gjyshi, gjyshja, motrat e vëllai. E jepte besën se ashtu më nuk do të vepronte, por të nesërmen të gjitha i harronte.

- S'është e mundur - tha gjyshi, besën për ta harruar, kësi çunash asnjëherë nuk kam takuar.

- Është e vërtetë, për kokë të mamit po, po deshe mos beso.

- Po mirë tha gjyshi, ja po të besoj, po tjetër ç'bënte, a mund të dëgjoj.

- Mundesh or gjysh, si nuk mundesh, unë do të tregoj, por të lutem mos më ndërpre deri sa ta mbaroj.

- Pajtohem - tha gjyshi pak i menduar, ta jap fjalën deri në fund kam për të dëgjuar.

- Ky çuni - vazhdoi Mendi, asnjëherë me kohë nuk zgjohej dhe për



mësim çdo ditë vonohej. Pastaj, detyrat rrallë i shkruante, vetëm me laps kokën e kruante. Rrugës për në shtëpi sillej shumë keq, nuk përshëndeste as fëmijë, as të rritur, as pleq. Fjalët e ndyta s'i hiqte nga goja, nuk e dinte i gjori se ç'është loja.

Këshillat e mësuesit nuk kishin ndikuar, edhe prindi kot e kishte çortuar. Prapështitë e tij nuk kishin patur të sosur, për asnjë çast me to nuk ishte ngopur. Dikush, me sytë e tij e paska shikuar, çerdhet zogjëve duke ua shkatërruar. Edhe në një kopsht tinzisht ishte futur, lulet më të mira, pa kurrfarë nevoje i kishte këputur. Tash së voni, një plak e paska zënë, xhamit të shoqës së klasës, Dritës me një guralec duke i rënë. I ati i Dritës prapa iu kishte lëshuar, e po ta kapte, kushedi puna si do të kishte mbaruar.

A nuk është ky, or gjysh, tregim pa mend, kur të gjitha veprimet e personazhit janë pa vend.

- Pajtohem - tha gjyshi, Armendin e përqafoi, për mençurinë e tij, të mira i uroi.

*Riza Haziri*



## BARASPESHA (RESTITUCIONI)

Komunikimi gjuhësor me gojë dhe me shkrim është një praktikë e përditshme. Njeriu në çdo hap ballafaqohet me nevojën për të biseduar me të tjerët, për t'iu drejtuar dikujt me letër, telefon, internet; për të shkruar ndonjë ftesë, kërkesë (lutje), ankesë, biografi, për të këmbyer letra etj.

Të gjitha këto forma të komunikimit i shtrohen një kulture të caktuar gjuhësore. Secila formë ka disa kërkesa të caktuara, të cilave duhet t'u përmbahet hartuesi i tyre. Ne do ta trajtojmë shkurt secilën prej tyre veç e veç, sa për të dhënë disa udhëzime të nevojshme.

### **Në vijim po japim disa rregulla themelore të kulturës gjuhësore:**

- Kultura gjuhësore është shprehje e nivelit të përgjithshëm kulturor të njeriut.
- Përdorimi i gjuhës letrare me mjeshtëri është tregues i njeriut të kulturuar.
- Ai që flet e shkruan mirë, ka shumë sukses në jetën dhe në punën e tij.
- Ka kulturë si të flasësh, por ka kulturë edhe si të heshtësh.
- Çdo thënie duhet të ketë saktësi logjike dhe gramatikore.
- Ajo që thoni ju, duhet të kuptohet nga dëgjuesi.
- Ndërtimi i rregullt i fjalive është kusht i domosdoshëm për t'i thënë drejt e qartë mendimet, për të qenë të kuptueshëm.
- Para se të shkruani ose të thoni diçka, duhet ta dini se ka shumë materiale për atë temë.
- Ka shumë mënyra për ta thënë po atë mendim.
- Mësoni nga modelet më të mira gjuhësore.
- Mos harro kujt i drejtohesh dhe për se. Zgjidh rrugën më të mirë për të shprehur mendimin, kërkesën, lutjen, porosinë, për ta bërë pyetjen etj.

- Mos ngurroni ta fshini atë që keni shkruar dhe të kërkonti zgjidhje të tjera.
- Zgjidheni fjalën më të përshtatshme për të shprehur atë që mendoni.
- Përdorni përemrin **Ju**, drejtohuni tjetrit me titullin që i përket dhe filloni me fjalë mirësjelljeje: *Më falni...*, *Ju lutem ... A ka mundësi...*, *Më lejoni...*, *Me leje...*, *Urdhëroni ...*
- Kur njerëzit kanë marrëdhënie të këqija, një pjesë të fajit e ka gjuha që përdorin njëri me tjetrin.
- Mos përdorni fjalë fyese e sharje.

## Lexojmë

### FJALËT

Të dashur lexues, ju që përdorni kaq shumë fjalë në ditë, a keni menduar ndonjëherë për to?

#### Fjalët janë si sendet

Fjalët u ngajnë rrobave tingullore të sendeve. Sipas tyre i njohim ato, i veçojmë njëri prej tjetrës, siç mund të dallojmë *një mësues* nga *një ushtar*. Për shembull, kur dëgjojmë fjalën *shkollë*, kurrë nuk mendojmë *mollën*, edhe pse nga jashtë janë shumë afër. Por ndodh që një send nganjëherë të ketë disa palë rroba ashtu si ne njerëzit. Merreni një shoqe tuajën. Ju e thërritni me *emrin e vet*. Nëna e quan *bijë*. Vëllai i vogël e thërret *motër*. Të tjerët mund ta quajnë *çupë*, *gocë*, *vajzë* ose *çikë*. Ju e keni *shoqe*. Por ajo është edhe *nxënëse*. E kjo është e njëjta, apo jo?

#### Herë-herë fjalët na duken si njerëzit

Lindin. Rriten. Jetojnë gjatë, gjatë. Dalëngadalë edhe ndryshojnë. Herë bëhen të shkurtra, herë të gjata. Por vazhdimisht përriten. Kështu rrallë u bie të plaken, e shumë më rrallë të vdesin fare. Zakonisht, vdesin ato që nuk enden nga goja në gojë, nga letra në letër.

### **Fjalët janë si lulet**

Ato gjenden kudo përreth nesh. Disa janë këtu. Disa janë atje. Disa i di unë. Disa i di nëna. Disa i di mësuesja. Disa i gjen në gazeta. Disa i dëgjon në radio. Disa i mëson nga televizori. Por më së shumti fjalë ka në libra.

### **Fjalët janë si urat**

Pa to çdo njeri do të mbetet i vetmuar. Merreni me mend, ç'do të bënim po të mos ishin fjalët? Si do t'ia shfaqnim nënës dashurinë tonë të pamatur? Si do të loznim me shoku-shokun? Si do ta përshëndetnim mësuesen kur të shkonim në shkollë? Si do ta njihnim botën përreth? Si do t'i shkruanin vargjet e tyre të bukura Naimi, Migjeni ...? Si do të jepte kushtrimin Skënderbeu?

### **Fjalët janë si fëmijët**

Edhe ato kanë dëshirat dhe huqet e veta. Duan që të përdoren me kujdes. Dëshirojnë të ruhet radha dhe forma. E kanë mërzi sidomos po t'u heqim ë-në. U vjen shumë keq po t'ua ndërrojmë vendet ç-së dhe q-së, ose gj-së, xh-së. Dhe kanë të drejtë. Mendoni vetë, si do t'ju dukej juve sikur dikush, nga pakujdesia, t'jua përdridhte qafën, t'jua thyente gishtërinjtë, t'jua shtypte hundën, t'jua priste veshin ...?

### **Fjalët janë si armët**

E ne si ushtarët. Sa më shumë fjalë të kemi, më të fuqishëm do të jemi. Secila fjalë është një armë më vete.

### **Fjalët janë si ilaçet**

Kush ka fuqi më të madhe shëruese se fjala e ëmbël e nënës, se fjala e çiltër e shokut, se fjala nga zemra e mikut?

Askush.

Prandaj t'i përdorim vetëm si ilaçe. Si? Të flasim vetëm fjalë të mira, që ato të na shërbejnë si ura, që të na i mbushin zemrat me dashuri.

Atëherë edhe unë në fund po ju them një fjalë të mirë:

**MIRUPAFSHIM!**

*Arif Demolli*

## RITREGIMI

(me gojë dhe me shkrim)

Shpeshherë kemi nevojë të ritregojmë përmbajtjen e një teksti të lexuar, të një shfaqje teatrore të shikuar, të ndonjë ngjarjeje të përditshme etj. Me anë të të ritreguarit, me fjalë tona, të tjerëve u transmetojmë atë që e kemi kuptuar gjatë të lexuarit, të shikuarit apo të dëgjuarit.

Për të ritreguar diçka që lexojmë, që shohim apo që dëgjojmë nuk është gjë e lehtë apo e thjeshtë. Duhet të kemi aftësi që me fjalët tona të tregojmë bukur dhe këndshëm për të pasur dëshirë për të na dëgjuar apo lexuar të tjerët.

Për të bërë një ritregim të këndshëm, duhet pasur parasysh disa kërkesa paraprake:

- ta lexojmë disa herë tregimin, ta dëgjojmë ose ta shikojmë me vëmendje ndodhinë;
- të veçojmë pjesët themelore: hyrjen, brendinë dhe përfundimin e ndodhisë, dhe
- të veçojmë shprehje më të bukura të burimit.

*Të marrim si shembull për ritregim këtë legjendë të shkurtër.*

### GURI I SKËNDERBEUT

Një ditë Skënderbeu porositi mjeshtër Medarin t'i farkëtonte një shpatë të re.

Pas një jave, Gjergj Kastrioti shkoi në farkën e farkëtarit.

- Puna mbarë, mjeshtër! - e përshëndeti Skënderbeu.
- Mbarë paç, kryezot! - iu përgjigj Medari.
- Erdha të marr shpatën që kam porositur. E kini gati? - e pyeti Skënderbeu.
- Po, shpata pret të zotin.
- I kini respektuar porosinë e mia?
- Po, kryezot, të gjitha. Kurrë ne jetën time nuk kam farkëtuar shpatë kaq të madhe e kaq të rëndë, - i tha farkëtari.
- Unë dua të di sa e fortë është? - e pyeti Skënderbeu.

- Më e fortë s'ka si bëhet, - ia ktheu mjeshtri.
- Tani do ta provojmë - i tha Skënderbeu. - Eja me mua!  
Skënderbeu doli nga farka me shpatën në dorë.

Pas tij doli edhe mjeshtrë Medari, si edhe njerëzit që e shoqëronin. Jashtë farkës qe një shkëmb sa një qerre. Skënderbeu hipi në kalë dhe filloi ta godiste shkëmbin me shpatë, pastaj shikoi tehun e saj mos i qe bërë ndonjë dhëmb. Shpata ishte po aq e mprehtë sa edhe më parë.

Skënderbeu i tha Medarit:

- Të lumtë, mjeshtrë! Se shpata s'më duhet si stoli, po për të luftuar.

Skënderbeu shpërbleu mjeshtrin, ngjeshi shpatën në brez dhe iku i gëzuar.

Që atë ditë, shkëmbit ku provoi shpatën Skënderbeu, i thonë "Guri i Prerë", ose "Guri i Skënderbeut".

## Detyrë

Ritregojeni me gojë këtë legjendë.



## **PËRSHKRIMI**

(me gojë e me shkrim)

Me përshkrim kuptojmë atë që shprehim me shkrim a me gojë kur duam të japim pamjen e jashtme të një njeriu, të një sendi, të një vendi etj. ose të tregojmë si u zhvillua një dukuri a një ngjarje; tregim i hollësishëm për diçka. Prandaj, shpeshherë themi: përshkrim i plotë (i gjallë, i qartë). Bëri një përshkrim të mirë (të hollësishëm). E njohëm nga përshkrimi i tij.

### **Teknika e përshkrimit**

#### 1. Si duhet të hartojmë një përshkrim?

a) Përpara se të hartojmë një përshkrim, duhet të përcaktojmë përshtypjen e përgjithshme që do të krijojë objekti i përshkruar. Pas kësaj do të gjejmë elementet që do ta japin këtë përshtypje.

b) Më pas do të mendojmë për planin e përshkrimit.

c) Së fundi, do të përdorim fjalor të përshtatshëm dhe të saktë. (Ku zakonisht përshkruhen fytyra, sytë, goja, hunda, flokët, trupi, pra elementet që përbëjnë trupin e një qenieje).

#### 2. Ku duhet vendosur përshkrimi?

Përshkrimi vendoset:

a) Në fillim të një tregimi:

- kur përshkruhet vendi, rrethanat ku do të fillojë veprimi. Ky vend mund të jetë, sipas rastit, një peizazh (pyll, mal, rrugë etj.) ose një mjedis i mbyllur (shtëpi, dhomë, klasë etj.).

b) Në brendësi të një tregimi:

- kur prezantohet një personazh i ri (e paraqesim duke përshkruar fizikun e tij, gjestet, qëndrimet, bëjmë pra, portretin e tij);
- kur një personazh vjen për herë të parë në një vend dhe ky



vend ka rëndësi për rrjedhën e mëtejshme të veprimeve (përshkruajmë vendin: një shesh, një shkollë, një dyqan etj.);

- kur një personazh përshkon një rrugë të caktuar (p.sh. përshkruhet rruga që bën një njeri në fshat);
- së fundi, kur një personazh ndalon në një pikë vëzhgimi (në dritare, në një kodër, etj.) dhe shkrimtari përshkruan pamjen që shfaqet para personazhit: rrugën, kalimtarët, ndërtesat e tjera etj.

## MBANI MEND

- *Mund të përshkruajmë:*

- objekte ose peizazhe: Përshkrimi i tyre varet nga rëndësia që ka secili për personazhin ose nga mundësia e përdorimit të ardhshëm të objektit (p.sh. arma e krimit në një roman policor).
- personazhe: Bëhet portreti i një njeriu. Përshkrimi varet nga roli i personazhit në tregim.

- *Për të bërë një përshkrim të mirë duhet:*

- të përcaktojmë përshtypjen e përgjithshme,
- të mendojmë për planin,
- të kërkojmë fjalë të përshtatshme.

### NËNA TEREZË



*"Me gjak jam shqiptare; me shtetësi, indiane. Përsa i përket besimit, jam murgeshë katolike. Sipas thirrjes, i përkas botës.*

Nëna Terezë, lindi më 26 gusht 1910 në Shkup. Më e vogla e pesë fëmijëve të Nikollë dhe Drane Bojaxhiut, u pagëzua me emrin Gonxhe Anjeze. Me vdekjen e papritur të babait, kur Anjezja nuk i kishte mbushur ende 8

vjetët, për familjen filluan vështirësitë ekonomike.

Në moshën 18-vjeçe, e shtyrë nga dëshira për t'u bërë misionare, në shtator të vitit 1928, Gonxhja i tha lamtumirë shtëpisë atërore, për të hyrë në Institutin "Motrat e Loretos", në Irlandë. Atje mori emrin motër Mari Tereza, për nder të Shën Terezës së Krishtit Fëmijë.

Në vitin 1929 u nis për në Kalkutë, Indi. Mbajti mësim në një shkollë për vajza dhe më 1944 u emërua drejtoreshë e shkollës për njëzet vjet me radhë.

Qëllimi kryesor i jetës së saj ishte që t'i përkushtohej shërbimit ndaj më të varfërve. Më vitin 1948 veshi për herë të parë sarin e bardhë me anët blu.

Gjatë këtyre viteve, në sa misioni i saj përhapej me të shpejtë, bota filloi t'ia ngulte sytë Nënë Terezës dhe veprës që ajo kishte nisur. Meritoi shumë çmime për veprën e saj, duke filluar nga Çmimi indian "Padmashri" në vitin 1962; për të vijuar me Çmimin e rëndësishëm Nobel për Paqen, më 1979; ndërsa mjetet e komunikimit filluan t'i ndiqnin veprimtaritë e saj me interes gjithnjë e më të madh.

Në vitin 1997 Nënë Tereza kishte 4.000 motra, të pranishme në 610 shtëpi misionare, të përhapura në 123 vende të botës. Si pati takuar Papën Gjon Pali II për herë të fundit, u rikthye në Kalkutë ku kaloi javët e fundit të jetës, duke pritur vizitorë e duke u dhënë këshilla simotrave. Më 5 shtator 1997 jeta tokësore e Nënë Terezës arriti cakun e fundit. Trupi i saj u varros në Shtëpinë-Nënë të Misionareve të Bamirësisë.

Më pak se dy vjet pas vdekjes, për shkak të përhapjes së famës së

shenjtërisë dhe hireve të nxjerra me ndërmjetësinë e saj, Papa Gjon Pali II lejoi të hapej çështja e kanonizimit. Më 20 dhjetor 2002 miratoi dekretin mbi virtytet heroike dhe mrekullitë e bëra me ndërmjetësinë e saj.

## Fjalor

**murgeshë** - anëtare e një urdhri fetar, që rri në një manastir e bën një jetë prej asketi. Murgeshë katolike.

**misionar** - pjesëtar i një misioni.

**amshim** - jeta e pafundme, përjetësi.

**kanonizoj** - e quaj dikë a diçka të shenjtë.

## Detyrë

1. Përshkruajeni figurën e Nënë Terezës:

- a) fëmijërinë e saj,
- b) moshën rinore të saj,
- c) veprat e bamirësisë,
- ç) dukjen e saj të jashtme dhe
- d) tiparet dhe virtytet e brendshme.



## **NJOFTIMI** (me gojë e me shkrim)

Çdo ditë flasim e shkruajmë. Marrim informata nga të tjerët, por edhe ne i njoftojmë ata për shumë gjëra. Dikush di të flasë mirë e rrjedhshëm, por edhe të shkruajë aq mirë saqë është kënaqësi të lexosh shkrimet e tij.

Në revistat për fëmijë, në gazeta, në radio e televizor çdo ditë lexojmë e dëgjojmë informata të ndryshme nga jeta e përditshme Edhe ju nxënës të dashur, duhet të përpiqeni të flitni e të shkruani sa më mirë.

Shkathtësia e të folurit dhe e të shkruarit mirë nuk arrihet vetëm me njohuritë nga gramatika. Për të shkruar mirë, përveç njohurive gramatikore, duhet të kemi para sysh edhe disa kushte të tjera. Ja disa prej tyre:

### **Si të shkruajmë dhe si të flasim bukur?**

1. Para se të fillojmë të flasim ose të shkruajmë, duhet të bëjmë një plan se çfarë duam të themi ose të shkruajmë.

2. Të jemi të vëmendshëm dhe me kujdesin më të madh të shfrytëzojmë gjithë imagjinatën dhe aftësitë tona krijuese.

3. Mendimet duhet t'i shprehim në mënyrë të qartë dhe të drejtë. Të jemi real dhe bindës në atë që e shprehim. Të mos përdorim fjalë fyese. Të flasim qetë e me zë të ulët, jo shumë shpejt as shumë ngadalë.

4. Fjalitë duhet t'i ndërtojmë sipas aftësive tona. Të respektojmë rregullat e drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit, të zgjedhim fjalët dhe të krijojmë fjali sipas natyrës së shqipes.

5. Shkrimi të jetë i lexueshëm dhe i bukur. Tekstin e shkruar ta rilexojmë disa herë dhe ta përmirësojmë.

6. Të lexojmë sa më shumë dhe të ndjekim modelet e mira të të folurit e të të shkruarit. Kështu kanë vepruar edhe shkrimtarët e mëdhenj.

## Pyetje dhe detyra

Para se të përgjigjeni në këto pyetje, siguroni dhe bëni zgjedhjen e të dhënave.

1. A keni në shkollën tuaj seksione të lëndëve mësimore: Seksionin e gjuhës shqipe, Seksionin e matematikës, të artit figurativ, të muzikës ose ndonjë seksion tjetër.

2. A marrin pjesë nxënësit e klasës suaj në ndonjë seksion?

3. Kush janë anëtarët e këtyre seksioneve nga klasa jote.

4. Shkruaj një raport për punën e seksionit ku ti merr pjesë.

## Të shprehurit krijues


1. Shkruaj një lajm të shkurtër për një ngjarje reale ose të përfytyruar.

2. Trego me gojë për suksesin ose rezultatin që ka arritur ndonjë shok ose shoqe e shkollës në dituri, art, sport, muzikë etj.

## RREGULLAT E SHKRIMIT TË TEKSTIT

Siç dihet, çdo njeri është në gjendje ta rrëfejë një ngjarje para të tjerëve, t'u përcjellë një informatë. Mirëpo, disa këtë punë e bëjnë më bukur, më shkathët e disa më dobët. Dikush mund ta ketë përjetuar një ngjarje dhe kjo t'i ketë bërë përshtypje të madhe, por ai mund të mos jetë në gjendje ta shprehë këtë përjetim as me një përqindje të vogël. Dikush tjetër, me mjeshtërinë dhe aftësinë e vet, arrin që edhe ngjarjet e rëndomta t'i përjetojë e t'i shprehë estetikisht, kështu që rrëfimi i tij bëhet më interesant. Atëherë themi se njeriu i tillë është artist i fjalës.

Rregullat e shkrimit të një teksti ose të një diskutimi me gojë u dhanë paraprakisht. Por, për të treguar një lajm, ose për të shkruar një tekst joletrar mbështetemi në pesë rregulla. Pra, duhet t'u përgjigjemi pesë pyetjeve themelore: kush, çka, ku, kur, si (pse). Përgjigjet e këtyre pyetjeve e kompletojnë rrëfimin tonë. P.sh.:



**Njoftimi:**

*Panairi i librit do të hapet më 17 tetor në Tetovë për të ekspozuar para lexuesve krijimtarinë letrare dhe shkencore*

i ndarë sipas 5 pikave do të sistemohej në këtë mënyrë:

**Kush?** - Panairi i librit.

**Çka?** - Do të hapet.

**Kur?** - Më 17 tetor.

**Ku?** - Në Tetovë.

**Pse?** - Për të ekspozuar para lexuesve krijimtarinë letrare dhe shkencore.

## TEATRI

Teatër quhet godina ku pjesët dramatike paraqiten në skenë nëpërmjet aktorëve. Ata veshin rroba të personazheve që i luajnë në skenë. Regjisori u tregon aktorëve si ta luajnë pjesën dhe si t'i thonë fjalët e tyre. Njeriu që e shkruan pjesën quhet dramaturg.



### BISEDIM

- ❖ A e dini ku ndodhet godina e teatrit në qytetin tuaj?
- ❖ A keni shkuar ndonjëherë në teatër?
- ❖ Nëse po, me kë keni shkuar?
- ❖ Çfarë pjese teatrore ke parë?
- ❖ A të ka pëlqyer dhe pse?

### VIZITË MËSIMORE

- Bashkë me mësuesin ose mësuesen vizitoheni teatrin e qytetit.
- Kërkoni nga ndonjë aktor i teatrit që t'ju njoftojë me ecurinë e përgatitjes së një drame.

**I LLASTUARI**  
**(PJESË E VOGËL TEATRALE)**

◆ *Lexojeni në role këtë pjesë teatrale.*

NËNA: Na, o bir, provoje vetëm pak...

DJALI: Jo!...

NËNA: E pse, o bukuroshi im?...

DJALI: S'dua!

NËNA: Pije, o bir, që të rritesh...

DJALI: Nuk dua të rritem!

NËNA: Mirë, pra, lëre, pasi s'po do. Veçse ta dish se ke për të  
ngelur i vogël me trup - si shkurtabiq.

DJALI: Çka, të mbes i vogël si shkurtabiq e të pi qumësht për  
çdo ditë. Jo kurrë!

NËNA: Mirë pra, merre e pije që të rritesh e të bëhesh i madh.

DJALI: S'dua!

NËNA: Hajt o bir, e mos u bëj i padëgjueshëm.

DJALI: Jo, jo, jo!

NËNA: Pije, o bir, se bëhesh ushtar, kalorës.

DJALI: Po si, kalorës e të rrëzohem prej kalit!

NËNA: Mos më lodh më, pije pak. Qumështi është i asaj lope  
që pamë në fshat.

DJALI: Po, po, ti gjithmonë po ma jep qumështin e asaj lope  
laroshe!

NËNA: Paj, more bir, qumështi i çfarëdo lope qoftë është i  
njëjtë. Hajt, pra, pije pak, se bëhesh i fortë.

*(Hyn Skënderi)*

NËNA: Mirë, ja ku erdhi Skënderi! Ai do ta pijë krejt. Eja, eja,  
Skënder...

SKËNDERI: Çka ka aty në gotë?

NËNA: Qumështi i Bardhylit. Por ai nuk dëshiron të pijë,  
prandaj merre ti.

SKËNDERI: Mirë.



DJALI: Punë e madhe, le ta marrë.

SKËNDERI: *(Duke pirë)*: Ohoho, ohoho! Për besë qenka shumë  
i mirë, ohoho!

NËNA: Ja, pra, a po sheh?

DJALI: Anil... Kuku për mua!... Ma piu krejt qumështin...

Tash as do të rritem, as do të bëhem kalorës, as kurrgjë, sepse ma  
piu krejt qumështin. Kuku për mua!

*(Bie perdja)*

## Fjalor

**i llastuar** - që është përkëdhelur jashtë masës, që është  
mësuar keq.

**kalorës** - ai që di të rrijë mbi kalë, luftëtar i stërvitur për  
luftim mbi kalë.

## BISEDIM

- ❖ Cilat janë personazhet e kësaj pjese teatrale?
- ❖ Pse thuhet se janë të llastuar disa fëmijë sikurse ky djalë?
- ❖ A je edhe ti fëmijë i llastuar?

## Detyrë

- Luajeni në role këtë pjesë teatrale.

## FILMI

Filmi është shfaqje me fotografi dhe zë që regjistrohet në një shirit dhe jepet në ekran. Sipas përmbajtjes që kanë, dallojmë: film historik, kriminalistik, film artistik, vizatimor, dokumentar, shkencor, mësimor etj. Sipas gjatësisë së shiritit filmik, dallojmë film me metrazh të gjatë dhe film me metrazh të shkurtër.

Nga vitet 1960 nisi transmetimi i filmave me ngjyra. Sot njerëzit me video mund të regjistrojnë programet e TV ose të përdorin kamerat video për të bërë vetë filma.

Filmi është fryt i punës kolektive në të cilën marrin pjesë disa anëtarë dhe një numër i caktuar aktorësh dhe teknikësh. Filmi duhet të ketë aktorë, regjisor, skenarist, kostumograf, punëtorë teknikë si dhe shumë bashkëpunëtorë.



### TË DISKUTOJMË

Diskutoni për rolin që e luan filmi.

#### TEMA PËR BISEDË:

- Filmi është mjeti më i mirë për të kaluar kohën e lirë;
- Filmi është shkaktar i grindjeve në shtëpi;
- Ai na jep informata të nevojshme ose
- Filmi është vetëm humbje e kohës.

## Detyrë

1. Cilin film vizatimor dëshiron ta shikosh më shpesh dhe pse?
2. Si quhet personazhi kryesor i filmit tënd të dashur?
3. Pse e do atë?
4. A do të bëhesh sikur ai? Pse?

## Të shprehurit krijues

*Zgjedhim një film që e kanë parë të gjithë.*

- Cilët janë personazhet kryesorë të filmit?
- Cilët janë personazhet e dorës së dytë?
- Cilët janë personazhet pozitive?
- Cilët janë personazhet negative?
- Kush është regjisor?
- Kush është skenarist?
- Cili është kostumograf?
- Cili është bashkëpunëtor i muzikës?
- Çfarë ndikimi pati muzika te ti (të ka qetësuar, të ka frikësuar, të ka disponuar etj.)?
- Si zhvillohet ngjarja?
- Si përfundon ajo?
- Si do ta kishe përfunduar ti?

Nxënësit i ndajmë në dy grupe:

1. Grupi i parë flet për vlerat pozitive të filmit.
2. Grupi i dytë flet për vlerat negative të filmit.

Secili grup mendimet i shpreh me shkrim në mënyrë të argumentuar.

## **BIBLIOTEKA**

Pas lindjes së shkrimit, njeriu ndjeu nevojën që gjithçka me vlerë që kishte arritur në fushën e letërsisë, artit, shkencës dhe të teknikës ta ruante e ta përcillte brez pas brezi.

Kështu lindën bibliotekat e para në Egjipt, Siri, Greqinë e Vjetër etj. Pas shpikjes së shtypshkronjës më 1445, bibliotekat shënuan një zhvillim të madh, duke u bërë institucione të rëndësishme të grumbullimit, të ruajtjes, të përpunimit e të programimit të të gjitha llojeve të botimeve (librave, gazetave, revistave etj.).

Në rrugën e gjatë të zhvillimit, bibliotekat kanë ardhur duke u profilizuar. Ekzistojnë:

a) biblioteka kombëtare që grumbullojnë, ruajnë, përpunojnë dhe propagandojnë gjithë krijimtarinë e shkruar të kombit të tyre, si dhe të popujve të tjerë;

b) biblioteka shkencore që ngrihen pranë qendrave studimore-shkencore, industriale etj.;

c) biblioteka popullore që u përgjigjen interesave të popullit;

ç) biblioteka vetjake të cilat u shërbejnë familjeve që i zotërojnë;

d) biblioteka të shkollave që janë në shërbim të nxënësve.

## **BIBLIOTEKA E SHKOLLËS**

Shkolla dhe biblioteka janë një dyshe e pandarë. Gjatë gjithë historisë së saj, shkolla e ka ndjerë si nevojë të brendshme bibliotekën. Që nga Mësonjëtorja e Korçës e vitit 1887 e në vazhdim, pothuajse të gjitha shkollat patën bibliotekat e veta modeste, të cilat plotësonin nevojat e nxënësve për letërsinë dhe shkencën.

Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare u hapën shkollat e para shqipe, u krijuan disa shoqëri që drejtoheshin nga njerëz të shquar, patriotë, shkrimtarë, dijetarë etj., si Sami Frashëri, Jani Vreto, F. S. Noli, Ndre Mjeda, Pashko Vaso, Mit'hat Frashëri, Preng Doçi etj. Pranë këtyre shoqërive u krijuan edhe bibliotekat.

## Si mund të ngrihet një bibliotekë në shkollën tuaj?

Mendojmë se për ngritjen e një biblioteke të re duhet të zgjidhen këto probleme:

Lokali zgjidhet sipas mundësisë konkrete të shkollës. Por, në çdo rast lokali ka rëndësi, sepse hapësira dhe pamja e tij estetike dhe funksionale ndikojnë në motivimin e nxënësve.

Për mjedisin e bibliotekës janë të nevojshme këto pajisje: raftet bibliotekare ku vendosen librat, revistat, gazetat, doserat, kasetat, videokasetat etj.

Duhet të kemi kujdes që të parashikojmë edhe shtimin e tyre nga viti në vit; tryeza, karrige, skedarë; stenda ku reklamohen librat e rinj, libri i vitit, plani i punës, veprimtaritë që do të organizohen, nxënësit më të dalluar si lexues të pasionuar etj., si dhe stenda ku vendosen listat e librave për leximet jashtëklase dhe ato që rekomandojnë mësuesit sipas lëndëve.

Po kështu, për mjedisin e drejtuesit të bibliotekës duhen siguruar: tryezë pune e karrige, libër inventari dhe libër të lëvizjeve të fondeve, kartela për nxënësit, skeda për regjistrimin e librave, vula të bibliotekës, fletëkërkesa (këto në kushtet e bibliotekës së shkollës nuk përdoren, por nxënësit duhet t'i njohin ato dhe të ushtrohen me qëllim që të dinë t'i përdorin), fotokopjues, magnetofon, aparat fotografik, video, monitor, kompjuter. Ndërkaq, për këndin e mirëmbajtjes duhen një tryezë pune, karrige, bojëra, lapsa, vizore, kartona, beze, ngjitës, letër, gërshërë etj.

### Detyrë

- ▶ Flitni se si funksionon një bibliotekë shkolle.



## MIRËMBAJTJA E LIBRIT

Çdo libër përbën një vlerë kombëtare, ai u përket brezave, prandaj të gjithë janë të detyruar ta ruajnë dhe ta mirëmbajnë atë.

Nëpërmjet kartelës së lexuesit, të gjithë ata që dëshirojnë të marrin një libër në bibliotekë njihen me kërkesat dhe detyrimet që kanë ata për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e librit. Si kërkesa të tilla mund të përmendim:

- ▶ të mos e lëmë librin në vende të papërshtatshme,
- ▶ të mos shkruajmë e të mos bëjmë shënime në të,
- ▶ të mos përthyejmë fletët, por të përdorim shënjuese,
- ▶ ta ruajmë që libri të mos griset e dëmtohet dhe, nëse është e nevojshme, ta riparojmë vetë,
- ▶ ai që e humb ose e dëmton librin detyrohet ta zhdëmtojë sipas rregullave.

### BISEDIM

- ▶ A keni bibliotekë në shtëpi?
- ▶ A keni bibliotekë në shkollë?
- ▶ A merrni libra nga biblioteka?
- ▶ A keni bibliotekë në qytetin tuaj?
- ▶ A ju ka qëlluar të dëmtoni padashje një libër?
- ▶ Çfarë keni ndier?
- ▶ A e keni riparuar atë?

### Detyrë

1. Bashkë me mësimdhënësin bëni një vizitë mësimore në ndonjë bibliotekë.
2. Kërkoni nga bibliotekari që t'ju njoftojë me ecurinë e punës në bibliotekë.
3. Çdo të thotë të kesh respekt për librin?

## PROGRAMI COBISS OPATS PËR TË KËRKUAR NË MEDIOTEKË

Në vitet e fundit, shumica bibliotekave të mëdha gjithë titujt e librave që i kanë, i kanë regjistruar edhe në një program të posaçëm elektronik, që njihet si COBISS OPATS. Këto të dhëna për fondin e librave të tyre si mediotekë i japin në rrjetin e Internetit. Pra, COBISS OPATS është një program i posaçëm ku janë të shënuara librat e bibliotekave dhe në këtë mënyrë janë të lidhura të gjitha bibliotekat që zbatojnë këtë program. Deri më tani janë kyçur në mediotekë mbi 600 biblioteka. Këtë program e përdorin Biblioteka Universitare e Popullore e Maqedonisë së Veriut, bibliotekat e qytetit të Shkupit, biblioteka e Manastirit etj.

Përdorimi i këtij programi është i lehtë. Nëpërmjet rrjetit të Internetit hyhet në mediotekë. Aty shënohet titulli i librit, autori dhe më pas marrim informata ku gjendet libri i kërkuar, në cilën bibliotekë jo vetëm në Maqedoni, por edhe në vendet e tjera Evropiane e botërore. Pas informatave që marrim, shkojmë dhe e huazojmë librin e nevojshëm.



### Vizitë kërkimore

► Bëni një vizitë me arsimtarin Bibliotekës Universitare e Popullore të Maqedonisë së Veriut që gjendet në Shkup ose ndonjë bibliotekë tjetër që zbaton programin COBISS OPATS.

► Kërkoni nga udhëheqësi i bibliotekës ose nga bibliotekari t'ju njoftojë konkretisht se si e kërkojmë librin e nevojshëm në mediotekë.

**PYETJE**

**USHTRIME**

**DETYRA**

**LEXIM LETRAR**

**INTERPRETIM**

**TË SHPREHURIT KRIJUES**

**PUNË KREATIVE**



## HISTORIKU I GJUHËS SHQIPE

### DETYRË

1. Lexoni këta rreshta të poezisë “Gjuha Shqipe” të shkruar nga Gjergj Fishta (1871-1940). Çfarë na thotë autori?

### Gjuha Shqipe

.....

Pra, mallkue njai bir Shqyptari,  
qi këtë gjuhë të Perëndis',  
trashigim, që na la i Pari,  
trashigim s'ia len ai fmis;  
edhe atij iu thaftë, po, goja,  
që përbuzë këtë gjuhë hyjnore;  
qi n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,  
flet e t'veten e lën mbas dore.  
Në gjuhë shqype nanat tona  
qi prej djepit na kanë thânun,  
se asht një Zot, qi do ta dona;  
njatë, qi jetën na ka dhânun;  
edhe shqyp na thanë se Zoti  
për shqyptarë Shqypninë e fali,  
se sa t'enden stina e moti,  
do ta gzojn kta djalë mbas djali.

.....

### DETYRË

2. Gjeneroni në internet dhe dëgjoni poezi të Gjergj Fishtës, interpretuar nga aktori i njohur shqiptar Reshat Arbana.

## DETYRË

3. Fjalët që ka përdor Gjergj Fishta shkruaj si përdoren në të folmen tënde dhe si në gjuhën standarde.

Gjuha e Fishtës	Në të folmen time	Në gjuhën standarde
mallkue		
njai bir Shqyptari		
trashigim		
s'ia len fmis		
qi n'gjuhë t'huej		
s'asht nevoja		
t'veten e lën mbas dore		
gjuhë shqype		
nanat tona		
prej djepit		
na kanë thânun		
shqyptarë		
Shqypninë		
do ta gzojn		
kta		
djalë mbas djali		

## DETYRË

4. Këto vargje të vjershës “Ujku dhe Qengji” të Naim Frashërit rishkruani në anën e djathtë në formën standarde.

Ujku pa fe	
Erth në kope	
Dhe, si s'pa qën,	
U fut nër dhën,	
Një qënq zuri	
Zëmërguri.	
Qëngji i tha:	
"Ore vëlla?	
E po përse?	
As më rrëfe	
Se ç'faj të kam?	
I vogël jam."	



## PËRNGJASHMIMI I BASHKËTINGËLLOREVE

### Ushtrohu

1. Formoni formën mohore të foljeve *di*, *dua*, *dal*, *bëj*, *gjej* me pjesëzën e mohimit *s'* (= nuk). Shënoni si shkruhen e si shqiptohen.

	<i>folje</i>	<i>shkruajmë</i>	<i>shqiptojmë</i>
<i>s'</i>	<i>di</i>		
<i>s'</i>	<i>dua</i>		
<i>s'</i>	<i>dëgjoj</i>		
<i>s'</i>	<i>bëj</i>		
<i>s'</i>	<i>gjej</i>		

### mëso më shumë

2. Me ndihmën e arsimtarëve të lëndëve, krahasoni përngjashmimin e bashkëtingëlloreve sipas zëshmërisë në shqipen me përngjashmimin e bashkëtingëlloreve në maqedonishten.

### Plotëso

3. Plotësoni tekstin me bashkëtingëlloret që mungojnë.

### Gjyshi i mirë

Njoh një gjysh shumë të mirë.

Dashuria e tij ndaj nipit është e pakufishme.

Sytë e tij çdoherë janë plot ëmbëlsi kur flet me nipin.

\_\_'ka gjë që \_\_'do ta bënte për të.

Ditët e para e qonte në shkollë dhe e priste që të ktheheshin bashkë.

Por tani më u morën vesh që të shkante vetë, sepse nipi ndjehej i aftë.

Shkon me të në park kur kërkon dhe atje kënaqet duke luajtur.

Kur sheh diçka interesante në shitore për nipin, ia blen, sepse ka dëshirë ta gëzojë.

Kur bën ndonjë sherr, prapë është gjyshi që ia \_\_but sherrin para prindërve, edhe pse kur mbesin vetë e qorton.

E në anën tjetër, nipi e respekton shumë gjyshin.

Kur thotë se diçka \_\_'duhet bërë, atëherë mjafton t'ia thotë vetëm një herë. Nipi e kupton se ashtu duhet të jetë.

Kjo është dashuri e ndërsjellë, por edhe respekt i ndërsjellë.

Kur i shoh, çdo herë ndjej kënaqësi.

## THEKSI I FJALËS

### Ushtrahu

1. Vini shenjën e theksit mbi zanoren e theksuar të fjalëve, si *drejtór, drejtorëshë*:

lexoj, përmirësoj, njeri, qytet, punëtor, nxënës, pesëmbëdhjetë, arsimtar, shkollë, fletore, shtëpi, qiri, lule, kumbull, dituri, vrapoj, shkruaj, shkrimtar, gjuhë, trembëdhjetë, notë

2. Fjalët *njeri, qiri, veri, teneqe, bakllava, baba, Fatime, Xhemile* i shqiptoni me theks në zanoren e fundit apo të parafundit?

### mëso më shumë

*Kërkoni ndihmë nga arsimtari apo prindi që të tregojë se si duhet të shqiptohen fjalët e mësipërme në shqipen standarde.*

## Lexojmë

3. Lexojeni tekstin e mëposhtëm. Kini kujdes si do t'i theksoni fjalët në fjali.

Nëpër fytyrën dikur të njomë e të bukur, të shëndoshë e të plotë, si lulja në mëngjesin e pranverës plot rreze të këndshme dielli, ishin kryqëzuar tash disa rrudha që ia kishin bërë koha dhe vuajtjet, thuajse në atë mënyrë i kishte shënuar çdo vuajtje kujtimet e veta me nga një rrudhë në fytyrën e saj. Të gjitha ato kishin marrë tash pamjen e një rrjete merimange në ndonjë qoshe të çardakut. Edhe trupi i saj, dikur i hollë e i gjatë si selvia në mes të malit, ishte kërrusur pak, tash dukej më e vogël. Sytë i ishin zgjeruar e flokët, dikur aq të zinj e të gjatë, sa të gjitha shoqet ia lakmonin, ishin thinjur e rralluar. Megjithatë, Hajria, pikërisht tani, në këto vite pleqërie, e ndjente veten më krenare se kurrë ndonjëherë më parë. Sa herë e mendonte jetën e vet, i dukej se ka lindur mu atë ditë, që u krijua bota dhe se është më e vjetër se të gjithë njerëzit në të.

*Nazmi Rrahmani,  
"Malësorja" (fragment)*

## GJINIA E EMRIT

### Ushtrohu

Shkruani emrat e orendive e të njerëzve që i shihni në fotografinë e mëposhtme në trajtën e shquar. Në kllapa shënoni gjininë gramatikore të tyre. P.sh. nxënësi - gjinia mashkullore (m).  
mësuesja - gjinia femërore (f).



- |         |          |
|---------|----------|
| 1. .... | 8. ....  |
| 2. .... | 9. ....  |
| 3. .... | 10. .... |
| 4. .... | 11. .... |
| 5. .... | 12. .... |
| 6. .... | 13. .... |
| 7. .... | 14. .... |

## Ushtrohu

*Shkruani në kolonën përkatëse emrat e dhënë:*

televizori, Arbeni, libri, topi, Teuta, plaku, ora, qershia, radioja, nëna, tigr, luga, natyra, fustani, mësuesi, dardha, zjarri, dielli, miu, shtëpia, këmisha, mali, peshku, gjuha, bregu.

*gjinia mashkullore*

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

*gjinia femërore*

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---



## SHUMËSI I EMRAVE


### Ushtrohu

*Lidhni me vijë formën e njëjësit me formën e shumësit.*

njëjës	shumës
shoqe	portokaj
bankë	rrathë
lexues	djem
orë	desh
këmbë	orë
dash	banka
thes	shoqe
djalë	lexues
lepur	këmbë
rreth	thasë
grua	lepuj
portokall	miq
lëng	gishta
mik	fshatra
ujk	letra
gisht	mullinj
dorë	punëtorë
fshat	ftonj
lojë	arinj
gjarpër	gra
letër	gjarpërinj
ari	lojëra
mulli	duar
ftua	ujq
punëtor	lëngje

## Ushtrohu

Emrat: *nxënës, numër, shokë, orë, shqiptarë, kuti, flori, libra, shkëmbinj, klasa, lumë, lexues, natë, derë, lule shkruani në vendet përkatëse.*



## Ushtrohu

Emrat në numrin njëjës, ktheni në numrin shumës (një - disa)

*Shembull : një laps - disa lapsa*

një burrë -----

një mësues -----

një zog -----

një ushtar -----

një lum -----

një vajzë -----

një gomë -----

një shok -----

një mur -----

një lis -----

një qytet -----

një oborr -----

një mësuese -----

një fletore -----

## KATEGORITË GRAMATIKORE TË MBIEMRIT

### Ushtrohu

1. Lidhni emrat e kolonës së parë me mbiemrat e kolonës së dytë.

shkollë	i sjellshëm
lule	besnik
vajzë	e pastër
gjuhë	e re
djalë	e bukur
nxënës	punëtore
klasë	amtare
mollë	i mirë
nënë	e ëmbël
qen	e dashur
dhelpër	i nderuar
mik	dinake

### Ushtrohu

2. Radhite siç duhet emrin e mbiemrin.

besnik djalë - \_\_\_\_\_ e bukur vajzë - \_\_\_\_\_

dimëror kostum - \_\_\_\_\_ i lexuar libër - \_\_\_\_\_

mik i nderuari - \_\_\_\_\_ i lartë mal - \_\_\_\_\_

amtare gjuhë - \_\_\_\_\_ e bardhë bluzë - \_\_\_\_\_

nënë e dashura - \_\_\_\_\_ javore gazetë - \_\_\_\_\_

## Lexojmë

### 3. Lexoni dhe njihuni me cilësitë e portokallit.

Portokalli është një pemë freskuese. Druri i tij është i lëmuar, me degë të holla e me gjemba të gjatë. Gjethet i ka të mëdha. Ngjyra e tyre është e gjelbër dhe e errët.

Kokrra e portokallit është e rumbullakët e me bisht të shkurtër. Kur piqet kokrra e portokallit, merr ngjyrë të verdhë dhe lëngu i ëmbëlsohet.

Portokalli është pemë detare, ajo kërkon klimë të butë e të ngrohtë. Dimri i ftohtë e dëmton këtë pemë frutore, të pasur me vitamina.



## Detyrë

### 4. Gjeni dhe nënvizoni fjalët që tregojnë cilësitë e portokallit.

## Ushtrohu

5. Mbiemrat e dhënë të gjinisë mashkullore ktheni në gjininë femërore. Shkruani në fletore.

i bashkuar, fisnik, i këputur, zemërgjerë, i pandarë, i përparshëm, ujqor, vjeshtor, popullor, kryeneç, i papërdorshëm, malor, shkollor, i zi, i ri, i dendur, dembel.

## Ushtrohu

6. Shndërroni këta mbiemra në gjininë mashkullore.

e qetë - .....	e lumtur - .....
e kënaqur - .....	e pikëlluar - .....
e hidhëruar - .....	e madhe - .....
e kuqe - .....	e zezë - .....
e tmerrshme - .....	e vetme - .....
bardhoshe - .....	dinake - .....
ushtarake - .....	përtace - .....

## Ushtrohu

7. Zgjidhni njërën nga trajtat e dhëna të mbiemrit dhe vendoseni në fjali.

1. Klasa është .....  
Klasat janë .....  
(i madh, e madhe, të mëdhenj, të mëdha)
2. Muri është .....  
Muret janë .....  
(i bardhë, e bardhë, të bardhë, të bardha)
3. Bleta është .....  
Bletët janë .....  
(punëtor, punëtorë, punëtore)
4. Trëndafili është .....  
Trëndafilat janë .....  
(i kuq, e kuqe, të kuq, të kuqe)
5. Libri është .....  
Librat janë .....  
(i ri, e re, të rinj, të reja)
6. Lulja është .....  
Lulet janë .....  
(i bukur, e bukur, të bukur, të bukura)
7. Stilolapsi është .....  
Stilolapsat janë .....  
(i zi, e zezë, të zinj, të zeza)
8. Ora është .....  
Orët janë .....  
(i vogël, e vogël, të vegjël, të vogla)

## Ushtrohu

8. Lakoni emrat me mbiemra sipas tabelës së dhënë më sipër (në trajtë të pashquar dhe të shquar, në njëjës dhe në shumës). Shkruani në fletore.

një kalendar i ri  
një veturë e re  
një trëndafil i kuq  
një çantë e kuqe

## Ushtrohu

9. Mbiemrat në kllapa vini në shkallën krahasore.

- Rrushi i bardhë është ..... (i ëmbël) se rrushi i zi.
- Denisi është ..... (i gjatë) se Agimi.
- Sot dita është ..... (e bukur) se dje.
- Dhoma e ditës është ..... (e madhe) se dhoma e gjumit.
- Vetura ime është ..... (e shpejtë) se vetura jote.

## Ushtrohu

10. Mbiemrat në kllapa vini në shkallën sipërore.

- Arta ka një shoqe ..... (e mirë).
- Merita është ..... (e bukur).
- Banesa jonë ka një ballkon ..... (i madh).
- Blendi ka një qen ..... (i rrezikshëm).
- Në muajin korrik ditët janë ..... (e nxehtë)

## KATEGORITË GRAMATIKORE TË PËREMRRIT

### Ushtrohu

#### 1. Gjeni përemrat në këtë tekst.

Unë nuk kam parë kalë më të mirë se ky. Ai kali i karrocës që kalon nga lagjja jonë s'është asgjë para këtij. Ai vjen çdo mëngjes në oborrin tonë, por s'është i bardhë si ky. As sytë, as barkun s' i ka si të këtij. Vërtetë ka ca zilka të vogla, por yni ka një zile të madhe, të cilën xhaxhi Thomai ia ka zënë me bar. Vetëm, të të them të drejtën, kali mua nuk më do aq sa e dua unë.

### Ushtrohu

#### 2. Gjeni dhe nënvizoni përemrat vetorë në tekstin e mëposhtëm.

Unë jam Beni... Ne banojmë në qendër të qytetit. Unë para një jave mbarova klasën e parë me përfundime shumë të mira. Babai u gëzua shumë. Ai nuk dinte ç'të bënte, kurse mami sa s'fluturonte nga gëzimi. Ajo më puthte vazhdimisht...

Babi dhe mami donin të më blinin një dhuratë.

Unë u thashë:

- Ju më mirë më blini një top...

- E di unë, gjithmonë top do ti, - tha mami.

Ata ecnin para dhe unë mbeta prapa. Mami kundërshtonte. Më në fund ajo më bleu dy libra me përralla, por edhe një top. Unë u gëzova shumë.

### Ushtrohu

#### 3. Zëvendësoni përemrat vetorë me emrat përkatës.

Në strehën e shtëpisë sonë dallëndyshet bëjnë folenë vit për vit. **Ato** shkojnë e vijnë me shpejtësi, punojnë pa u lodhur. Blerta i do shumë dallëndyshet. **Ajo** kënaqet kur u shikon gushën e larme. Një ditë Blerta pa një dallëndyshe të vogël. **Ajo** u përpoq të fluturonte, por ra në tokë. Blerta pa macen. **Ajo** donte ta kapte. Por gjyshja i bërtiti:

- Çit, moj Pambuke!

Macja e ka frikë **atë**. Blerta mori shkallën. **Ajo** hipi në shkallë duke e mbajtur me kujdes dallëndyshen e vogël në njërën dorë, dhe e vuri **atë** ngadalë në fole.

## Ushtrohu

4. Gjeni dhe nënvizoni përemrat dëftorë në fjalitë e mëposhtme.

- S'duhet harruar se në këtë luftë Skënderbeu po përdor një taktikë të re.

- A nuk beson ti se këta topa do ta mposhtin këtë kala? Topa të tillë përdoren për herë të parë në historinë e njerëzimit.

- Ai shi vere nuk ra gjatë.

- Ky qe sulmi i tyre i parë.

- Kjo është toka jonë.

- Ç'arkitekt mund ta kishte projektuar këtë kështjellë?

## Plotëso

5. Në vend të pikave vini përemrin dëftor që është hequr.

- Në ..... mënyrë ruhet jeta e ushtarëve.

- ..... fjalë na rritin krenarinë, moj nënë.

- Kuptohet se ai s'do të kursejë asgjë në ..... punë.

- Ata nisën të diskutonin për ..... gjë.

- Me mjete ..... ne duhet të fitojmë patjetër.

- Armendi i tregoi si mendonte ta fillonte kronikën .....

fushate.

## Plotëso

6. Në vend të pikave vini përemrat pyetës **kush?** ose **cili?** në rasën e duhur.

- ..... do ta blejë këtë kostum?

- Çanta ..... është kjo?

- ..... i bleu nëna fustan të bukur?

- Prej ..... e more letrën?

- Me ..... do të shkosh në teatër?

- ..... po ia blen këtë kukull?

- ..... po pritni para kinemasë?

- Me ..... skuadër luan sot "Vardari"?

- Afër ..... e ke shtëpinë?

- ..... prej jush do të vijë me mua?



## KOHA E PAKRYER

### Ushtrohu

1. Foljet **kam** dhe **jam** vini në kohën e pakryer në vetën e duhur.

Unë dje ..... (jam) në kinema, ndërsa Gimi dhe Beni ..... (jam) në teatër. Në rrugë ..... (kam) shumë njerëz dhe makina. Filmi ..... (jam) i bukur. Në mbrëmje ne ..... (jam) në shtëpinë e Drinit por ai nuk ..... (jam). Aty ..... (jam) vetëm prindërit e tij. Të nesërmen e pyetëm: ku ..... (jam)? Ai tha se ..... (jam) në park me Sokolin.

### Ushtrohu

2. Foljet e dhëna ktheni në kohën e pakryer.

Petriti çdo mëngjes ..... (ngrihem) në orën shtatë, ..... (shkoj) në banjë, ..... (lahem), ..... (rruhem), ..... (fshihem) me peshqir dhe ..... (krihem). Pastaj ..... (kthehem) në dhomën e tij dhe ..... (vishem). Kur ..... (bëhem) gati, ..... (shkoj) në dhomën e ngrënies, ..... (ulem) në tryezë dhe ..... (ha) mëngjes. Kur ..... (bën) të ftohtë ..... (vishem) trashë; në kokë ..... (vë) një kapelë dhe ..... (mbështillem) me shall, pastaj ..... (nisem) për në zyrë. Në punë ..... (shkoj) më këmbë. ..... (Ndalem) në qoshkun e parë dhe ..... (blej) gazetë. Në orën tetë ..... (arrij) në zyrën e tij dhe ..... (filloj) punën.

## Ushtrohu

3. Gjjeni dhe nënvizoni foljet e kohës së pakryer.

Atëherë, kur shkoja unë në shkollë, nuk kishte shkolla tetëvjeçare nëpër fshatra, prandaj çdo ditë udhëtonim nga disa kilometra më këmbë. Shpesh kur binte borë e madhe, nuk mund të shkonim në shkollë derisa shkrihej bora. Mësonim në kushte të vështira. Nuk kishte as libra si sot, por merrnim shënime nga arsimtarët. Posa ktheheshim në shtëpi, i bënim detyrat e pastaj u ndihmonim prindërve. Në mbrëmje mblidheshim përreth gjyshit, e ai fillonte të na tregonte përralla derisa na zinte gjumi.

### KOHA E KRYER E THJESHTË

## Ushtrohu

4. Plotësojeni tekstin me foljet **kam** dhe **jam** në vetën e duhur në aorist.

Unë sot ..... (*kam*) shumë punë. Pasta..... (*jam*) edhe te Sokoli. Unë dhe Benita ..... (*jam*) në fakultet. A ..... (*jam*) ju në teatër? Beni nuk ..... (*jam*) sot në mësim. Ai ..... (*kam*) temperaturë. A ..... (*kam*) ne detyra sot? Ti ..... (*kam*) një çantë në dorë dhe ..... (*jam*) me një fustan të kuq. Ata ..... (*kam*) mësim në orën 8, ndërsa ne ..... (*kam*) në orën 7. Ju ..... (*jam*) në park me disa shokë dhe ..... (*kam*) biçikleta. Nora ..... (*kam*) lule.

## Ushtrohu

5. Shkruani foljet paraprahe në kohën e kryer të thjeshtë.

- Unë *punoj* në kopsht. / Unë ..... në kopsht.
- Ne *mësojmë* shqip. / Ne ..... shqip.
- Ata *lexojnë* bukur anglisht. / Ata ..... bukur anglisht.
- Ti *paguan* 100 denarë. / Ti ..... 100 denarë.
- Ju *dërgoni* letra. / Ju ..... letra.
- Ajo *këndon* mirë. / Ajo ..... mirë.
- Ato *gatuajnë* gjellë. / Ato ..... gjellë.

## GJYMTYRËT KRYESORE TË FJALISË

### Lexojmë

#### ÇDO GJË KA GJUHËN E VET

Agroni dallohej si organizator i shkëlqyer, megjithëse nuk ishte më i madh nga ne. Çdo të shtunë ai organizonte lodra, shëtitje, vizita, gara sportive.

Atë ditë erdhi duke fishkëlyer tërë gaz, duke tundur një tufë kartonësh që mbante në dorë.

U bëmë të gjithë kureshtarë dhe e rrethuam duke u zgjatur për të parë çfarë ishin ato kartonë.

– Dëgjoni! - tha ai. – Kam prurë ca kartonë me figura të ndryshme që paraqesin shpendë, bagëti, insekte etj.

Kushtet e lojës që dua të zhvillojmë janë:

– Merrini këto kartonë dhe poshtë çdo figure shkruani si quhet zëri që lëshon kafsha, shpendi ose sendi. Kush do të përgjigjet më drejt do të fitojë garën.

Të gjithëve u pëlqeu.

Agroni shpërndau kartonët me figura.

Ja përgjigjet e tyre:

- Bilbili ligjëron.
- Delja blegërin.
- Zilja tingëllon.
- Kali hingëllin.
- Macja mjaullin.

- Pula kakaris.
- Miza zhuzhet.
- Ujku ulërin.
- Zogu cicëron.
- Bleta zukat, gumëzhin.

Nga grupi Emirjona pyeti:

- Po njeriu?
- Donika u përgjigj: Flet.
- Skënderi tha: Qesh.
- Pirroja shtoi: Qan.
- Tanushi me zë të lartë tha: bërtet, qorton, këndon.

Agroni mblodhi kartonët dhe i ftoi shokët dhe shoqet të formonin një rreth.

## Plotëso

Plotësoni me + (plus) ose - (minus) tabelën e mëposhtme.

	lopa	zogu	njeriu	treni
flet	-			
blegërin				
mjaullit				
buçet				
pëllet	+			
zhuzhet				
cicëron				

- Kontrollojeni me njëri-tjetrin.
- Cili nga ju e ka plotësuar krejt e pa gabime? Cili më shpejt?

## Detyrë

*Fjalitë:*

- Bilbili ligjëron.
- Delja blegërin.
- Zilja tingëllon.
- Kali hingëllin.
- Macja mjaullin.
- Pula kakaris.
- Miza zhuzhet.
- Ujku ulërin.
- Zogu cicëron.
- Bleta zukat.



*janë nxjerrë nga teksti i mëparshëm. Kryefjalën nënvizojeni me një vijë, ndërsa kallëzuesin me dy vija.*

*Çfarë renditje kanë kryefjala dhe kallëzuesi?*

## Ushtrohu

1. Në fjalitë e poshtëshënuara gjeni kryefjalët. Shkruani ato në vijat boshe. Që të mos gaboni, parashtroni një nga pyetjet **kush? cili? cila? cilët? cilat?**

- Afrimi shkruan. \_\_\_\_\_
- Ai punon çdo ditë. \_\_\_\_\_
- Punëtorët punojnë në fabrikë. \_\_\_\_\_
- Ju laheni në liqen. \_\_\_\_\_
- Babai pasdreke lexon gazetën. \_\_\_\_\_
- Arta e Besa shëtitin nëpër lulishte. \_\_\_\_\_
- Mjalti është i ëmbël. \_\_\_\_\_
- Libri është imi. \_\_\_\_\_
- Molla është e shijshme. \_\_\_\_\_

## Plotëso

2. Plotësoni me kryefjalë fjalitë e mëposhtme.

- ..... këndon bukur.
- ..... është shpend i dobishëm.
- ..... i ndihmon nënës kur ka kohë të lirë.
- ..... dhe ..... mësojnë bashkë.

## Plotëso

3. Plotësoni fjalitë me njërën nga fjalët: shkoj, punoj, lexoj, shikoj, flas, ruaj, vizitoj, mësoj, jetoj, lahem.

1. Adelina ..... një libër.
2. Babai ..... televizor.
3. Valbona ..... mirë shqip.
4. Sokoli ..... në bibliotekë.
5. Ne ..... në Shkup.
6. Në shkollë ..... bashkë me Denisin.
7. Punëtorët ..... në fabrikë.
8. Gjatë verës ..... në det.
9. Frika i ..... vreshtat.
10. Arta ..... shpesh gjyshin dhe gjyshen.

**KUPTIMI I PARË DHE  
KUPTIMI I FIGURSHËM I FJALËVE**

**Të mësuarit kreativ**

1. Me ndihmën e **Fjalorit shpjegues** shkruani shkurtimisht kuptimin e parë dhe kuptimet e tjera të fjalëve *urë, dritë, gjuhë, gjarpër*.

URË

---

---

---

---

---

DRITË

---

---

---

---

---

GJUHË

---

---

---

---

---

GJARPËR

---

---

---

---

## KRAHINORIZMAT

### Detyrë

1. Dalloni dhe nënvizoni krahinorizmat:

Oda ishte tejpertej me njerëz. I shkruajtëm një kartë në kurbet e aj na thotë se është gjallë... Ishim njo dhet çobanë bashkë, i shlojmë berret pa hongër bukë. Kur vjen uku, mue ma varroi një delme, njonit i çarti tremdhet, mue sall një ... Mendova një herë me vete ta hiqja branë nëpër odë, po u mbajta, se do të patakseshin gratë e çiliminjtë. Desha s'desha, hodha gunën në kokë e u kumbisa për çimentoje... Na Markolajt tjetër nafakë nuk kemi ... Shuej, moj, se po kujtojn robt se njimend çika vdiq!...

### Plotëso

2. Zëvendësoni krahinorizmat me fjalë të shqipes standarde:

Krahinorizëm	Fjalë e shqipes standarde	Krahinorizëm	Fjalë e shqipes standarde
xhit		llaf-i	
kaun-i		apet	
karpuz-i		begenajs-i	
llubenajc-a		dost-i	
kundër -ra		asker-i	
netëll -a		haber-i	
masall/-a		gollman-i	
nama, ama		potvërd-a	
ovçar/-i		struj-a	
rab/- a		okolla	
rek-a		ulic/ë, -a	
zhab-a		zgrad/ë, -a	

## NEOLOGJIZMAT

### Ushtrohu

Në çiftet e fjalëve të dhëna, njëra është fjalë shqipe, tjetra është fjalë e huaj. Shumica e këtyre fjalëve shqipe janë edhe neologjizma. Me zëvendësimin e fjalës së huaj me fjalë shqipe pastrohet dhe pasurohet gjuha jonë. Qarkoje (rrethoje) shkronjën para fjalës shqipe.

a) anulohj, anulim  
b) shfuqizohj, shfuqizim

a) ekuilibër  
b) baraspeshë

a) përparohj, përparim  
b) avancoj, avancim

a) barazim  
b) ekuacion

a) biografi  
b) jetëshkrim

a) ballinë, parëse  
b) fasadë

a) barrierë  
b) pengesë

a) hajdut  
b) vjedhës

a) brazdë  
b) hulli

a) jastëk  
b) nënkresë, përkresë

a) përkufizim  
b) definicion

a) vendor  
b) lokal

a) dekadë  
b) dhjetëvjetësh

a) neutral  
b) asnjanes

a) shmang, shmangie  
b) devijohj, devijim

a) statujë  
b) shtatore, trupore

a) drejtpërdrejt  
b) direkt

a) befasi, e papritur  
b) surprizë

### Plotëso

2. Shkruani katër çifte fjalësh si këto më sipër.

1. a) fjalë e huaj: \_\_\_\_\_

b) fjalë shqipe: \_\_\_\_\_

2. a) fjalë e huaj: \_\_\_\_\_

b) fjalë shqipe: \_\_\_\_\_

3. a) fjalë e huaj: \_\_\_\_\_

b) fjalë shqipe: \_\_\_\_\_

4. a) fjalë e huaj: \_\_\_\_\_

b) fjalë shqipe: \_\_\_\_\_



## PËRDORIMI I ZANOREVE /I, Y/

### Plotëso

1. Plotësoni vendet e zbrazëta me shkronjat që mungojnë:

- T\_ do më shumë nënën tënde. Vërtetë u ndave prej saj, po at\_ e ke mendjen, s\_të, zemrën dhe këmbët të çojnë gjithmonë te dhoma e saj.

- Jo, \_u përgjigj djali me zemrën e vrarë. -Ju dua të d\_jave njëlloj e me tepër se veten t\_me...

- Ashtu? T\_ s'më dashke fare. Më shumë do nënën tënde, gjersa na do të d\_jave njëlloj.

Unë kërkoj të më duash vetëm mua dhe asnjë tjetër. Merr vesh apo jo? Nuk dua ta ndash dashur\_në në d\_sh. Dua të të kem vetëm për vete.

- Po për vete më ke natë e ditë. Me ty bie, me t\_ ngrihem. Me t\_ nga mëngjesi në mbrëmje e nga mbrëmja në mëngjes...

- Nuk më mjafton kaq. Dua që ta dëbosh nënën nga shtëpia dhe të mbetemi vetëm ne të d\_. Kështu do të jemi të qetë dhe të lumtur si asnjë ç\_ft tjetër.

- Si ta bëj këtë të pabërë? A dëbohet nëna që më ka bërë?- u ankua djali. - A përzihet nëna nga shtëpia?

- M\_rë, atëherë, më dëbo mua.- iu përgjigj e shoqja. Ose më m\_rë po \_ki vetë. Dhe rrëmbeu këpucët, çantën në duar e iku si furtunë.

Odhise Grillo, "Zemra e nënës" (fragment)

### Detyrë

2. Format e fjalëve të gegërishtes qendrore, shndërroni në forma të shqipes standarde.

<i>forma jonormative</i>	<i>forma normative</i>	<i>forma jonormative</i>	<i>forma normative</i>
ill		frajm	
liej		xhamaj	
tlin		temcëj	
qimir		tajm	
grik		vëjç	
ftajr		krajp	
kraje		po bje shaj	

## PËRDORIMI I DREJTË I TOGJEVE TË ZANOREVE UA, UE, IE, YE

### Plotëso

3. Plotësoni tekstin e mëposhtëm me togjet e zanoreve që mungojnë.

Ism\_\_\_l Kadare është nga personalitetet më të shq\_\_\_ra të letërsisë shqiptare. Me veprën e tij, që ka shën\_\_\_r një numër rekord të përktimeve (në rreth 45 gjuhë të h\_\_\_ja) ai e bëri të pranishme Shqipërinë në botë, me historinë dhe me kulturën e saj shekullore.

Kadareja që në vitet '60 shën\_\_\_ kthesë në letërsinë shqiptare me p\_\_\_zinë dhe prozën e tij. Brenda potenc\_\_\_lit të tij krijues janë mitet dhe legjendat, e shk\_\_\_ra dhe e ardhmja, raportet e përkohshmërisë dhe të përjetësisë, dramat e kal\_\_\_ra dhe ato të tashmet, veset dhe virtytet shqiptare, kullat dhe pallatet moderne, qëndresa dhe humbja, zhdukja dhe ringjallja, të gjitha labirintet e jetës dhe të vdekjes. Duket sikur asgjë çka është shqiptare, nuk mund t'i shpëtojë syrit të shkrimtarit të madh.

### Detyrë

4. Format e gabueshme të fjalëve shkruani ashtu siç duhet.

gabim, keq	mirë, drejt	gabim, keq	mirë, drejt
due		kam shkru	
gru		kam shku	
qill		duhet lexu	
dir		kam zi	
ruj		msuse	
përkthis		thej	
kriesor		i ndëgjushëm	
thies		i kuptushëm	
liej		i arsishëm	

## PËRDORIMI I DREJTË I BASHKËTINGËLLOREVE

/q, ç; gj, xh; r, rr; h, f, nj, v/

### Shkruaj

1. Gjeni dhe shkruani shkronjën që u mungon fjalëve të mëposhtme.

**q**

apo

**ç**

\_\_afë  
\_\_aj  
\_\_en  
\_\_erdhe  
\_\_iell  
\_\_antë  
\_\_ekan  
\_\_ilim  
\_\_erre  
\_\_mim



**gj**

apo

**xh**

\_\_el  
\_\_ep  
\_\_uhë  
\_\_ashtë  
\_\_axha  
\_\_ezve  
\_\_umë  
\_\_eth  
\_\_am  
\_\_ilpërë

### Detyrë

2. Në katror, pas fjalës së shkruar gabimisht vini shenjën **X**, ndërsa pas fjalës së shkruar drejt vini shenjën **✓**.

rëshqas		rresht		ferrë		rotë	
ndërroj		rrepë		rrjetë		burrë	
sharë		mëshqerrë		kokër		regullore	
rrëfim		rotull		rrënjë		reth	
zjar		kurriz		korik		sipërmarje	
rush		rip		kurrë		territor	

## Detyrë

3. Në katror, pas fjalës së shkruar gabimisht vini shenjën **X**, ndërsa pas fjalës së shkruar drejt vini shenjën  $\surd$ .

undë		mësoem		pej		hec	
shah		hajvar		lexovi		hije	
njof		letërnjoftim		nxeh		mëhallë	
laem		pava		nisoj		i shtrejtë	
zojushë		ulkojë		shkronjë		hallvë	
gështenjë		gjahtar		vllavi		krevi	

## Detyrë

4. Fjalët e shkruara sipas shqiptimit dialektor, shkruani në formën letrare.

<i>forma dialektore</i>	<i>forma letrare</i>	<i>forma dialektore</i>	<i>forma letrare</i>
themër		nimoj	
shkam		ner	
mjell		ven	
dham		knoj	
maj		fun	
kumëll		men	
quhën		fjakë	
kang		qak	
mret		bgjetë	
mush		kingj	
nrishe		fjutër	
knej		ppot	

## Plotëso

5. Plotësoni fjalët me një nga tojet e bashkltingëlloreve **mb**, **nd** ose **ng**.

_ _ etem	kë _ _ ë	fu _ _
_ _ arë	kë _ _ ëtar	kri _ _
_ _ arkoj	dhë _ _ ër	dhë _ _
_ _ uloj	dal _ _ adalë	re _ _
_ _ ryshe	ti _ _ ëllon	tru _ _
_ _ a	ku _ _ ull	pëllu _ _
_ _ rëmë	pëllë _ _ ë	hu _ _
_ _ ec	bashkëti _ _ ëllore	ve _ _
_ _ eli	bi _ _ je	lë _ _
_ _ aloj	bre _ _ osem	cu _ _
_ _ utem	bre _ _ a	ahe _ _
_ _ iemër	xhu _ _ ëll	rre _ _
_ _ aloj	ci _ _ ërroj	kë _ _
_ _ anjëherë	gru _ _ ull	plu _ _
_ _ roj	bru _ _ ull	shkë _ _

## Detyrë

6. Lexojeni me vëmendje tekstin e mëposhtëm. Gjeni dhe nënvizoni togjet e bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng, pl, pj, fl*.

### NORA DHE ALFABETI

Të gjithë kishin rënë në gjumë. Vetëm Nora ishte e zgjuar. Ishte kërrusur mbi fletoren e saj, të cilën e kishte vendosur mbi tavolinën e punës dhe mundohej të shkruante sa më bukur detyrën e shtëpisë që ia kishte dhënë mësuesi. Herë-herë grimconte me dhëmbë lapsin që e mbante në dorë. Assesi nuk i vinin fjalët që ajo dëshironte. I ngatërroheshin shkronjat, fjalët dhe fjalitë. I dukej se alfabeti ynë ka shumë shkronja, të cilat i vinte vështirë t'i lidhte në mes veti.

-Të çuditshëm janë këta gjuhëtarët, - mendoi ajo. Kanë futur gjithë këto shkronja në alfabetin tonë. Po të më pyesnin mua, nuk do të fusja 36 shkronja në alfabetin tonë. Mjaft do të ishin 20 shkronja. Ato do t'i mësonim dhe do t'i mbanim mend më lehtë. Pastaj, pak u janë dukur shkronjat me nga një tingull, por kanë futur edhe shkronja me nga dy tinguj – përforcoi mendimin e saj. Dhe, pa vonuar fare, filloi ta thjeshtojë e ta ndërrojë alfabetin. Hoqi të gjitha shkronjat e përbëra (dyshe, dyshkronjëshat). Hoqi edhe shkronjat: p, b, n; të cilat mendoi se mund të zëvendësohen me shkronjat: q, d dhe m.

- Tani do ta kem më lehtë!, - shprehu gëzimin e saj dhe filloi të shkruajë.

Që në fillim hasi në pengesa që assesi t'i kapërcejë. Fjala “peni” i doli “qeni”, fjala “mana”, i doli “nana”, fjala “dora” i doli “bora”, fjala “dhija” i doli “dija”, fjala “llulla” i doli “lula”, fjala “xhami” i doli “xani”, fjala “gjeth” i doli “geth” e shumë fjalë të tjera dolën fare pa kuptim. U mundua, u mundua, por më kot. Assesi ta shkruajë hartimin.

Më në fund u bind se çdo tingull i gjuhës shqipe dhe çdo shkronjë e alfabetit e ka vendin e vet. Të gjithë tingujt dhe të gjitha shkronjat duhet të përdoret drejt.

## Të mësuarit kreativ

Riza Haziri

7. Shkruani në fletore për çka na mëson kjo copë?



## VEÇORITË E POEZISË ARTISTIKE

### Detyrë

1. Lexoni këto vargje të poezisë dhe dalloni veçoritë e tyre.

Eqrem Çabej

Ku ndriçon plisi përthekon guna  
Ku buka është bukë e uji ujë  
Ku digjet qiriu e tymon una  
Rrjedh lumë Drini rrjedh lumë Buna  
Hesht Iliri flet vetë Albani  
Në valle Lisi ku feston fisi  
Merr në thua e bie tirani  
Në male të bardha bardhon plisi  
Në natën e zezë del para Abeja  
Ti thur ballin me kujtime e gjak  
Midis krahërorit të shkrep rrufeja  
Klithjen e moçme e zgjon në prak...

(Sabri Hamiti, Leja e njoftimit 1985)

\*\*\*

Hanko Halla

(fragment)

Halla do një nuse si edhe i biri  
rrënjët prej ergjëndi, degat prej floriri,  
me të folur halla, nusja të hap' sytë  
“Lepe” fjala e parë, “peqe” fjala e dytë;  
edhe asgjë tjetër, vetëm “lepe”, “peqe”,  
pasi zemra e Hallës qënka si një qelqe:  
po u thye, vajti, e s'ka më: ngjite, qepe,  
zogu i plagosur di të kap' me sqepe! ... (Ali Asllani)

\*\*\*

Recital' i malsorit

O, si nuk kam një grusht të fortë  
t'i bij' mu në zemër malit që s'bëzanë,  
ta dij' dhe ai se ç'do me thanë i dobët –  
n'agoni të përdihet si vigan i vramë. (Migjeni)



## Detyrë

2. Lexoni vargjet e mëposhtme. Cila është poezi popullore e cila është poezi artistike.

Qajnë! Po kush nuk qa?  
Qajnë burra, qajnë gra,  
Qajnë maletë për pyle,  
Qajnë fushatë për lule!

Kjo është poezi \_\_\_\_\_

\*\*\*

A je brymë, moj, a je borë?  
Moj e holla!  
E bukura vetull kunorë  
Moj e holla!  
E bukura kuq në faqe  
Moj e holla!  
Si hana qi shkrep në bahçe  
Moj e holla!

Kjo është poezi \_\_\_\_\_

\*\*\*

Sa e dua gjithë jetën!  
Se atje gjenj të vërtetën,  
Yjtë, hënën, hapësirën,  
Të mugëtit, natën, ditën  
Mëngjezë, djellinë, dritën  
Mbrëmën, dh'atë errësirën.

Kjo është poezi \_\_\_\_\_

\*\*\*

I ra qiellit e ndriti,  
I ra zemrësë, e nxehu,  
I ra verës, e buçiti  
I ra shpirtit dhe e dehu.

Kjo është poezi \_\_\_\_\_

## Detyrë

3. Lexoni vargjet e mëposhtme dhe gjeni cilit lloj të poezisë artistike u takojnë.

a) Mjerimi asht një njollë e pashlyeme  
në ballë të njerzimit që kalon nëpër shekuj.  
Dhe këtë njollë kurr nuk asht e mundshme  
ta shlyejnë paçavrat që zunë myk ndër tempuj.

Kjo është poezi \_\_\_\_\_

b) Një sorrë në plep  
Në tokë shumë fletë.  
Bujku në arë  
Në tokë shumë farë.  
Në qiell retë zi  
Në tokë shumë shi.  
Tash më shumë  
Ka ujë në lumë.

Kjo është poezi \_\_\_\_\_

c) Oh, i verbër jam  
dhe e di  
se kjo lloj verbërie  
është palcë e dashurisë!

Kjo është poezi \_\_\_\_\_

ç) Prej lufte veç ai largohet  
Që është lindur tradhëtor  
Kush është burrë nuk frikësohet  
Po vdes, po vdes si një dëshmor.

Kjo është poezi \_\_\_\_\_

## ELEMENTET PAMORE DHE DËGJIMORE TË POEZISË

### MANUSHAQES

#### Detyrë

*Lexojeni me zë këtë vjershë.  
Mësojeni përmendsh dhe recitoheni.*

Manushaqe e vogël  
Lulëzon në ferra,  
Lajmëron gjithë botën  
Se erdhi pranvera.

Manushaqe e vogël  
Unë të dua shumë;  
Mos e ul ti kokën.  
Mos u tremb nga unë.

Manushaqe e bukur  
Mos u dridh në ferrë:  
S'vij për të këputur,  
Vij të të marr erë.

*Adelina Mamaqi*



#### Të analizojmë poezinë

- Si është shkruar kjo poezi: në rreshta apo në vargje?
- Sa strofa ka kjo vjershë?
- Nga sa vargje kanë strofat?
- Nga sa rrokje kanë vargjet?
- Me cilat rrokje mbaron vargu i parë dhe i tretë, e me cilat vargu i dytë dhe i katërt?
- Si e quajmë këtë përputhje rrokjesh të vargut?

## Të shprehurit krijues

- Për kë bëhet fjalë në këtë vjershë?
- Ç'është manushaqja?
- Ku rritet ajo?
- Në cilën stinë lulëzon manushaqja?
- Pse manushaqen e quajmë lajmëtare e pranverës?

## Po ti?

- A i do ti lulet?
- Pse i duam lulet?
- A tremben lulet nga njerëzit?
- A duhet t'i këputim lulet?
- Pse bleta i do shumë lulet?
- Shkruani një vjershë ose tregim për lulet.
- Vizato një lule dhe ngjyrose.

## FIGURAT STILISTIKE

### Pyetje dhe detyra

1. Gjeni epitetet në vargjet e mëposhtme:

*I nap ballë perishan,  
I nap vetllën si gajtan,  
I nap synin si filxhan,  
I nap hundën miskali.  
I nap faqen gurabi,  
I nap gojën si kuti,  
Dhambë e dhëmballë porsi inxhi! ... Këngë popullore*

2. Kur duam të vëmë në dukje virtytet ose veset e ndonjë njeriu shpesh themi se është: *dhëlpër, ujk, luan, sokol, lepur, breshkë, qengj, gjarpër* etj., si Bardhyli është dhëlpër. Çka tregojnë metaforat e mësipërme?

### Ushtrohu

3. Çfarë figure stilistike kemi në shprehjet: *këmishë e bardhë si bora, rrush i ëmbël si mjalti, shegë e kuqe si gjaku, ka flokë të zinj si pendla e korbit.*

4. Çfarë figure stilistike kemi në katër vargjet e dhëna.

*Ma ka synin si filxhan  
Ma ka ballin pirishan  
Ma ka shtatin si selvi  
M'i ka dhambët si inxhi ... \_\_\_\_\_*

5. Në vargjet e dhëna të kësaj kënge popullore gjeni dhe nënvizoni figurën e krahasimit:

*Gja ma të mirë s'shef njeri nën kët diell!  
Vetulla e saj ndrejt si fiskaja;  
Shteku i ballit, si shteku i malit,*

*Kur merr hana me pranue;  
Syni i saj, si kokrra e qershis;  
E ka qerpikun, si krahu i dallndyshes;  
Ftyra e saj, si kuqet molla n'degë;  
Hunda ndrejt, si kalemi i Tushës;  
Goja e vogël, si lula që shpërthen;  
Dhambët e bardhë, si gurzit e lumit ...*

(Këngë popullore)

### **Pyetje dhe detyra**

6. Në tekstin e dhënë gjeni dhe nënvizoni antitezat:

U ngrit në këmbë i madh e i vogël, i ri e plak, të gjithë rrokën armët me parullën “Ja të rrojmë të lirë, ja të vdesim, o sot o kurrë”. Ai është aktor i madh i roleve të vogla. Industria e madhe e prodhimeve të vogla shtëpiake.

7. Në vargun më poshtë gjeni dhe nënvizoni antitezën:

*Ku e lam e ku na mbeti  
Vaj-vatani e mjer-mileti  
Anës detit i palarë,  
Anës dritës i paparë,  
Pranë sofrës i pangrënë,  
Pranë dijes i panxënë,  
Lakuriq dhe i brengosur,  
Trup e shpirt i sakatosur?*

(F. Noli, Anës lumenjve)

## Të analizojmë poezinë

8. Lexojeni këtë poezi të bukur të Lasgush Poradecit. Gjeni figurat stilistike në këtë poezi. Nënvizoni ato.

### Maja e Çelur

Lulet lulëzuan  
me të parë djellë  
kushedi ç'duruan  
që kur janë mbjellë:

që kur u përzien  
me rër' e me ujë,  
dhe u lagn' e u lyen  
pa bujë e rrëmujë.

Pa zë psherëtimi,  
zë e vaj të kotë,  
i ngurroj thellimi  
nënë dhen' e ftohtë.

Edhe balt' e ndotur,  
edhe llum' i ndyrë  
i patnë përлотur  
me ngjyrë e mënxyrë.

Ato piperonin  
me një sulm i qetë  
dhe mbinin e shkonin  
që përposh përpjetë.

Që ngaj errësira  
brenda në dhë thellë  
ndillnin krejt të lira  
dritën edhe qelltë.

Sa me rënd' i mbante  
rrënj' e balt' e nxirë  
dh' i tërhiqte e s'i ndante  
për në fundësirë,

dhe sa m'i padukur  
edhe sa m'i zjarrtë  
ishte sulm' i bukur  
për në qiejt' e lartë,

aq më lirë e fshehur,  
dh' aq më me ngadalë  
rritnin pa pandehur  
sulmin e pandalë:

Dhe ja, ndizet era  
mbi barishte e bimë!  
Ja! qesh pranëvera  
nëpër ngashërime!

Ja! sa lul' e qetë  
çeli gjinë e sajë,  
përmbi degë e fletë  
atje lart në majë!

*Lasgush Poradeci*

## Punë kreative

9. Shkruani një vjershë në një temë që do ta zgjidhni vetë. P.sh.:  
*Shkolla ime. Mësuesja ime. Nëna. Vendlindja. Pranvera. Dimri. Libri.*  
Përpiquni të përdorni sa më shumë figura stilistike që i keni mësuar më parë ose tani.

Ja se si e shkruan një poezi një grup nxënësish të zellshëm të klasës së gjashtë.

### ALFABETI I GJUHËS SHQIPE

Arta tha: ta shkruajmë një poezi  
Beni tha: edhe unë jam dakord  
Cili s`do të pajtohej foli një syzi  
Çka po presim t`ia nisim që sot.

Dardani tha: jemi tridhjetë e gjashtë  
Dhe aq shkronja ka alfabeti  
Ermela një vogëlushe flokëgjatë  
është mirë tha vjersha të jetë sa deti.

Flora tha: unë lulet shumë i dua  
Genti tha: nga gjumi libri m`ndan  
Gjithkush veten e tregon me punë  
Hana foli kryefjalën ia dhanë.

Iliri tha: këngën shumë e dua  
Jeta tha: më pëlqen aktrimi  
Kushtrimit shtatgjatë e faqeftua  
Loja e basketbollit dhe vizatimi.

Llokume, ëmbëlsira më bën mamaja  
Mësuesen do ta thërrasim patjetër



Nadia: tha n`ditëlindje më vjen daja  
Një ditë më ka lajmëruar me letër.

Ora kalonte, vargjet shtoheshin  
Porsi shtëpia e re gurë mbi gurë  
Qëndresa tha që të mendoheshin  
Radhën t`ia lënë zotëriut Flamur.

Rrumbullakohet ngadalë poezia  
Secili diçka të re propozoi  
Shumëkush i tha mendimet e tija  
Teuta e vogël shokët i dëgjoi.

Tha Mirjeta vjersha u bë si tren  
Unë jam në të tetin t`parafundit  
Vagoni i fundit pastaj vjen  
Xërxa nuk është stacion i fundit.

Khyla doli para shokëve të vet  
Ylberin vizatoi me lloj-lloj ngjyrash  
Zell kush ka, në të gjitha lëndët  
Zhvillon lehtë çfarëdo detyrash.

## FABULA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT

### BUKURIA QË VRET

Hana e zbetë, si fytyra e një të vdekuri, kundron nga kupa e qiellës. Kundron botën e maleve të kristalizueme nga bora. Kundron kasollet e kristalizueme të katundit, të cilat as fymë nuk marrin. Të gjitha janë mbështjellë në bardhësinë e borës. Dhe të vret kjo bukuri e bardhë. Vret shpirtin e malsorit siç vret shpirtin e artistit shtatorja e bardhë e ftoftë e një gruaje lakuriqe. E në kasollë, e cila gjëmon nën barren e borës, derdhen dy ngjyra, kuq e zi. I kuq zjarrmi i votrës në fund të kasollës, e zi rrethi. Të zeza, t'errta janë skutat e kasollës, nga dëgjohehet blerimë e mekun e ndoj delje ose kumona e lopës. Edhe ata i vret bukuria e bardhë. Nga goja u del avulli i afshavet që ngrihen n'ajr, bie mbi qimet e tyne si brymë dhe kristalizohet. Heshtje. Gjithçkafja e kristalizume.

- Një dorë shtrihet, zen një dru, e shpupurish zjarrmin. Ropos një botë gacash. Flaka lëpin errësirën e njerëzve që dridhen, nëpër kuriz u përshkohet të ftohtit që vjen nga skutat, andej nga errësina. Brr... uf... andej mbrapa shpinet përpijnë errësina me të ftohtit e saj.

- Po shiko mos ngrini Laroja?

Dhe çohen, i lëshojnë vend rreth zjarrmit Larojës, lopës së shtëpisë. Të nxehet dhe ky pjestar familjeje në kasollën e kristalizueme.

- E Laroja din si duhet m'u shtrimë rreth zjarrmit. Por, me trupin e saj të madh, gati shtypi dy vocrrakë, të cilët i kish zanë gjumi pranë zjarrmit.

E kur andej nga mesnata acarimi arrin dhe kulmin e vet, atëherë ndër bagëtis fillon një lëvizje. Po, një lëvizje. Një nga një u aviten njerëzve e me sytë e vet si me u lutë: "Na lëshoni edhe neve të ngrohemi pak rreth zjarrmit se u ngrimë. Dhe njerëzit kundrejt njerëzve s'kanë mëshirë, po kundrejt shtazëve po. Prandej çohen, ua lëshojnë bagëtisë vendin rreth votrës, e ata vetë shkojnë n'erësinën që përpin.

... Dhe agimi zbardh me bukurinë e bardhë që vret. Çohen njerëzit me trupa të mpirë dhe me kujtim në ndërgegje se u kalua edhe një natë e vështirë. U çuan, por nuk çohet një vocrrak. Dora e s'amës shtrihet mbi te dhe m'at çast një britmë e tmershme çpoi zemrat e kasollës. Dhimba e një nane i shkrin zemrat në vaj, por ç'e do kur nuk shkrin zemrën e ngrime të vocrrakut.

Po, ishte ngrimë lokja e nanës. Gjaku i tij i kuq e i purpurt ish ngri ndër dej dhe në zemër, ish bamë kristal, që të bahet një servis për milionarin, jo, gjaku ish ba rubis, për gjerdhanet e metresave. E trupi i vocrrakut, i lokes së nanës, ishte bamë një shtatore e ngurtë e zhgulun nga gjiri i nanës.

- Merrnje dhe çonje në qytet këtë shtatore. Vendosije në një

shesh! Dhe si permendore kushtonja ndokujt! Kushtonja atij që ka më shumë merita për këtë vend! Po, ndoj ministrin o deputetin o ndokujt tjetër... E në rasë se nuk gjeni ndonjë njeri që ka merita të mjaftueshme, atëherë kushtonja atij që ka merita ma pak, perendisë klasike.

*Millesh Gjergj Nikolla - Migjeni*

## FJALOR

**kundroj** - vërej dikë a diçka me kujdes, e shoh mirë dhe me vëmendje nga të gjitha anët

**shtatore** - statujë trupore, përmendore

**mek** - dobësoj, e mpak, e shuaj për zërin

**rropat** - përplas këmbët duke ecur dhe bërë zhurmë

**rubin** - gur i çmuar, shumë i fortë e me ngjyrë të kuqe

## INTERPRETIM

- ▶ Për cilën kohë bën fjalë shkrimtari në këtë tregim?
- ▶ Si e përshkruan shkrimtari dhembjen e nënës për vocërrakun?
- ▶ Shkruaj në fletore përmbajtjen e këtij tregimi.



## VEÇORITË E TREGIMIT

### Lexojmë

*Lexojeni me vëmendje këtë tekst.*

### TË JEMI TOLERANTË

Konfliktet kanë shoqëruar njerëzimin gjatë gjithë historisë së tij. Shpesh ata janë bërë shkak i grindjeve të ashpra. Mjafton të kujtojmë dy luftërat e mëdha botërore që i sollën botës dëme, apo edhe konfliktet e brendshme nacionale të pranishme në një shoqëri multietnike.

Aty ku konfliktet janë zgjidhur me tolerancë, përmes dialogut të hapur, shoqëria ka ecur përpara. Kurse jotoleranca është një ngërç i madh që zë në fyt zakonisht komunitetet e paemancipuara njerëzore. Kështu, në jetën e përditshme shpesh njerëzit ndodhen përballë konflikteve e keqkuptimeve të ndryshme. P.sh. Albani mendon se mësuesi nuk e ka vlerësuar drejt detyrën e tij në anglisht. Andi do të mbajë në shtëpi një qenush, por prindërit nuk e lejojnë. Dorina kërkon të shkojë në disko, por nëna nuk është e një mendjeje me të. Klajdi i vogël kërkon të shikojë filmat vizatimorë, por Inës, motrës së tij të madhe, i pëlqejnë telenovelat. E kështu mund të vazhdonim me dhjetëra e dhjetëra konflikte të tjera.

Mënjanimi i konflikteve bëhet vetëm me tolerancë, duke shpjeguar së pari shkaqet e vërteta të tyre.

### Pyetje dhe detyra

1. Ç'është toleranca sipas mendimit tuaj? Po e kundërta e saj, ç'është?
2. Ç'janë konfliktet e si mund të zgjidhen ato?
3. Si quhen ata njerëz që grinden?
4. Diskutoni rreth konflikteve a grindjeve të ndryshme në jetën shkollore. Flitni si i keni zgjidhur ato.
5. Zhvilloni një bisedë rreth konflikteve multietnike dhe përpuni të jepni mendime se si mund të zgjidhen ato.
6. Shkruani një bisedë që të paraqesë një konflikt ndërmjet dy njerëzve.

## NOVELA

### Lexojmë

#### LULI I VOCËRR

Asnjë s'e njeh Lulin. As shokët e tij që përpara tij luajnë, nuk e njohin. Më mirë të thuash se e njohin, por ata luajnë për hesap të vet dhe Luli i shikon pa u përzier me ta. Sot kushdo ka punët dhe kujdesjet e veta, ashtu edhe fëmijët, ashtu edhe Luli.

- More Luli! Shumë herët ke filluar të shikosh punën tënde!


Kur Luli hyn në oborr të shkollës, buza i qesh pak, por askujt asnjë fjalë s'i thotë. Ecën ngadalë duke shikuar djathtas e majtas, por gjithnjë duke ecur, derisa të arrijë në cakun e vet. Aty te dera e rrugicës së shkollës shumë i pëlqen të qëndrojë. Aty është caku i tij, i praruar me rrezet e ngrohta të diellit në këto ditët e vjeshtës. Mbështetet Luli në mur, grushtet e vogla i vë në xhepa, hundën e pjerrët të skuqur nga të ftohtët e mëngjesit ia kthen diellit dhe ... shikon. Gjëja që më tepër ia tërheq vëmendjen, janë çizmet që kanë mbathur disa shokë të tij. "Sa të bukura janë! Si shkëlqejnë! - mendon Luli dhe, pa dashje, sytë i shkojnë te tollumbat e vet, nëpër të cilat shihen fare mirë të pesë gishtat e këmbëve të zbathura. Nga kureshtja i afrohet një shoku që ka çizmet më të reja. Ulet dhe sheh në lustrën e çizmes këmbët e veta të zbathura. Aq shumë shkëlqejnë çizmet!!! Pasi shoku me çizme fluturon, Luli, ngadalë, shkon te caku i tij, në diell, të ngrohë këmbët. Po kur nuk ka diell, si ia bën i shkreti Lul?!

Nganjëherë, Lulit i afrohet mësuesi. Dhe, kur e ka fytyrën të pastër dhe pa puçrra, mësuesi ia ledhaton faqet, gushën; e Luli i afrohet, ia merr dorën, e shikon me sy pëllumbi dhe do të kishte dashur t'i falte diçka mësuesit. Po vjollca nuk ka. E Luli i vocërr çfarë mund t'i falë mësuesit tjetër? Veç t'i falë tollumbat e vet, që kanë hapur gojën, sikur duan ta hanë mësuesin! Po, po, tollumbat e Lulit të vocërr kanë për ta ngrënë mësuesin!

*Sipas Migjenit*

## Detyrë

- Bëni përshkrimin fizik dhe shpirtëror të Lulit të vocërr.
- Portretizojeni atë sipas kërkesës së mëposhtme:

Portretizimi i jashtëm	Portretizimi i brendshëm
	

## NARRATORI (RRËFYESI)

### Lexojmë

### ARBËRESHI I VOGËL

Ditën kur Gjergji shkoi për herë të parë në shkollë, nuk ndjehu asnjë gëzim. Mësuesi foli e foli dhe djali pothuajse s'mori vesh gjë. Ai fliste në një gjuhë që Gjergji nuk e kuptonte.

Gjergji rrinte në bankë, me kokën e mbështetur në të dy duart dhe s'dinte ç'të bënte. Shikonte muret, vërente dritaret, ndiqte lëvizjet e mësuesit. Ora nuk ecte dhe ai ndiente sikur dikush e mbante me zor në klasë.

Mezi priti sa të mbaronte mësimi i ditës së parë. Doli nga shkolla dhe, i mërzitur, u kthye në shtëpi. Te porta e vjetër me hark, takoi gjyshin. Gjyshi i përkëdheli kokën dhe e pyeti:

- Hë, Gjergj, si shkove sot në shkollë?

Djali u vrenjt në fytyrë dhe uli sytë. Iu lidh gjuha.

- Fol, more trim, ç'më rri kështu? - ngriti zërin gjyshi - Mos të ka rrahur njeri?

- Jo, - u përgjigj djali dhe me sy të përlotur mbështeti kokën pas trupit të gjyshit.

Plaku e vështroi nipin e dëshpëruar dhe i erdhi keq.

- Gjysh, jo, nuk shkoj më në shkollë. Mësuesi flet vetëm italisht e unë s'kuptoj gjë. Pse, nuk ka shkollë arbërisht?

Gjyshi u mundua të buzëqeshte.

- Dalëngadalë do ta kuptosh çfarë thotë mësuesi. Mos u mërzit, - i tha të nipit - Po më thuaj çfarë mësove sot?

- Thash që unë nuk kuptova asgjë, o gjysh - i tha Gjergji me sy të përlotur - Pse nuk flasim në shkollë siç flasim në shtëpi, siç flet mami, babi, ti gjysh, nëna dhe xhaxhai?

- Ke të drejtë Gjergj, në shkollë këtu flasim gjuhën e tyre, dhe jo gjuhën tonë. Gjuha jonë është gjuha shqipe.

- Po pse ne flasim ndryshe nga italianët? - pyeti Gjergji.

- Po ata janë në vendin e tyre o Gjergj, ne jemi të ardhur këtu - ia

priti gjyshi.

- Nuk të kuptoj, gjysh - tha Gjergji duke e vështruar në sy.

Gjyshi e mori djalin përdore, dhe bashkë filluan të ecnin në një rrugice të ngushtë, e më pas, drejt një kodre të lartë. Atje lart ishte një lis i gjatë degëshumë. Kur arritën atje, gjyshi tha:

- Këtu do rrimë dhe do bisedojmë pak. Si thua?

- Mirë. - tha djali.

Pasi plaku erdhi rreth e rrotull lisit, e pyeti djalin:

- A ngjitesh dot në majë të lisit, Gjergj?

- Ngjitem, si nuk ngjitem! - tha djali i gëzuar.

Gjyshi nxori nga xhepi një shami të kuqe, dhe i tha djalit ta lidhte këtë shami në majën e këtij lisi të gjatë. Djali u nis gjithë gëzim. Pasi Gjergji arriti majën e lisit, gjyshi i tha ta nxirrte shaminë dhe ta lidhte fort. Gjyshi pyeti:

- Ç'po bën shamia?

- Asgjë, gjysh.

- A po e valëvit era?

- Po, gjysh.

- Nga po valëvit, nga lindja apo nga përendimi?

- Nuk e di, gjysh.

Gjyshi priti dhe pastaj tha:

- Nga deti, apo nga toka?

- Nga deti, nga deti...

- Shumë mirë, shiko mirë andej nga deti, dhe zbrit pastaj, mirë?

Gjergji po shikonte, por nuk po kuptonte asgjë. Pasi pa nga deti, ai zbriti poshtë lisit. Kur u afrua afër gjyshit, gjyshi i tha:

- Dëgjo të thotë një fjalë gjyshi sot, që të mbash mend deri sa të rrosh. Andej nga deti, ku valëviste shamia e kuqe, është Arbëria. Atje është dheu ynë. Këtu, në Itali, në jemi në vënd të huaj. Para shumë vitesh, gjyshi i gjyshit tim luftoi me Skëndërbeun, kundra turqve. Kur mbaroi lufta, familja e tij erdhi këtu.

Kur erdhën, ata ndërtuan vendin e tyre. Ne këndojmë dhe qajmë arbërisht, atë kemi folur të gjithë, prandaj ti nuk kuptove gjë në shkollë sot. Do të kuptosh më vonë, se këtu do të jetosh. Por, mbaje mend "Ta kesh për nder që je arbëresh dhe këtë emër ta mbash lart". A ma jep fjalën?

- Po, gjysh, ta jap - tha Gjergji i mallëngjyer.



Dhe pastaj ai ngriti zërin dhe tha:

- Për gjakun e arbërit, do të rroj dhe do të vdes arbëresh...

Gjyshi e puthi në ballë, fshiu sytë, dhe i tha të shkonin në shtëpi tani. Djali shikoi edhe njëherë shaminë e kuqe dhe tha:

- Shamia valëvitet nga Arbëria, që është në anën tjetër të detit, apo jo?

- Po, Gjergj, - tha gjyshi.

## Detyrë

Nga copa e dhënë dalloni dhe shkruani në vijat e mëposhtme disa pjesë të:

a) Rrëfimit të autorit (narratorit)

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

b) Rrëfimit të personazheve (gjyshit dhe nipit)

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

## DRAMA DHE LLOJET E DRAMËS

### Lexojmë

Lexojeni pjesën në vijim. Ky është një fragment nga tragjedia "Romeo e Zhulieta" e Shekspirit.

#### SKENA III

*Qeli e Fratit Laurens. Hyn FRATI LAURENS me një shportë.*

#### FRATI LAURENS:

Pas natës së vrenjtur, qesh mëngjes' i zbehtë.  
Kur drita larushon nga lindja retë;  
Dhe cip' e zezë zbardhet bëhet ditë  
Nga zjarri i Titanit që sjell dritë.  
Pa dalë dielli erën të përçajë,  
Të zgjojë ditën, vesën të na thajë,  
Barishte do të mbledh me helm të fortë,  
Dhe lule për ilaç në këtë shportë.  
Ky dhé, q'është' nënë, është' dhe varri ynë  
Pra gropë varri qënka mitra jonë,  
Kjo mitër, lloj-lloj hijesh na ka dhënë  
Që thithin gjin' e tokës për të ngrënë.  
Disa fëmijë plot virtyte kanë  
Asnjë nuk është bosh, po njësh nuk janë.  
Oh! Fuqplotë është' hiri që qëndron,  
Përmbi çdo bim' e gur që na rrethon,  
Se s'ka asgjë të ligë a të kotë,  
Që s'bën asnjë shërbim në këtë botë,  
Po dhe një gjë e mirë na bën keq  
Kur shtrëmbër e përdorim dhe për dreq.  
Virtyti, kur e nxin, në ves ndërron  
Dhe vesin pun' e mir' e zbukuron.  
Kështu edhe kjo lule e uruar  
Nën luspë ka një helm për të shëruar.  
Në qoftë se i merr erë ta ka ënda  
Po n'e shijofsh me ndjenjat humb dhe mëndja.  
Dhe tek njeriu luftojnë dy fuqira  
Dy mbretër hasmë: E liga dhe e mira.  
Dhe kur ai m'i ligu na fiton,  
Sakaq bimën sëmundja e shkurton.

*(Hyn ROMEO).*

ROMEO: Mirëmëngjesi, uratë!

FRATI LAURENS: Paç uratën!

Ky zë i ëmbël ç'është që me natë?  
O bir që kaq shpejt më ke munguar  
Do kesh një hall të madh të paduruar.  
Meraku vjen kur plaket ca njeriu,  
Kur vjen ai dhe gjumi shkon vetiu;  
Po trurin e shkujdesur të rinisë,  
E ruan gjum' i art' i qetësisë.  
Prandaj, mëngim' i yt më siguron  
Se një merak i madh të çqetëson.  
Ose, t'i shtie shenjës ca më mirë,  
Në shtrat ti sonte fare nuk je shtrirë.

ROMEO: Tamam, po sonte isha m'i qetuar.

FRATI LAURENS: O Zot! Tek Rozalina paske shkuar?

ROMEO: Oh jo, imzot atë e kam harruar

Dhe dhëmbja që më sillte m'është shuar.

FRATI LAURENS: Pra thuaj ku e shkove këtë natë?

ROMEO: Ja ku ta them pa pyetur më gjatë.

Tek hasmi isha mbrëmë në gosti  
Kur rashë në një tjetër dashuri.  
Si unë u plagos edhe ajo  
Prandaj si shenjt, na ndih e na shëro.  
Për' të, uratë, s'kam ndonjë mëri  
Dhe lutjen për të dy e bëj tani.

FRATI LAURENS: Shpjegom biro punën pa e zgjatur.

Se ndjesë s'merr përveç nunosj' e hapur.

ROMEO: Ta them pra hapur, zemrën me të parë

E bij e Kapuletit ma ka marrë.  
Si zemr' e saj dhe e imja u bashkuan.  
Të gjitha, veç kurorës, u mbaruan.  
Tani ta them më mirë, duke shkuar  
Se ku dhe kur dhe qysh jemi takuar  
Dhe si këmbuem fjalë zumë dorë;  
Po vetëm, zot, që sot na ver' kurorë.

## Detyrë

1. A keni dëgjuar apo lexuar më parë për Romeon dhe Zhulietën?
2. Kush janë ata?
3. Çka simbolizojnë këto dy personazhe?
4. Si përfundon kjo tragjedi?
5. Çfarë përfundimi do t'i kishe dhënë ti?
6. Përcaktojeni cila pjesë është dialog e cila monolog.

## BISEDA DHE DISKUTIMI

### Pyetje dhe detyra

1. Ç'është biseda?
2. Ç'është diskutimi?
3. Si duhet t'i argumentojmë mendimet tona në një diskutim?
4. Thoni disa nga rregullat kryesore të diskutimit?
5. Ç'detyra ka drejtuesi i diskutimit?
6. Zgjidhni tri nga cilësitë e mëposhtme që i quani më të rëndësishme për drejtuesin e diskutimit. Argumentoni mendimin tuaj.

- të jetë i mençur
- të jetë i bukur
- të dijë të dëgjojë të tjerët
- të dijë të ndërhyjë
- të ketë para
- të jetë i butë
- të dijë të vishet
- të dijë të merret vesh me të tjerët
- të dijë të hajë
- të dijë të organizojë punën.

7. Zhvilloni një diskutim për njëren nga temat e mëposhtme:

- a) një film i shikuar.
- b) një ndeshje sportive.
- c) sjellja e nxënësve të shkollës sonë.
- ç) suksesi i përgjithshëm në klasë.
- d) pastërtia e nxënësve dhe e shkollës.

8. Lexoni tregimet e mëposhtme dhe diskutoni rreth tyre.

### **TË VLERËSOJMË TOLERANCËN**

- Mirëmëngjesi, Ilir! Përse u vonove? - e pyeti mësuesi.
- Isha me nënën në spital, te babai; është plagosur në kokë.
- Po si ndodhi? - pyeti me keqardhje mësuesi.

- Na thanë se një djalë deshi të kalonte me vrap para makinës, ndërsa babai po e ngiste me shpejtësi, sepse po çonte një grua në spital. Djali dhe gruaja shpëtuan, vetëm babai u plagos në kokë. Sot do ta operojnë.

- Po, kush qe ai djalë?
- Nuk dimë, se iku me vrap.
- Për fat të keq, të tillë ka, edhe jo pak, - tha mësuesi me inat.
- Ti Ilir, kur të duash, shko tek babai, ke leje nga unë.
- Faleminderit! - tha Iliri.

Unë isha zbehur. Ballin e mbështeta mbi dorë dhe bëja sikur shikoja fletoren e detyrave. Zemra më rrihte me forcë dhe nuk kisha guxim as të ktheja kokën nga banka e Ilirit". Po sikur babai i Ilirit të vdesë"?!

Mami m'i dha paratë, megjithëse më kish hequr veshët një natë më parë për pantallonat dhe u nisa për të dalë. Të dera ndenja një çast dhe u ktheva:

- Mami!
- Urdhëro, more bir, ç'ke, s'të dalin paratë?
- Më dalin, më dalin, po e di pse i dua?
- Ti më the se do të blesh diçka. Ti nuk shpenzon kot.
- Do të blej fruta dhe do të shkoj në spital te babai i një shokut

tim, Ilirit.

- Po, nga se vuan babai i shokut tënd?
- Nga unë! - i thashë me gjysmë zëri.
- Ti!? Pse?

Mbështeta fytyrën në prehrin e saj dhe, duke qarë, i tregova gjithçka. Kur mbarova, ajo nuk foli, por u ngrit, u vesh dhe dolëm bashkë.

Në një krevat pranë dritares, te pavijoni i dytë, pamë Ilirin që po rrinte pranë të atit kokëlidhur. Kur na pa në derë, i ati i tha Ilirit gjithë gëzim.

- Shiko, shiko, më duket se ky është Loni, paska ardhur të më vizitojë!

Me të dëgjuar këto fjalë, unë shtanga në vend. Rrushi sa s'më ra nga duart. S'dija çfarë të bëja. Lashë rrushin në komodinë dhe iu hodha të sëmurit në krahë.

- Më fal, xha Petro, më fal! Unë isha ai djali që deshi të kalonte makinën. Nga unë e pësove ti.

Ai më përqafoi.

Mami filloi ta pyeste për shëndetin, ndërsa unë dhe Iliri dëgjonim dhe herë-herë shihnim njëri-tjetrin në sy. Me vështrimin e vet të çiltër, Iliri më fali për atë që kisha bërë.

### **Pyetje dhe detyra**

1. Diskutoni për veprimin e Ilirit.
2. Si do të kishe vepruar ti sikur të ishe në vend të tij?
3. Si e vlerësoni veprimin e xha Petros dhe të Lonit?
4. Vlerësoni me nota (prej 1 deri në 5), personazhet e tregimit të mësipërm në bazë të sjelljeve të tyre.

## BARASPESHA (RESTITUCIONI)

### EDUKATA

Edukata është fjalë abstrakte, por në fakt shumë e dukshme.

Çdo punë që bëni fëmijë, tregoni sa edukatë keni.

Fjalët: Urdhëro!, Më fal!, Faleminderit!, Të lutem! janë pikënisja. Nëse ju fëmijë i përdorni këto fjalë, atëherë dëshmoni se jeni të edukuar.

T'i përshëndesësh njerëzit, të mos hedhësh mbeturina, të sillesh mirë me të gjithë, të mos gënjesht, të mos vjedhësh, të mos përdorësh fjalë të ndyta etj. është edukatë e vërtetë.

Mos i thuaj dikujt atë që nuk do të kishe dashur të ta thotë ty dikush.

### Detyrë

1. Dikush të ka ndihmuar për diçka. Si do ta falënderosh e si do ta urosh atë, kur është:

Bashkëmoshatari juaj.

---

---

Shoku juaj i shkollës ose i klasës.

---

---

Një i panjohur.

---

---

Një kalimtar i rastit.

---

---

Një i moshuar.

---

---

## Detyrë

2. Kur i themi këto urime: për lindje, për ditëlindje, për martesë apo për fejesë?

Me jetë të gjatë!	Për lindje
Urime martesën!	
U trashëgofshi!	
Me jetë të gjatë!	
Qoftë me shëndet!	
Urime fejesën!	
Urime ditëlindjen!	
U bëfsh 100 vjeç!	
Jetë të lumtur!	

## Detyrë

3. Lexoni me vëmendje këto fjalë të arta të njerëzve të mëdhenj. Shkruani për secilën veç e veç se çfarë na mësojnë ato?

- Kur ta keni të qartë atë që doni ta shkruani, fjalët do t'ju vijnë vetë (Horaci).

---

---

- Dëgjoni këshillat e atyre që dinë shumë, po sidomos dëgjoni ata që ju duan shumë (A. Graf).

---

---

- Mos ia lejo gjuhës sate të ecë para mendimit tënd (Shilone).

---

---



- Mos thuaj kurrë fjalë për të cilat më vonë do të turpërohesh ose do të pendohesh (A. Gelio).

---

---

- Pa pasur njohuri nuk mund të shpikësh, ashtu si nuk mund të thurësh vargje pa ditur gjuhën (Ajnshajtj).

---

---

- Njeriu që s'gabon, zakonisht s'bën asgjë (Felps).

---

---

- Nëse doni që goja juaj të mos gabojë, kini parasysh këto pesë gjëra: kujt i flisni, për cilin flisni, si flisni, kur dhe ku flisni (Anonim).

---

---

- Jeta është një edukim i vazhdueshëm (Flober).

---

---

- Kur dikush thotë se i di të gjitha, do të thotë se nuk di asgjë (Varoni).

---

---

- Nuk ka errësirë më të madhe se padituria (Shekspiri).

---

---

- Ka shumë mënyra për të lexuar, por duhet një zgjuarsis e veçantë për të lexuar mirë (Flober).

---

---

## RITREGIMI

(me gojë dhe me shkrim)



Nastradini, sa herë e dërgonte të birin me shtambë të mbushte ujë në krua, e rrihte atë.

- Pse e rrah? – e pyeti një ditë një miku i tij. Ai nuk bëri ndonjë faj.

- Ta rrah kur do ta thyejë shtambën? Ç'më duhet atëherë? Unë po e rrah para se ta thyej shtambën që të mos e thyej atë.

### Detyrë

*Ritregojeni me shkrim këtë fabul.*

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

## MBRETI KAFSHËVE TË PYLLIT



Tregojnë se luani, mbreti i kafshëve, u sëmur rëndë dhe kërkonte ndihmë nga të gjitha kafshët, për ta shpëtuar.

Ujku, që e ndiente veten të parë pas luanit, nxitoi i pari për ta parë dhe për t'i dhënë kurajë. Rrugës takoi një dhelpër, së cilës i tha:

- Zonja dhelpër, - a e ke marrë vesh se mbreti ynë është sëmurë? Ai mund të ketë nevojë për ndihmën tonë. Eja me mua ta vizitojmë.

- Unë kam punë të tjera dhe nuk më mbetet kohë e lirë për të parë sa mbretër janë sëmurë. Shko dhe ndihmoje ti.

Ujku vazhdoi rrugën i vetëm, por përgjigjja e dhelprës e nevríkosi dhe vendosi t'i japë një mësim të mirë. Kur arriti para luanit, me përulësi, i tha.

- Madhëri, a jeni më mirë sot?

- Jo, i dashur ujk, kam dhembje të mëdha. Gjithnjë po bëhem keq e më keq. Asgjë nuk po më përmirëson.

- Është një dhelpër mjeke, që mund të të shëronte. E takova dhe i thashë që të vinte me mua, por ajo nuk më përfilli as mua, as ju.

Luani u inatos, ulëriti dhe vendosi ta dënonte dhelpren. Mirëpo, dhelpra porsa u nda nga ujku filloi të frikësohej, se mos ujku do t'ia rrëfente luanit mospërfilljen e saj. Ndërroi menjëherë rrugë dhe pas pak u gjet ne selinë e mbretit të kafshëve.

- Nderime, madhëri, si jeni sot? Kam disa ditë që bredh nëpër pyje për të gjetur ndonjë ilaç për ju, por jam e mendimit që ilaçi me i dobishëm për sëmundjen tuaj është përgatitja e një furçe me mustaqet e ujkut dhe fshirja me to disa herë në ditë e vendit ku keni dhembje.

Me të dëgjuar këto fjalë, ujku u tromaks dhe i inatosur i ndërhyri:

- Mustaqet e mia janë të forta. Nuk shërbejnë për furça.

- Ç'moshë ke ? - e pyeti dhelpira.
- 5 vjeç.
- Oh sa mirë. Pikërisht këto janë më të përshtatshmet.

Shërbyesit e mbretit e mbërthyen me forcë ujkun dhe ia prenë mustaqet. Përgatitën me ato një furçë dhe filluan ta gudulisin luanin aty ku kishte dhembje dhe mbreti e ndjeu veten më mirë.

Dhelpira dinake fitoi mbi ujkun paditës.

Ujkun, që po kthehej ashtu pa mustaqe, askush nuk e kishte frikë më. Edhe në strofullin e tij nuk e njohën dot.

*Nga folklori*

## **Detyrë**

*Ritregojeni me gojë këtë fabul.*

## PËRSHKRIMI

(me gojë e me shkrim)


### PLAKU DHE FËMIJA



TË MENDOJMË, TË PËRSHKRUAJMË

- Çka sheh në këtë fotografi?
- Sa vjeç duhet të jetë plaku?
- Çka po bisedojnë ata?
- Përshkruaje dukjen e jashtme të plakut.
- Përshkruaj vetitë e brendshme të tij.
- Përshkruaje dukjen e jashtme të djalit.
- Përshkruaj vetitë e brendshme të tij.
- Çfarë ka në çantë plaku.
- Pse plaku e mban bastunin në dorë.

## FSHATI IM



Fshati im është i vogël, por i bukur dhe i rregulluar mirë. Shtrihet në luginën e një kodre. Është i mbytur në blerimin e pemishteve. Kodra është e veshur me pyll të bukur ahesh.

Në fund të fshatit rrjedh një përrua i kthjellët. Në të lahen tufa të bardha patash dhe rreziten në diell. Pak më tutje shtrihen livadhe e fusha të blerta. Midis tyre kalon një urë e gjerë.

Në mes të fshatit tonë gjendet shkolla e re dhe biblioteka me shumë libra të mirë e të bukur. Aty ka radio e televizor. Shpesh aty shohim edhe filma.

Zemra më vlon nga gëzimi, kur shikoj se sa i bukur është fshati ynë.

Ata që vijnë në fshatin tonë për të parën herë, habiten se sa ka përparuar.

### **Të shprehurit krijues**

*Përshkruaje me shkrim qytetin, fshatin apo lagjen tënde. Së pari titulloje atë.*

## NJOFTIMI

(me gojë e me shkrim)

### MENDO MIRË E PASTAJ FOL OSE SHKRUAJ!

Kur dikush flet ose shkruan pa rregull, rëndom thuhet: „Atë nuk mund ta kuptosh as kur flet as kur shkruan“.

Ja, kështu shkruajnë e flasin edhe disa nxënës. Fjalive të tyre nuk mund t'i gjesh as kryet as bishtin. Nuk dihet se ku është fillimi e ku mbarimi i tyre.

Përpiquni ta rregulloni këtë hartim të një shokut tuaj të pakujdesshëm. Rishkruajeni duke i radhitur fjalitë sipas rrjedhës logjike të ngjarjes.

*Pas mësimit kthehemi në shtëpi. Ngrihemi herët dhe takohemi në krye të rrugës. Në shkollë arrijmë gjithnjë me kohë.*

*Çdo mëngjes ne shkojmë bashkë në shkollë. Unë dhe Fatosi jemi shokë klase.*

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

## **DETYRË:**

*Më poshtë janë ngatërruar padashur fjalitë e temës **Shkollimi i njerëzve** dhe të temës **Ushqimi**. Rishkruani fjalitë e mëposhtme në vendet e duhura që të fitoni dy tekste.*

Njerëzit mësojnë për të ditur më shumë. Çdo gjë që e hamë dhe e pimë ndikon në trupin tonë. Në shkollë mësojmë gjërat themelore. Ushqimi na jep energji për jetë. Ne mësojmë gjatë gjithë jetës. Njerëzit mund të jetojnë disa javë pa ushqim, por vetëm pak ditë pa ujë. Fëmija mëson shumë gjëra para se të bëhet pesë vjeç. Gjysma e njerëzve në botë vuajnë nga uria. Në botë ka ushqim të mjaftueshëm për të gjithë. Dituritë e fituara gjatë jetës, njerëzit i shkruajnë në libra.

### **SHKOLLIMI I NJERËZVE**

---

---

---

---

---

---

---

---

### **USHQIMI**

---

---

---

---

---

---

---

---



## TEATRI

### AI DI VETË

*(Skena është e hapur pjesërisht, kështu që shihet pjesa e mesme e skenës, e cila paraqet klasën. Shihet mësuesi dhe Edmondi, e prapa tyre, tabela, tavolina, karrigia. Mund të ndihet eventualisht, përjashta, të kolliturit e të qeshurit e nxënësve, të cilët nuk shihen).*

MËSUESI: Pra, Edmond, trego pse je vonuar prapë? Fol me zë që të ndiejë tërë klasa.

EDMONDI: Më falni, m'u këput lidhësja e këpucëve dhe kërkova një tjetër, por nuk e gjeta...

MËSUESI: Mirë. Por, edhe dje je vonuar.

EDMONDI: Po, më falni... Ajo ndodhi për shkak se u ndala te bukëpjekësi. Më ndali një plak dhe më vonoi duke më treguar se si dikur buka ka qenë pjekur më mirë se sot.

MËSUESI: Mirë. Por, edhe pardje je vonuar. A të kujtohet?

EDMONDI: Më kujtohet, si jo. Ende më djeg gjuha qyshse u përvëlova. Për mëngjes ma prunë qumështin valë...

U detyruam ta hedhim prej një gote në tjetrën...

MËSUESI: Po, më kujtohet, më kujtohet edhe mua. Ke treguar... Ashtu në atë punë të kanë kaluar pesë minuta. Mirë, Edmond. Kjo ka ndodhur pardje, të mërkurën, por, ti je vonuar edhe të martën. A të kujtohet?

EDMONDI: Po, si jo! Të martën kemi ndjekur miun nëpër dhomë. Askush nuk ka guxuar ta çelë derën. Ashtu kishte urdhëruar babai që të mos na ikte miu.

MËSUESI: Po, po më kujtohet. Për atë ti nuk ke guxuar të dalësh përjashta pa marrë fund i gjithë ai pështjellim. Po të hënën? Nëse nuk mashtrohem, ti edhe të hënën je vonuar. Trego, nëse të kujtohet, por mos na kallëzo prapë lidhëset, qumështin ose që ndoshta ta kanë fshehur fletoren ndokund.

EDMONDI: Shumë mirë më kujtohet. Por, të hënën kam pasur ditëlindjen dhe, ndërsa të gjithë u radhitën për të ma

uruar...

MËSUESI: Pra, tash dimë pse je vonuar për shkollë prej të hënës e deri të enjten. Sikur të dije të na kallëzosh pse do të vono hesh nesër të premtën, që kështu të plotësojmë tërë javën dhe ti do të kishe marrë pesëshe në vonesë.

EDMONDI: Pesëshe?

MËSUESI: Po, pesëshe. Por, sigurisht ti nuk e di që më parë.

EDMONDI: E di... e di edhe për nesër.

MËSUESI: Si mund ta dish përpara?

EDMONDI: E di. Nesër në mëngjes, para fillimit të mësimit, do të më vijë tezja nga Ulqini.

MËSUESI: Tezja? E çfarë do të bësh?

EDMONDI: E dini... se me të nuk jam parë tre vjet me radhë... do të zemërohet në qoftë se largohem prej shtëpisë posa ajo të vijë.

Më duhet të rri me të më së paku nja pesë minuta.

*(Perdja bie)*

## DETYRË

□ Lexojeni në role e me zë këtë pjesë të dramës. Kini kujdes ngritjen dhe uljen e zërit (intonacionin).

## TË KUPTOJMË PËRMBAJTJEN

- ❖ Cilat janë personazhet e kësaj pjese?
- ❖ Cili është personazhi kryesor?
- ❖ Përshkruani vetitë e Edmondit.
- ❖ Cila është tema e këtij teksti?
- ❖ Çfarë na porosit kjo pjesë e dramës?

## BISEDIM

- A vonoheni edhe ju në mësime?
- A e tregoni të drejtën apo krijoni gënjeshtër?
- Po në shtëpi, a i gënjeni edhe prindërit?
- A bën të gënjejmë?
- Pse nuk duhet të gënjejmë?
- Pse themi “Gënjeshtër i këmbët të shkurtra”?

## BIBLIOTEKA

### DETYRË

- *Lexojeni këtë tregim.*
- *Çfarë na mëson ai?*

### LIBRAT

Ndarja ime nga librat ishte tepër e rëndë. Më dukej vetja se i tradhëtova ato, nga se nuk e mbajta benë e dhënë se do të jemi gjithnjë së bashku.

Para se t'u ktheja shpinën, ua hodha një vështrim të gjithave me radhë. "Lulin e vocërr" sikur e kapën ca të dridhura dhe më thoshte "merrëm edhe mua të të gjendem pranë, edhe pse jam i zbathur pa këpucë, do ta zë një shteg". "Afërditës" iu mbushën sytë lot, sikur m'u lut që mos ta lë në duart e kriminelëve. Ogiqi me këmbor dhe kecat e Naimit i kishte kapluar frika se do t'ua nxjerrin sytë korbzinjtë. "Sarajeve të bardha" sikur filluan t'u shembeshin themelet.

Secili libër më dukej se ishte shumë i pikëlluar për ndarjen tonë. Vetëm librat e historisë dhe të romantikëve, që qëndronin disa raftë më lart, sikur nuk ipeshin. Më bëhej se më thonin "Jemi mësuar t'u përballojmë furtunave të këtilla, shko ti, shko, të shkoftë puna mbarë! se nuk frikohemi ne". "Mos më lerë këtu", më tha "Lahuta e Malcisë", ti e di se pushka dhe kënga nuk shkojnë njëra pa tjetrën.

Dhe njëmend "Lahutën e Malcisë" e futa në trastë, me keqardhje që nuk mundja t'i merrja me vete edhe të tjerat. Kështu ishte ndarja ime nga librat, kujtimi për të cilat më shoqëronte kudo, në fushëbeteja, në istikame e ndeja të tjera. Shpesh i shihja edhe në ëndërr. Më dukej se çdo ditë i merrja në dorë dhe ua ledhatoja faqet.

Kështu vazhdoi me muaj të tërë derisa një ditë u ktheva në shtëpi. Vendi i parë që e vizitova ishte biblioteka. Asnjëri libër nuk ishte në vendin e vet. "Lulin e vocërr" e gjeta të gjymtuar në një kënd krejt tjetër. "Lulet e verës" ishin vyshkur në tërësi. "Afërditës" nuk ia gjeta fare kopërtinat. Kecat e Naimit gati sa nuk ishin tretur.

Shumë të tjera ishin hedhur në pluhur dhe mbeturina, ndërsa mbi kopërtinat e tyre shiheshin gjurmët e këpucëve të kriminelëve. "Hasan Prishtina", "Bajram Curri", "Azem Bejta" e shumë të tjera ishin tretur fare. Para derës së hyrjes shiheshin gjurma të zjarrit.

*Riza Haziri*

## LEKTYRA E PARË E LEXUAR

Sot bleva një lektyrë  
që më dha mësuesja detyrë,  
kishte poezi plotë  
thash këtë s'e kuptoj dot.

Por gabova pa masë  
se çdo poezi që vinte pas,  
më mbushte me gëzim  
vetë bëja komentim.

Babit, mamit i thashë  
- edhe një lektyrë e pashë,  
me poezi plotë  
do ta marr që sot.

E para poetja Adelina Mamaqi  
zemrën ma kënaqi,  
e dyta "Keci bardhosh"  
që kaloi kurthin shëndosh.

Në vazhdim e di  
do të shkoj shpesh në librari,  
do të marr lektyrë  
edhe pa pasur detyrë.

## INTERNETI

Jam botë pa skaj  
më quajnë internet,  
informata brenda mbaj  
për çdo gjë në jetë.

Për dituri a argëtim  
pandarë ju shërbej,  
veç kliko miku im  
për ty çdo gjë do të gjej.

## PËRMBAJTJA

Historiku i gjuhës shqipe .....	4
Përngjashmimi i bashkëtingëlloreve .....	9
Theksi i fjalës .....	10
Gjinia e emrit .....	12
Shumësi i emrave .....	15
Kategoritë gramatikore të mbiemrit .....	18
Numri i mbiemrit .....	19
Kategoria e rasës të mbiemrat .....	21
Kategoria e shkallës të mbiemri .....	22
Kategoritë gramatikore të përemrit .....	23
Përemri vetor .....	24
Përemri dëftor .....	25
Përemri pyetës .....	26
Koha e pakryer .....	27
Koha e kryer e thjeshtë .....	39
Vetat e foljes .....	31
Gjymtyrët kryesore të fjalisë .....	32
Kuptimi i parë dhe kuptimi i figurshëm i fjalëve .....	34
Krahinorizmat .....	35
Neologizmat .....	35
Përdorimi i zanoreve i dhe y .....	37
Përdorimi i drejtë i togjeve të zanoreve ua, ue, ie, ye .....	38
Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve q, ç; gj, xh; r, rr; h, f, nj, v..	39
Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve r, rr .....	40
Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve h, nj, f, v .....	41
Përdorimi i drejtë i togjeve të bashkëtingëlloreve .....	42
Programi kompjuterik për drejtshkrim .....	43
<b>LEXIM LETRAR</b>	
Veçoritë e poezisë artistike .....	46
Llojet e poezive lirike .....	49
Poezia e dashurisë .....	49
Poezia sociale .....	51
Poezia e peizazhit .....	53
Poezia patriotike .....	55
Elementet pamore dhe dëgjimore të poezisë .....	57

Figurat stilistike .....	60
Ndarja e letërsisë sipas gjinive .....	62
Veçoritë e poezisë epiko-lirike .....	64
Fabula dhe përmbajtja e tekstit .....	68
Veçoritë e tregimit .....	74
Novela .....	77
Narratori (rrëfyesi) .....	80
Llojet e dramës .....	84
Tragjedia .....	84
Komedia .....	88
Drama .....	90
Dialogu dhe monologu .....	95
<b>TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA</b>	
Biseda dhe diskutimi .....	101
Të treguarit .....	104
Baraspesha (restitucioni) .....	107
Ritregimi (me gojë dhe me shkrim) .....	110
Përshkrimi (me gojë e me shkrim) .....	112
Njoftimi (me gojë e me shkrim) .....	116
Rregullat e shkrimit të tekstit .....	117
Teatri .....	119
Filmi .....	122
Biblioteka .....	124
Programi COBISS OPATS për të kërkuar në mediotekë .....	127
<b>PYETJE, USHTRIME, DETYRA, LEXIM LETRAR, INTERPRETIM, TË SHPREHURIT KRIJUES, PUNË KREATIVE</b>	
Përmbajtja .....	129-196
Përmbajtja .....	197